

STRATO VODICA  
ROMAN

# Udhëve të luftës

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-31

V 81




814-31

V 81

STRATO VODICA

# UDHËVE TË LUFTËS

Roman



KOMBINATI BOTORVAK - KULTYRNOBILNYA R.R.  
SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



lën në rrugë. Duke vështruar trisht e përparë me kujdes  
edhe me hapë të shpejtë anës trotuarit të drejtimit të shpër-  
ndarjes së ndërrimit, nga do të fillonin hedhjen e trakteve.  
Një trakt ishte hodhën nëpër traktin në opor. Që gjë në  
nëgjë, të nisen në drejtim të ndërrimit. Po kjo?  
Hedja ishte një gjë. Në këtë moment hapja e tij ka-  
ndonin fort dhe këmbëz tërësisht sikur të ishte mbar-  
lur me qelbë. Duke qelbë nga lura se ky njëri ishte në  
qelbë këmbëz me një këmbëz të këmbës.

## KAPITULLI I.

Qyteti malor që kishte humbur në errësirën e natës  
dukej edhe më i vogël. Vetëm në qendër të tij hidhnin  
dritat e tyre dy llamba të mekura. Nuk dukej asnjë lëvizje.  
Dëgjohej vetëm gërhimja vajtuese e një llamarine mbi  
çatinë e dyqanit të Peti Danit që e lëvizte era e malit  
Grano.

Dy të rinj, Din Kurti, një djalë me shpatulla të gjera,  
me këmbë të gjata e të drejta, me sy të çuditshëm e si të  
zhytur në ëndërrime, dhe Nesti Makashi rrinin në errë-  
sirë, brenda në dhomë, në katin e dytë të një shtëpie që  
i kishte dritaret nga rruga kryesore dhe hyrjen nga prapa  
dhe mbanin vesh në qetësinë e natës.

Orët kalonin ngadalë, të rënda, të mbushura me an-  
kthin e pritjes. Po afrohej ora 23.00. Pas 30 minutash do të  
fillonin shpërndarjen e trakteve. Gjithçka duhej të kry-  
hej brenda një kohe sa më të shkurtër. Po qe se çdo gjë  
do të kryhej në qetësi, do të venin të «flinin» po në atë  
bazë. Në rast se do të diktoheshin, do të shkonin në fsha-  
tin Lenicë. Sipas vendimit të celulës së Partisë po atë na-  
të do të hidheshin trakte dhe në disa fshatra në afërsi të  
qytetit.

Në orën 23.30 fiks u hap porta. Dini dhe Nesti do-

lën në rrugë. Duke vështruar rreth e përçark me kujdes, ecën me hapa të shpejtë anës trotuarit në drejtim të shtëpisë së nënprefektit, nga do të fillonin hedhjen e trakteve. Një trakt ia hodhën nënprefektit në oborr. Çdo gjë në rregull. U nisën në drejtim të nënprefekturës. Po kjo? Befas iu shfaq një njeri. Në këtë heshtje hapat e tij kumbonin fort dhe këpucët trokisnin sikur të ishin mbathur me potkonj. Dukej që nga larg se ky njeri ishte në qejf. Këmbët nuk i bindeshin dhe murmuriste e këndonte nën buzë. Ata e ndoqën me sy dhe vunë buzën në gaz, duke e vënë re se si përpiqej të ndizte cigaren, ashtu i dehur dhe me gjithë atë erë që frynte atë natë. Filloi lufta qesharake e këtij njeriu me shkrepësen, të cilën era kishte vendosur, me sa dukej, të mos e linte të ndizte cigaren. Me vështirësi ai kaloi në trotuar, u mbështet pas murit të një dyqani dhe filloi të shkrepëte shkrepëse njëren pas tjetrës. Dhjetë shkrepëse i shkuan kot... Më në fund e ndezi cigaren. Era filloi të frynte më fort. Dukej sikur po shtypte natën me krahë të padukshëm. I dehuri u lëkund dhe u kap pas bravës së portës së dyqanit. Të dy shokëve iu bë sikur dëgjuan, veç fishkëllimës së llamarinës, edhe një zhurmë tjetër, për nuk ishin krejt të bindur për këtë. U afruan dhe vunë re se si i dehuri, duke u përkulur dhe duke u shtrembëruar në një mënyrë qesharake, ra përmbys në qoshen e dyqanit.

— Shkojmë, Din, s'ke ç'sheh më, — i tha Nesti me zë të ulët.

— Të presim dhe pak, — i tha Dini.

Kaluan pesë minuta, mbase dhe më shumë. Qyteti në errësirën e natës gulçonte nga lodhja, aq sa tani mund t'ia ndieje dhe rënkimet. Lodhje. Zymtësi.

«Ah, djall o punë», — tha me vete Nesti që nuk e kuptoi qëllimin e shokut, i cili s'po lëvizte nga vendi.

Ata s'i hiqnin sytë nga i dehuri. Ai rrinte aty pa lë-



vizur. Dini bëri një hap përpara. Pas tij u nis dhe Nesti. Të dy iu afruan të druajtur njeriut pa ndjenja. Ishte një nënoficer i ushtrisë italiane. Dreqi e di ku kishte qenë dhe ku kishte pirë atë natë.

Të dy shokët e tërhoqën osh mbas qoshes së dyqanit e qëndruan në një rrugicë qorre. Nënoficeri kishte një fytyrë të hollë dhe të mprehtë, një hundë pak me kurriz. Flokët e kuqërremë i qenë rralluar mjaft, ndonëse dukej që kurrsesi s'do t'i kishte kaluar të tridhjetat. Ai ishte i armatosur me një pistoletë të markës «Beret». E zhveshën shpejt e shpejt, i morën me vete rrobet e pistoletën, kaluan në anën tjetër të rrugicës e dolën nga prapa nën-prefekturës. Aty ndaluan një çast. Roja, një polic që ruante nën-prefekturën, ishte strukur në një nga qoshet e saj dhe si duket e kishte zënë gjumi. Dëgjohej gërhima e tij e lehtë dhe monotone.

— Po fle, — pëshpëriti Dini dhe ia bëri me dorë shokut që të vazhdonin rrugën. Bënë përpjetë dhe pas disa minutash arritën në muret e jashtme të kazermave. Muret e tyre ishin lyster me tri ngjyra, të bardhë, kafe dhe jeshile. Të gjitha këto ndërtesa në përgjithësi kishin atë pamje ogurzezë që kanë kazermat e ushtrive të huaja. Dini dhe Nesti psherëtinë. Pa folur ata vepruan sipas planit të aprovuar në celulën e organizatës, ndonëse Dinin e pengonin rrobet e nënoficerit.

\* \* \*  
Të nesërmen në mëngjes, nëpër rrugët e ngushta të qytetit, gjëmuar motorët e motoçikletave dhe të makinave të blinduara që shkonin dhe vinin poshtë e përpjetë si të tërbuara, duke ngritur një re të dendur pluhuri. Një gjë e tillë s'kishte ndodhur ndonjëherë që nga Lufta italo-greke. Nëpër rrugët me kalldrëme, të nxira dhe të lëpira



nga këpucët me gozhdë të ushtarëve, dëgjoheshin hapat e patrullave që shkonin e vinin me pushkë në krah e me rripin e kapeles nën mjekër. Këto trokitje metalike i jepnin qytetit një pamje akoma më të zymtë. Njerëzia, nëpër porta e dritare, pyesnin çfarë kishte ndodhur, ç'ishte ajo lëvizje. Fytyrat e ngrysurat të karabinerëve, helmetat e hirta, rripat nën mjekër si dhe shkëlqimi i tytave të pushkeve, krijonin një ambient të rëndë, të padurueshëm.

Nëpër një rrugicë të vogël të qytetit, pranë sheshit «Dëshmorët e kombit», shëtiste dhe Dini, i cili qe veshur me një kostum të vjetër tërë arna. Dorën e djathtë e mbante në xhep. Kohë pas kohe ndalte këmbët dhe vështronte me vëmendje dyqanet e vogla me vitrina gjysmë të boshatisura tërë pluhur e rrjeta merimangash. Donte të përcaktonte se ç'mendonin njerëzit pasi kishin lexuar traktet që ai ua kishte futur nën dyer gjatë gjithë natës. Ai vinte re se si dhe ata njerëz, që më përpara i qenë dukur indiferentë në politikë, vështronin njëri-tjetrin me sy që shkrepnin dhe tundnin kokën në shenjë miratimi. I emocionuar nga ky mendim, Dini përshkoi gjithë rrugën që të nxirrte në të dalë të qytetit, por pastaj, sikur të kishte frikë nga ndokush, u kthye andej nga kishte ardhur dhe më në fund vendosi të hynte në kovaçhanën e Tase Polos. Para se të kapërcente pragun e kovaçhanës, u ndal me një pamje të pavendosur, sikur të mos dinte se si të sillej.

Prapa kurrizit të Dinit, në cepin e kovaçhanës bisedonin dy gra. Me gjithë goditjen e çekanëve të kovaçëve që mprehnin sëpata dhe plugje ai mundi të dëgjonte: këtë bisedë:

— Ç'ishin ato letra a trakte, qysh i thonë, që ishin hedhur që me natë në rrugë, moj korbë?, — e pyeti njëra.

— Nuk pashë gjë, — u përgjigj tjetra.

— Si, moj, s'pe! Epo atëherë ke dalë vonë nga shtë-

pia. «Pa, hë more, — i thashë djalit të komshiut, që e kishte në dorë, — ç'thotë ai trakt?!» Dhe ai filloi të ma lexonte. Sa mirë që thoshin pa! Mos paguani të dhjeta, taksa... e ç'thoshin, ç'thoshin, po kush i mban mend të gjitha. Po m'u bë qejfi mal kur thoshte: «Rroftë Shqipëria e lirë!». Dhe unë fët ia rrëmbeva një dhe e futa në gji.

— Pse s'thua që do të na vënë zjarrin, — e ndërpreu tjetra. — Ndaj u sulën ashtu sot më motora e autoblanda fshatit përpjetë?!

— Të na bëhen kurban i qenit!, — iu përgjigj tjetra. Dini buzëqeshi i kënaqur e pa u yënë re hyri në kovaçanë.

Edhë Nesti Makashi sipas detyrave që kishin ndarë me Dinin lëvizte bri shqetësimit të njerëzve, pranë vështirimeve të liga të spiunëve. Mendimet i vinin dhe i iknin, ashtu siç ndodh zakonisht në raste të tilla. «Po sikur të na kenë diktuar? Ç'do të ndodhë, ë?! Jo, asgjë s'mund të ndodhë. S'na pa kush mbrëmë?», — qetësoi veten Nesti dhe hyri në një rrugicë të pazarit, ku ishte mejhania e Taqit. Aty mblidheshin lloj-lloj njerëzish që ia kërcisnin tërë ditën shamatës. Në mes të atij grumbulli njerëzish që hynin e dilnin nga mejhania Nesti ndjeu se dikush me syze dielli po e shikonte me djallëzi. Ishte Sevo Maluka, një shok i fëmijnisë, me të cilin jeta e kishite ndarë me kohë. Nesti që i vogël punonte me babanë për ngritjen e shtëpive nëpër fshatra dhe në qytet, ndërsa dimrit shkante në shkollë. Kur mbaroi filloren, mësuesi iu lut babait të tij që ta lejonte të vazhdonte liceun. I ati e lejoi. Por Nesti nuk mundi të mbaronte veçse një klasë, sepse i ati, i vrarë nga jeta dhe i plakur para kohe, vdiq nga një plevit. Kështu Nesti la shkollën dhe zuri vendin e të atit. Vitë me radhë ai hapi themele, mbajti gurë dhe ba-



Itë, ngriti mure, sharroi dhe mbërtheu trarë, lidhi çati e hodhi kulme; kurse Sevoja, me të mbaruar liceun e Korçës, si bir nëpunësi që ishte, nuk punonte asgjëkundi. Gjithë ditën merrej me sport e bridhte kafeneve e haneve të qytetit. Ditën e 7 prillit të vitit 1939 Sevoja kishte dalë bashkë me disa studentë të tjerë në sheshin përpara prefekturës së Korçës duke tundur flamurin tringjyrësh të Italisë. Pastaj ishte regjistruar në organizatën e rinisë fashiste, kurse në korrik të vitit 1940, së bashku me disa të rinj të tjerë të sërës të tij, autoritetet fashiste të vendit e kishin dërguar për pushime në Itali. Kur ishte kthyer, Sevoja s'pushonte së foluri për mrekullitë që kishte parë andej. Vishej bukur dhe mund të dukej i hijshëm po të mos i mbante flokët dhe favoritët të gjata, të cilat e tregonin pak qesharak. Ç'është e vërteta, ai nuk ndiqte njeri nga pas. Rrallë e tek ngrinte sytë si me pahir dhe prapë merrte një pamje si të mos i interesonte asgjë përreth. Ishte dhënë pas kumarit, prishte jashtë masës dhe për këtë gjë disa shokë të tij kishin filluar të mos e afronin, bile të dyshonin për të si për një njeri jo të mirë. Por këto qenë vetëm dyshime. Këto të dhëna ishin të pamjaftueshme për të gjykuar një njeri për të mirë apo për të keq. Dhe ja, takimi i Nestit atë ditë me Sevon te hani i Llaqit hodhi dritë më tepër në qëndrimin e tij.

— U, Nesti, — tha ai kur u afrua dhe i hodhi dorën në qafë.

Nesti heshti një çast dhe e vërejti në fytyrë.

Sevoja që kishte kohë pa e parë shokun, nxori paqetën dhe i afroi një cigare. — Eja, shkojmë nga pazari.

Të dy u vërtitën një çerek ore rreth pazarit. Njerëzit diç pëshpërisnin me njëri-tjetrin. Fshatarët, të ardhur nga malet rreth e rrotull, i dukeshin si më të çelur në fytyrë. «Ç'të fshehta ruajnë vallë në shpirtin e tyre. Përse janë si të gëzuar sot?», — nisi të mendonte Nesti, po Se-



voja, duke e kapur për krahu, e shkëputi nga mendimet dhe e tërhoqi në të djathtë të pazarit pa këmbyer asnjë fjalë. Atëherë Nesti vuri re se diçka po ndodhte. Fshatarët nuk po shisnin dhe nuk po blinin më, por po vështronin të gjithë nga një anë. Të dy shokët bënë dy hapa më tutje, hipën në trotuar për të parë më mirë se ç'bëhej më tej, kur ja, nga bërryli i rrugës kryesore karabinierët po shtynin me kondakët e pushkëve një njeri.

Njëri nga karabinierët vinte i pakët nga shtati. Tjetri vinte më i madh në trup e kishte një mjekër të kuqërremë, që i jepte fytyrës së tij një shprehje si të një bishe kurse i arrestuari ishte një djalë i ri, rreth të njëzetave, me një fytyrë të menduar, të bukur e me sy plot shkëlqim. Ndonëse në çdo hap ndiente të shtyrat e kondakut, ecte krenar duke mbajtur kokën lart e duke hedhur i sigurtë hapat e tij të gjatë dhe të rëndë e dukej sikur i tërhiqte ai të dy karabinierët. Pazari ngriu i tëri në heshtje. Të gjithë kishin kthyer sytë nga treshja që po ecte rrugës kryesore dhe i tregonin njëri-tjetrit me shenja prangat që lidhnin të dyja duart e të arrestuarit. Një vajzë e re, që ishte disi mënjanë nga turma, u drodh nga tronditja. Ajo hakërrehej flakë e kuqe nga inati, ndërsa sytë i kishte të mbushur me lotë.

— Pali! Pali!, — thirri Sevoja, kur njohu të arrestuarin.

Nesti e njihte prej kohësh Pali Duron dhe e dinte shumë mirë se ç'përfaqësonte ai në atë krahinë, por mori një pamje të tillë sikur të mos e njihte dhe të mos i interesonte asgjë për atë që ndodhte.

Pas të arrestuarit, si nja tridhjetë hapa, vinte nënprefekti, zoti Fate Ymeri, dhe me një herë pas tij kapiten Barxolla, komandanti i kuesturës.

Heshtje. Filluan të ndienin bezdi nga njëri-tjetri si të ishin armiq dhe jo shokë fëmijërie. Si kaluan ca çaste

kështu, Sevoja ngriti syzet e diellit mbi ballë dhe i hodhi një shikim pyetës shokut të tij, Nesti:

— Ç'kemi andej nga fshati, o Nesti?

— E ç'të kemi, — iu përgjigj ai ftohtë. — Ç'të reja doni më tepër nga kjo që patë tani?!

— Dëgjo, Nesti, se të kam shok, — tha e i rrotulloi sytë sa andej-këtej, sikur të kishte frikë se mos e dëgjonte njeri, — kam marrë vesh se mbrëmë këtu në qytet dhe në fshatin tonë janë hedhur trakte...

— Si, ore, si the?, — u hodh Nesti dhe ngriti dorën mbi ballë, si për t'u mbrojtur nga rrezet e diellit. — Unë nga fshati po vij, as kam parë e as kam dëgjuar gjë. — «Hajde, hajde, gjete kujt t'ia hedhësh,» — mendoi Nesti me vete.

— Çudi si s'paske dëgjuar gjë! Këtu po zien tërë qyteti, nuk e shikon se ç'bëhet?

«Po ky nga e mori vesh kaq shpejt?! Apo mos më provokon?», — mendoi Nesti me vete dhe, duke u shtirur sikur nuk dinte gjë e pyeti:

— Po këtu në qytet ku kanë hedhur, rrugëve?

— Rrugëve dhe brenda në shtëpinë e nënprefektit.

«Shiko, shiko, Ky i ditka të gjitha», — tha Nesti me vete pas pak e shtoi me zë:

— Po më çudit, more Sevo! Po çfarë shkruajnë në ato trakte?

— Unë, more Nesti, nuk di gjë fare. Po, siç më tha një shok, në trakt i bëhet thirrje popullit për luftë kundër fashizmit, të mos paguajë të dhjetat e ku di unë. Fliste dhe për luftën në male për partizanët, për flamurin. Do ta kemi pisk.

— Pse?

— Si pse, ore, merr vesh ti ç'bëhet apo jo? Italianët janë egërsuar shumë dhe, siç më tha ai shoku, po nuk i gjetën ata që i kanë bërë dhe shpërndarë këto trakte, do



t'i djegin ato fshatra ku janë hedhur... Shumë keq, ë?  
Si thua ti?

Sevoja priste nga Nesti përgjigje. Meqë Nesti nuk foli, ndezi një cigare dhe, pasi e thithi, u kujtua dhe i dha edhe atij një duke i kërkuar falje për harresën.

— E ç'të keqe ka këtu, o Sevo, — foli më në fund Nesti. — Ata flasin kundër të huajit. Të huajt ngaherë keq na kanë bërë dhe ngaherë me plumb i kemi pritur e jo me llafe të bukura, ashtu si ua do qejfi disave.

Sevoja qeshi.

— Pse qesh?! — pyeti Nesti dhe u shtirur sikur i vinte keq dhe çudi për ato që kishin ndodhur.

— E ç'jemi ne, o Nesti?! Një flluskë sapuni, një kokërr rërë në një det të madh.

— Një kokërr rërë? Ne, shqiptarët? Kush e thotë këtë?

— Kush e thotë?! Realiteti, faktet, historia, — u përgjigj si me rrëmbim Sevoja.

— Jo. Historia thotë të tjera gjëra.

— Çfarë?, — u interesua Sevoja duke thartuar fytyrën sikur të ndodhej te dentisti.

— Ky popull nuk është nënshtruar asnjëherë, apo jo?

Sevoja bëri sikur u pendua për ato që kishte shprehur. Fytyra e tij mori një pamje të menduar. Ai kishte një natyrë të heshtur, por tepër të nxituar kur hynte në bisedë me tjetrin dhe kërkonte që gjithçka ta thoshte menjëherë.

— Ashtu vërtet. Historia është histori dhe është gjë e bukur kur ajo flet mirë, por, të ngrihesh kundër Italisë dhe Gjermanisë që po tund botën, a s'është kjo gjë çmenduri, a s'është kjo t'i kundërvihesh historisë?

— Varet si ta kuptosh historinë!, — iu përgjigj Nesti.

— Nejse, — e ndërpreu Sevoja bisedën kur vuri re



se në drejtimin e tyre po vinte Dini, të cilin, megjithëse e kishte shok, nuk deshi ta takonte aq më tepër të bisedonte në sy të tij me Nestin ndaj shtoi me të shpejtë: — Dëgjo këtu, Nesti, ty të kam shok, ndaj dhe të flas hapur, të tregoj edhe zorrët e barkut se e di që nuk më keqkupton, por të lutem mos i bisedo me njeri ato që të tregova. Për punën e trakteve e kam fjalën.

— Mos ki hiç merak, nuk del fjalë nga goja ime, — e qetësoi ai e u habit kur ndieu përqafimin e Sevovs, i cili u largua menjëherë.

Gjatë rrugës për në fshat Nesti i tregoi Dinit me hollësi të gjithë përmbajtjen e bisedës që kishte bërë me Sevov.

— Kujdes!, — e këshilloi Dini. — Të shohim ku do t'i dalë tymi këtij njeriu. Ai edhe mua më ka folur disa herë pro fashizmit. Po më çudit pse nuk deshi të takohej me mua, — e u kredh në mendime që të gjente arsye.

— Sepse është duke më folur dhe mua pro fashizmit dhe s'ka dashur që ti të dëgjosh për të dytën herë.

— Tamam. I re pikës. Ai vepron kur gjen rastin dhe ruhet. Mendoj që të njoftojmë shokët e qytetit ta ndjekin veprimtarinë e tij.

\* \* \*  
Komandanti i kuesturës, kapiten Barxolla, një burrë me shtat mesatar e të drejtë, me flokë kaçurrel ngjyrë gështenje, me tiparet e fytyrës të theksuara dhe me sy të zgjuar, të cilët bëheshin si vrima të vogla kur qeshte, vazhdonte pa ndërprerje të gjurmonte për të zbuluar autorët e shpërndarjes së traktit dhe të çarmatosjes së rreshterit. Ai kudo kishte agjentët e tij, por ja që asnjëri prej tyre nuk po i sillte asnjë informatë të saktë. Kapiteni u nevrikos shumë sidomos kur u takua me një nga agje-

ntët e tij, Sevo Malukën, dhe kur ky i fundit u justifikua me shprehjen se «gjarprit nuk i duken këmbët».

— Dëgjo këtu, — filloi kapiten Barxolla me këshillat e tij të mërzitshme, — ç'është kjo «gjarprit nuk i duken këmbët». Këto fjalë s'dua t'i dëgjoj më. Çdo gjë që ndodh përreth e bën dora e njeriut. Ai lë gjurmët e tij, por s'jeni ju të zotët t'i zbuloni.

— E kuptoj, zoti kapiten, e kuptoj, por...

— Kurr gjë s'ke kuptuar, — e ndërpreu kapiten Barxolla, — derisa thua se gjarprit nuk i duken këmbët. Pse vjen atëherë kur s'je në gjendje të zbulosh asgjë? Ti përpiqu t'i zbulosh. Përpiqu të fitosh besimin e njerëzve. Mos harro se ke detyrime karshi nesh. Dhe, kryesorja, deklarata që ke nënshkruar kur ke qenë në Itali ndodhet në duart e mia. Mua më duhet patjetër të zbulohen autorët e këtij trakti. Më kuptoni!

Sevo Maluka e kishte humbur fare toruan. Por shpejt fati i buzëqeshi.

Sevoja e kishte kuptuar me kohë se Stiljan Geroja, një djalë fytyrëhequr, i dobët, por i fortë si sustë çeliku e që punonte çirak te kovaçi Tase Polo, ishte djalë i padjallëzuar e ngaqë besonte lehtë, filloi të afrohej me të. Një ditë Stiljani, duke biseduar me Sevon, i hapi zemrën dhe i tregoi se në fshatin Lenicë para disa javëve qe krijuar organizata e rinisë komuniste dhe se ai kishte një shok që ishte lidhur me komunistët dhe që punonte me rininë, por nuk i tregoi se kush ishte ai, veçse i premtoi se do ta njih-te me të së afërmi.

I kënaqur nga këto informata, po atë ditë Sevo Maluka fluturoi te kapiteni. Ai e ndiente veten të sigurtë se së shpejti do të zbulonte shpërndarësit e trakteve dhe do të shpëtonte kapiten Barxollën nga kjo andrallë e madhe.

— Hë, ç'keni? Erdhe me ato fjalët e tua se «gjarprit



nuk i duken këmbët»? Po qe kështu, mund të ktheshi kra-  
hët menjëherë, — i foli me tallje kapiteni.

— Jo, jo, zoti kapiten, kam informata të rëndësishme.

Sevoja i tregoi me hollësi për të gjitha ato që kishte  
mundur të nxirrte nga goja e Stilianit.

— Po kush i ka shpërndarë traktet?, — e pyeti kapi-  
teni.

— Edhe për këtë fola, por... — ngaqë s'dinte si të  
vazhdonte që të mos e zemëronte kapitenin, heshti.

— «Gjarprit nuk i duken këmbët», — buzëqeshi ka-  
piteni.

— Si të them? Akoma s'kam zbuluar se kush i ka  
shpërndarë. Por, me sa kuptova unë, ai duhet të dijë se  
kush ka marrë pjesë në hedhjen e trakteve.

— Edhe kjo do të zbulohet, — e lavdëroi kapiteni  
dhe i dha kurajë bashkëpunëtorit të tij. Pastaj filloi t'i  
jepte udhëzime të hollësishme.

— Kudo për këtë flitet, por vetëm duhet të dish të  
mbledhësh informata. Duhet të hapësh veshët dhe të dë-  
gjosh çdo gjë. Ja, për shembull ajo që të tha Stiljani. Sot  
ata hedhin parulla, trakte, çarmatosin ushtarakë, kurse  
nesër ndoshta do të ngenë mitralozin e do të na qëllojnë  
në mes të qytetit. Po ti shiko të afroresh me të sa më shu-  
më. Të gjithë në fillim fillojnë nga e vogla. Delja, po s'i  
mjaftoi kripa, fillon të lëpijë gjithë gurët që i dalin për-  
para. Më kupton ç'dua të them?

— Si urdhëron, — iu përgjigj Sevoja i gëzuar.

— Mirë, mund të shkosh. Dale, se për pak harrova.  
Vetëm bli dhe mos shit asgjë.

Sevoja psherëtiu dhe doli.

Gjatë dy-tri ditëve kapiten Barxolla pati takime të  
shpeshta me disa nga informatorët e tij. Ai përdori çdo  
mënyrë me ta, i kërcënoi, u premtoi para, mendoi e thuri



shumë plane, por asnjë të dhënë konkrete nuk mori. Ai përpiloi listën e të gjithë atyre që dyshoheshin për punëra të tilla. Lista nuk i doli e gjatë por ai kishte ndër mend ta zgjaste dhe me emra të tjerë, pasi të verifikonte dhe një herë kartotekën e kuesturës. Ngaqë mendonte shumë për atë që kishte ndodhur, i dilnin para syve fytyra të ndryshme, ndaj dhe mendohej t'i përfytyronte. Në listë ai kishte vënë dhe Stilian Geron. Kapiten Barxolla rrinte tërë inat e i pezmatuar si ndonjë djalë tekanj, kurse sytë e vegjël shikonin sa andej-këndej tërë etje. Ai i hodhi një sy zyrës. Muret ishin lyer me bojë bizele të hapur. Në mure ishin varur tablo piktorësh të njohur italianë. Pasi vështroi orën e dorës, i ra telefonit.

— Zoti Fate?

— Si urdhëron.

— Si shkojnë punët?...

— As unë s'di si të them, Asgjë të saktë nuk kemi deri tani. Gjarpri lëshon helmin dhe struket në folenë e tij...

— Jam shumë i pakënaqur nga këto që po ndodhin, zoti Fate. Nuk mund të flas në telefon, duhet të takohe mi, të flasim personalisht. Po të keni kohë, hajdeni në vendin tonë të zakonshëm. Unë do të vij atje për një orë. Po, po. Ju lutem mos u vononi.

Kapiteni la dorezën e telefonit dhe kërcënoi me gisht; «Prit pa do ta shohësh». Mbas një ore ai ndodhej në vendin e caktuar. Fatja se pse po vonohej. Kapiteni filloi të pinte cigare njërën pas tjetrës. Ndrejte uniformën, flokët.

Më në fund ai erdhi. Kolltukët dhe qilimi të linin një përshtypje madhështore, por ndriçimi dhe ambienti i dhomës ishte për të vënë duart në kokë.

Pasi i vajti pranë, i shtrëngoi dorën që e kishte zgjatuar kapiteni, i cili në çast mori pamje zyrtare, u ul në kolltuk dhe tundi kokën si me qederosje.

— Si ndodh kështu, zoti nënprefekt, — filloi kapiteni me ton të ftohtë, — në qytetin tonë të hidhen trakte, të çarmatosen ushtarakë? Kjo nuk na nderon as ju, as ne, por sidomos ju. Ju e dini fare mirë se ne ju besojmë. Ne ju kemi njeriun më besnik. Dhe ju vetë keni deklaruar kushedi sa herë: «Sa të jem gjallë, do t'i shërbej me besnikëri Duçes së ndritur». Po ç'ndodh se? Ata që i konsideroni njerëz profashistë, njerëzit tuaj, na dalkan të dyshimtë ose më mirë të themi prokomunistë dhe, më e keqja, është se ju, pikërisht ata merrni në mbrojtje.

Këto fjalë të kapitenit nuk i pëlqyen nënprefektit.

— Nuk po flisni drejt, zoti kapiten, aspak drejt!, — tha ai me ton të përmbajtur. Unë po luftoj me gjithë shpirt kundër komunistëve, ja ç'kujtim kam nga komunistët, — dhe tregoi një letër që ia dërgonin ata, ku e kërcënonin se, po të vazhdonte t'i shërbente fashizmit do ta paguante me kokë, — kurse ju po më shpallni mbrojtës të tyre!...

— E kuptoj, e kuptoj, — e ndërpreu kapiteni. — Por tani e kam fjalën për diçka tjetër. Unë s'flas kurrë keq për njerëzit pa pasur fakte. Ja për shembull, ju më keni thënë dhe më keni siguruar se në fshatin Lenicë që është nën hundën e qytetit nuk ka asnjëri të dyshimtë dhe që përzihet me politikë. Po a e dini ç'të dhëna kam unë?! Nga këto të dhëna na del se atje ka komunistë të vërtetë. Po, po, mos u çudit. Të mos e humbasim kohën kot. Më mirë merruni ju vetë me këtë çështje. Derisa keni miqësi me zotin Myrto, e dini vetë se si t'ia filloni punës. Ne jse, s'më takon mua t'ju mësoj për këto gjëra.

Pasi mori fund pjesa zyrtare e bisedës, Fatja i foli me ton të lartë.

— Këto janë gjëra boshe, zoti kapiten. Unë i njoh mirë ata të fshatit Lenicë. Pastaj zotit Myrto nuk i shpëton asgjë në fshatin e tij. Shiko se mos ju kanë keqinform-



muar. Megjithatë unë nuk do të rri duarkryq, të jeni i sigurtë, zoti kapiten, se do të bëj një pamundurën që të justifikoj besimin që kanë autoritetet fashiste tek unë dhe te njerëzit e tjerë që më rrethojnë.

— Skile je, zoti nënprefekt, skile, — e lavdëroi kapiteni duke i rënë në sup me përkëdheli. — Të tillë njerëz na duhen neve, oh, sa na duhen. . . Lufta me komunistët sapo ka filluar dhe ne e bëjmë atë kundër armikut të padukshëm, kundër atij duhet të veprosim me mend: ku me fjalë përkëdhelëse, ku me hu, e atje ku duhet edhe me litar e plumb kokës, apo jo?, — pyeti dhe i zgjati paqetën e cigareve e, duke vënë buzën në gaz me djallëzi, shtoi: — Të shohim se si do ta vërtetoni këtë besim, zoti Fate!

— Të shohim the? Vetë unë do t'ua përdredh qafën. Hajde të pimë një shishe verë, — shtoi e u ngrit.


Edhe kapitenit ia kishte ënda.

Mbas një ore, ulur pranë tryezës, i bërë çakërçejf, nënprefekti ngriti gotën sipër kokës dhe tha:

— Për shëndetin tënd, zoti kapiten! Betohem për nderin tim se ju dua shumë. Ushtaraku duhet të jetë i tillë si ju, njeri i vendosur. Edhe unë kur kam qenë ushtarak i tillë kam qenë, si ju. Pi për shëndetin tuaj dhe shpresoj se kurrë nuk do të zemërohem me njëri-tjetrin. Besimëni, ju mund të mbështeteni gjithmonë në besnikërinë time. Bashkarisht do t'ia dalim në krye, — tha më në fund nënprefekti, sikur të merrte zotim.

Mbi mbulesë kishin derdhur verë dhe ishte bërë një njollë e errët që i përngjiste hartës së Greqisë së vjetër.

Kapiteni vështronte fytyrën e nënprefektit që ishte mbuluar me pika djerse, tundte kokën dhe buzëqeshte i kënaqur.



## KAPITULLI II

Ajo natë sikur u err më shpejt se netët e tjera në Leninicë. Dritat e dobëta të kandilave me vajguri u shuan njëra pas tjetrës. Fshati u kredh në errësirë. Të gjithë shokët e organizatës së rinisë, sipas detyrave që kishin caktuar në mbledhjen e rinisë, një nga një u grumbulluan në vendin e caktuar, në të dalë të fshatit.

— Erdhën të gjithë shokët?, — pyeti Dini që vajti i fundit.

— Po, po, — iu përgjigjën ata të gjithë njëzëri e s'përmbaheshin nga gëzimi.

— Mirë, atëherë, nisemi. Me shokët e fshatit Lushakë e kemi lënë të takohemi në luadhet e Qeramithanës.

Dhe u nisëm. Nata ishte e bukur dhe e freskët. Era e mollëve kundërmonte kudo. Rruga e ngushtë dredhonte ndërmjet drurëve. Përreth gjithçka kishte rënë në hesh-tje dhe vetmi, nganjëherë dëgjohej gurgullima e një përroi apo fluturimi fërshëllyes i ndonjë zogu të natës.

Ata vazhduan të ngjiteshin për ndonjë orë rresht, pastaj drurët sikur u rralluan dhe u futën në një rrugë tjetër që zbriste. Ata e ndoqën këtë për disa minuta dhe u ndalën në një livadh në vendin e takimit.

Sa mirë ishte të dëgjoje këngën e zogjve, të shtriheshe



në bar e të sodisje gjysmë i dremitur qiellin e kaltër, t'i përgjigjeshe jehonës së zërit tënd, të thurje këngë. Sa gjëra mund të bënte njeriu. Por gjëja më e mrekullueshme ishte të merrje pushkën në dorë e të shporrje armikun nga vendi yt. S'kishte gjë më të bukur sesa kjo. Dhe këtë ata do ta bënin patjetër! Lufta ishte ndezur në të katër anët. Nuk pritën më shumë se dhjetë minuta, kur nga kthesa e një rruge, përbri një kodre, u duk një varg i gjatë njerëzish që po zbrisnin me të poshtë. Ata ishin mbi pesëmbëdhjetë vetë.

— Vdekje fashizmit!, — i përshëndetën kur arritën në vend.

— Liri popullit!, — iu përgjigjën ata njëzëri dhe u përqaftuan me njëri-tjetrin. Kazmat dhe qysqitë i hodhën në krahë dhe u nisën nëpër atë rrugë të verbër bri vargut të kodrave. Anës rrugës tek-tuk kishte disa drurë që dukeshin si qirinjtë të shuar. Nga larg dukej qyteti si një shkretëtirë e thellë. Era e veriut bënte që t'u dridheshin këmbët pas shpine. Dini ecte në krye të kolonës me hapa të gjatë e të shpejtë sikur do të fluturonte. Pas një ore arritën në vend. Në atë peisazh të bukur një lis i madh përpëlitej sikur të kishte shpirt. Lisi ishte mënjanuar pak përpara si të kërkonte rrugën për t'u larguar me vrap që andej. Shokët që ishin rraskapitur gjithë ditën në punët e tyre të bujqësisë filluan menjëherë nga puna. Dini qëndroi për disa minuta në këmbë duke soditur peisazhin. Parulla «Viva Divizione Venecia» dukej në atë faqe kodre si një re e zezë, e madhe. Trajtat e bardha e gjeometrike të parullës dukeshin si një dekor i zi.

Por ata nuk ishin i vetmi grup që kishin çarë errësirën e natës dhe i qenë ngjitur malit përpjetë. Përreth kodrave e pyjeve të fshatrave të krahinës lëviznin dhe të rinjtë të tjerë. Që nga maja e kodrës ata panë dhe ndien forcën që do të përllante e përmbyste çdo pengesë. Gurët

e mëdhenj dhe të bardhë si blloqe akulli që formonin parrullën rrokulliseshin përmbys dhe ndryshonin formën dhe ngjyrën. Lodhja i rëndonte përherë e më shumë, por ritmi i punës së tyre ishte si sahat. Në mes të atij grupi dëgjohej gjithnjë thirrja e Dinit: «Më shpejt, shokë, më shpejt». Atëherë shumëfishonin përpjekjet e tyre, i shtrydhnin të gjitha forcat që u kishin mbetur duke përdorur kazmën e qysqinë, sikur do të gërryenin prej përbindshit eshtrat e tokës.

Ata nxitonin duke u munduar kush e kush të punonte më shumë dhe dalngadalë toka po merrte një trajtë tjetër. Padashur vështrimi i tyre rrëshqiste andej nga qyteti, atje ku ishte strukur armiku dhe në atë pjesë të horizontit që ishte edhe në errësirë, nuk dëgjohej asnjë zhurmë, nuk vihej re asnjë lëvizje. Por andej nga lindja po jepe-shin shenjat se së shpejti do të zbardhte drita dhe qielli do të skuqej nga flakët e agimit dhe mali Grano do të merrte një ngjyrë të purpurt.

Vjeshta e atij viti ishte e nxehtë dhe e thatë. Të goditurat e kazmave dhe të qysqive përhapnin në qetësinë e natës valëzime tingujsh që derdheshin e dridheshin nëpër hapësirë, duke jehuar gjer në largësi, dhe grykat e shumonin jehonën e tyre.

Pa u zbardhur mirë, beteja mori fund. Ata ecnin dhe vështronin kodrën e përflakur nga agimi. Një peisazh të tillë nuk e kishin parë kurrë. I tërë qielli ishte i përflakur. Dini ia mori këngës. Fjalët e këngës ndoshta nuk merreshin vesh nga larg, por isoja e zgjatur dhe e mprehtë me siguri tingëllonte qartë në tërë krahinën.

*Në Lenicë atje në shkallë  
u zunë qafat si më parë,  
krisi lufta me andarë,  
sytë e tyre ç'kanë parë.*



Dini këndonte e shkrihej i tëri në këngë. Ai shpesh edhe vetë thurte vargje. Kur ishte i vogël, futej ndër dasma në dhomat ku mblihdeshin burrat, rrinte në një qoshe dhe dëgjonte tingujt e këngëve që i këndonin trimërisë së të parëve, luftës që kishin bërë ata kundër pushtuesve të huaj dhe i dukej sikur tingujt e atyre këngëve e merrnin në krahë. Herë-herë sytë i bëheshin të menducshëm dhe fytyra i vrenjtej si vetë kënga që ishte bërë për të si një ushqim. Kënga e gjallëronte dhe më shumë.

Në mëngjes herët Myrto Grenza kaloi përmes fshatit. Disa re të holla endeshin si fije merimange dhe si vello të holla mbështillnin horizontin. Qielli ishte i kthjellët. Vetëm kodra e Gorricës që ishte zhytur në mjegull Myrto Grenzës i dukej e vrenjtur, e trishtuar.

Ai ndali te shkolla dhe që andej, ashtu siç i ishte bërë shprehje çdo mëngjes, kthente kokën nga kodra e Gorricës dhe vështronte parullën ku dukeshin trajtat gjeometrike të saj si një simbol i forcës dhe i pushtetit të ushtrisë italiane, që, sipas tij, ishte ushtria më e fortë dhe nuk kishte forcë dhe ushtri tjetër në botë që t'i dilte përpara.

Befas mjegulla u ça, por në vend të parullës «Viva Divizia Venecia» ai lexoi «Rroftë Shqipëria e lirë». Ai i hapi sytë aq shumë, sa të thoshte se po i kërcenin kërkdhokët jashtë.

«O zot, — thirri Myrtoja me vete, — ç'po më shohin sytë?! E kanë prishur? Po kush ta ketë bërë xhanëm?! A thua ta ketë bërë ndonjë nga këta të fshatit tim! Nuk më besohet, pastaj, për ta prishur atë, duhen njerëz shumë, punë e madhe!! Sido që të jetë, kushdo që ta ketë bë-

rë, nuk është në kufijtë e fshatit tim», — i jepte zemër vetes dhe mundohej të tregohej i qetë.

I zhytur në mendime të tilla fytyra erdhi e iu bë edhe më e zbetë, flokët nën kapelen bojë kashte i kërcyen përpjetë si driza. Shkoi dhe u ul këmbëkryq në sofatin e shkollës. Në brez iu duk doreza e revolverit e larë me argjend. Nxori kutinë e duhanit dhe filloi të dridhte një cigare. Në këtë kohë u dhanë Zeqo Tosumi dhe Qerimi Turkeshi.

— Po ç'u bëre, more Zeqo, — i tha Myrtoja dhe mori frymë thellë sikur të mos ngopej me ajër. — Pa shiko, more, se ç'është bërë, — dhe zgjati dorën. — I shoftë allahu i shoftë!, — dhe u vrenjt si nata.

— Oj, oj, — ia bëri Zeqoja me atë fytyrën ezmere e të vrenjtur e me atë hundën e madhe dhe të kërrusur dhe mbeti për një çast si i shastisur. Ndërsa Qerimi s'ndihej fare, ai vetëm u hidhte sytë sa njërit dhe tjetrit sikur t'u këndonte mendimet dhe shqetësimet. Po, kishte të drejtë Qerimi i gjorë, ai nuk dinte të lexonte dhe nuk po kuptonte akoma se ç'kishte ndodhur.

— Shyqyr që s'është në sinorin tonë, o Myrto vëllai, se vallahi bilahi do të na kishin përvëlur fshanë. Ah, si erdhi kjo botë!.., — dhe sytë e tij të vegjël iu zvogëluan më shumë se kurrë ndonjëherë tjetër.

— Po kush ta ketë bërë xhanëm?!, — e ndërpreu Myrtoja.

— E po kush tjetër përveç këtyre kopilëve tanë, — tha e i hodhi sytë nga shtëpia e Din Kurtit.

— Ose ata rrjepacakët e fshatit Lushakë, — shfryu Zeqoja, sytë e të cilit u thelluan si nga një lodhje e madhe.

— More, le ta ketë bërë kush të dojë, veçse këta horrat e fshatit tonë të mos jenë përzier me këtë punë. E, ç'do të më lozin nga mendtë ndonjë ditë, — bërtiti Myr-



toja e duke vënë dorën mbi ballë, shtoi: — Më turpëruan edepsëzët, më vjen turp të vete në qytet.

— Vallahi, kam frikë se do ta kenë bërë bashkë, — tha Zeqoja. — Se, të ishin vetëm këta të çmendurit e fshatit tonë, të punonin me ditë të tëra dhe nuk e prishnin dot. Nuk prishet ajo parullë për një natë, dhe ku pa, në gojën e ujkut! Për të luajtur mendsh është! — «Po këta tutkunë italianë ç'bëjnë xhanëm?! Si nuk kanë dëgjuar gjë?», — tha me vete e i hutuar vështronte kodrën përtej.

— Çudi, — pyeti Myrtoja, — deri këtu të ketë arrihur puna?! Atëherë kemi të bëjmë me një forcë të organizuar e ky organizim do të na hapë telashe të mëdha. Demek ti mendon se në këtë valle duhet të jetë futur dhe i biri i Tasim Kurtit e ndonjë tjetër, ë?! —

— Vallahi, më merr mendja se po, — iu përgjigj Zeqoja. — Lëviz rinia, lëviz... — dhe balli po i mbushej me bulëza djerse.

— Ashtu ë?, Hej ky pis millet!, — shfryu Myrtoja. — Në fshatin tim nuk do të lë të lëvizë miza e jo i biri i Tasim Kurtit që kërkon të përvëlojë fshatin...

— Të paçim sa malet, o zoti Myrto, — filloi të fliste Qerimi, që deri tani s'e kishte hapur gojën fare. — Ti dhe perëndia, na shpëto dhe këtë radhë...

— Mirë e ke ti, Qerim, mirë, po kush ta di se!, — e ndërpreu Myrtoja. — Unë në fshatin tim nuk dua t'i dalë njeriu gjak nga hundët e jo të digjet e të shkatërrohet. Dhe ja, meqë ra fjala, ç'nuk kam bërë së foluri e këshilluari Tasim Kurtin që të mbledhë djalin, po kujt i flet? Ai është gdhe! Shkon pas mendjes së tij. Or, po të mos kesh në dorë dhe të mos bësh dot zap të pjellët e tu! Hej, si erdhi kjo dynja! Lesh e li u bë kjo flamë!

— E, se mos do të humbasë i biri i Tasim Kurtit kapitalet, apo do t'i digjen sarajet, — ndërhyri Zeqoja me fytyr të trishtuar.

— Nuk e di, po mua sikur nuk më besohet që Din Kurti dhe ndonjë tjetër nga fshati të ketë shkuar deri aty, — tha Qerimi. — Mos e kanë bërë ata të fshatit Lushakë dhe ne flasim...

— Ç'të fshatit Lushakë, more Qerim, — ndërhyri prapë Zeqoja. — Ta kenë bërë ata, gjysmë e së keqes, se, në mos përvëlofshin italianët, do ta përvëlojmë ne. Por, me sa ma pret mendja mua, këtë e kanë bërë bashkë. Mor, po a e ke parë se si krekoset ai i biri i Tasim Kurtit, Dini! Tërt s'ia bën syri. E kam dëgjuar me veshët e mi atë dobiç dobiçi se si flet kundër italianëve. Pardje bridhte rrugëve të fshatit dhe këndonte:

*Që kur suall italianë,*

*u plagosa brinjë më brinjë.*

— Hajde kuje më drekë, hajde! Kurse një ditë, siç më tha im nip, po bisedonte me ca të rinj dhe ç'u thoshite se: gjoja të varfërit paskan vetëm kallot në trup, kurse çdo gjë tjetër është pasuri e agait, por s'do të jetë gjithnjë kështu, jo... E ku di unë se ç'u kishte dërdëllisur ai atë ditë... Edhe im nip kishte filluar të lozte bishtin, por unë i thashë «sus» dhe ai e uli bishtin.

— Ashtu, ë?, — murmuriti Myrtoja i çuditur. Fytyra dhe qafa e gjatë iu bënë gjak të kuqe. Atij i dukej qesharake që këta të rinj kishin marrë përsipër të çlironin vendin.

Atij i përziente përbrenda kundër Tasim Kurtit. Njëherë, duke u shtirur se e donte dhe i vinte keq, i pat thënë: «Tasim, je burrë plak, po mblidh djalin, mos shko pas tij, se do të marrë më qafë veten dhe tërë fshanë», por ai as që ia kishte varur fare. Por nuk ishte vetëm kjo. Ai kishte inate të vjetra me Tasim Kurtin për punën e



një arc që Myrto Grenza me të mirë e me të keq kishte dashur t'ia merrte për të zgjeruar bahçen e tij, por Tasim Kurti nuk i qe bindur.

— E që thua ti, Myrto, këtyre u duhet shtypur koka si gjarpri, se, po i lamë, të gjallë do të na hanë. Është kolerë e rrezikshme ajo.

— Nuk e ke keq Zeqo, — tha Myrtoja. — Foshnja duhet shtypur, që në djep, se, po u rrit. . . — Pastaj, si të qe kujtuar për diçka, i hodhi dorën në sup Qerimit dhe vazhdoi: — More Qerim kam vënë re se edhe yt bir, Rustemi, rri gjithë ditën me atë Dinin. Mos është molepsur dhe ai me kolerën bolshevike.

Qerimi ngriti supet. Nuk e kuptonte fjalën «bolshevik».

— Hë, fol! Pse s'flet, — e pyeti prapë Myrtoja pas një heshtjeje të gjatë dhe luajti sytë me qesëndi.

— E, ku di unë i shkreti ç'të them. Po atë fjalën «bolshevik» a si the zotrote, nuk e marr vesh, — u përgjigj Qerim Turkeshi.

— Komunist, komunist, — e ngriti zërin Myrtoja. — Apo dhe këtë fjalë se merr vesh ti?

— Vallahi, o zoti Myrto, këtë fjalë e kam dëgjuar, po, se ç'janë këta komunistë dhe ç'kërkojnë. . . E po njëri pa gramë, unë, o zoti Myrto, — mbaroi fjalën Qerimi e heshti.

— Hëm, — shfryu Myrtoja, — ja, ta shpjegoj unë se ç'janë. Njerëz pa fe, pa din e pa iman, njerëz që duan të prishin familjen, shtëpinë e katandinë, njerëz që martohen dhe me motrat e tyre. Ja se çfarë të paudhë janë këta! . . .

— Jo, more!, — u çudit Qerimi. — Demek i biri i Tasimit dhe im bir të jenë të tillë? Sikur s'më besohet, o aga!

— S'të besohet, ë?

— Për besë!, — u betua Qerimi.

— Atëherë shko e pyet tët bir se ku ka qenë mbrëmë ai, ose Dini, ose shokët e tij dhe eja e bisedojmë prapë.

«Ndaj s'është ngritur akoma nga gjumi», — i dogji Qerimit qëndrimi i të birit dhe aty për aty deshi të largohet, por nuk e la Myrtoja. Ai i tha që të mos e merrte punën rrëmbyer, po ta pyeste të birin me marifet nëse kishte dijeni për këtë dhe cilët kishin marrë pjesë në prishjen e parullës. Në qoftë se zbulonte gjë, të mos ia thoshte askujt përveç atij.

Rustem Turkeshi e ndiente veten të lumtur dhe i dukej se gjithë bota merrte pjesë në gëzimin e tij të madh që sapo ishte pranuar në organizatën e rinisë komuniste të fshatit, e cila po atë ditë kishte marrë vendim që me rastin e pranimit të tij të kryhej dhe aksioni i prishjes së parullës «Divizia venecia». Rustemi ecte e merrte frymë me tërë forcën e mushkërive dhe nuk ngopej me ajrin e lehtë të malit Grano. I dukej sikur fluturonte nëpër rrugët e fshatit dhe mendonte: «Unë jam i ri komunist?! A thua të jetë e vërtetë kjo?!» — Akoma nuk i besohej. — «Po, po, tani unë jam i ri komunist,» — filloi t'i këndonte zemra atij. Dhe papritur i hyri një si frikë në zemër. — «Çfarë mund të bëj dhe çfarë s'duhet të bëj tani? Sot s'jam ai që isha dje. As dhe ai që isha dy orë më parë. Tani unë s'mund të bëj ç'të dua dhe pa m'u bërë vonë. Jam i ri komunist. Përpara se të veproj ose të flas, duhet të mendohem mirë nëse i përshtatet kjo një të riu komunist...».

— Pa hajde këtu, more buzëqumështi i babait, — i tha Qerimi të birit, Rustemit, që s'ishte ngritur akoma



nga gjumi. Ku ke qenë sonte natën?

— Asgjëkund, — u përgjigj i biri si me habi.

— Si asgjëkund!, — i bërtiti Qerimi. — Po pse më fjete deri në drekë, si ata djemtë e bejlerëve, ë?!

— S'kam fjetur tërë natën, baba. Kam vaditur misrin. Harrove që kishim radhën e ujit, — iu përgjigj i biri qetë-qetë.

Rustemi kishte folur shumë herë me të atin kundër fashizmit dhe për atë jetë të mjerë dhe të zitë e ullirit që hiqnin. I kishte thënë se këto i shkaktonin të pasurit, bejlerët, agallarët dhe Qerimit, duke dëgjuar mendimet e të birit, i bëhej sikur para syve të tij parakalonte një varg i gjatë njerëzish që s'kishte të sosur, zbatharakë dhe të pangrënë që vetëm punonin dhe rënkonin, dhe një varg tjetër i vogël njerëzish që s'bënin gjë tjetër veçse hanin, pinin e dëfrenin gjithë ditën. Përfaqësues i atij vargu të gjatë njerëzish ishte dhe vetë Qerimi.

Vuajtja ishte bërë si një gjë e zakonshme dhe ai nuk e kishte vuarë mendjen për të gjetur shkaktarin e këtyre vuajtjeve. Megjithatë, Rustemi akoma nuk guxonte t'i tregonte të atit se ishte i ri komunist; kishte frikë se mos e shqetësonte dhe e trondiste. Ai ruhej fort nga gjaknxehësia e babait. «Po t'i them, do të fillojë të bëjë potere, — mendonte ai. — Pastaj konsipracioni duhet mbajtur! Tani jam i ri komunist. . .».

— Hëm, — po a ke marrë vesh se ç'ka ndodhur?!

— Jo, çfarë, baba?, — dhe mori një pamje sikur të mos dinte se ç'kishte ndodhur.

— Domethënë ti nuk di gjë, ë?, — thirri, e tërhoqi për krahu duke zbritur shkallët dhe nderi dorën. — Ja pra, shikoje vetë se ç'ka ndodhur?!, — dhe me vështrim të vrenjtur ai sikur donte të thoshte: «Mua kërkon të ma hedhësh ti?».

Rustemi ktheu kokën andej nga ia bëri me dorë i ati

dhe heshti një çast. Pastaj u kthye nga ai duke qeshur tërë gëzim.

— Ç'më qesh!, — i shfryu Qerimi. — Për të qeshur është?

— Si të mos qesh, baba?, — i thirri Rustemi kur lexoi «Rroftë Shqipëria e lirë» dhe i hodhi dorën në qafë.

Nën vetullat e trasha shkëlqyen sytë e Qerimit.

— Mos bërtit kështu, — e qortoi i ati, po Rustemi nuk e dëgjoi. Ktheu dhe një herë sytë nga kodra e Gorriçës dhe lexoi me zë të lartë.

— «Rroftë Shqipëria e lirë».

— Mos, bir, mos bërtit kështu, — e qortoi prapë i ati. — Nuk na duhen neve këto. E çfarë u bë se shkruan atë parullë? Asgjë. Është mbretëri e madhe kjo, dëgjomë mua. Kjo të shtyp, të djeg, të shkrin si vesa e mëngjesit.

— Megjithatë çdo mëngjes gdhin prapë vesa, baba. — Në luftë me armikun që na ka pushtuar vendin ne do të fitojmë lirinë. S'rrohet në robëri, baba. Pastaj, si të fitojmë, ndryshe do të rrojmë.

— Ehu, — vazhdoi Qerimi mbas pak, — jam ngopur gjer në fyt me këto, biri im. Kam gjashtëdhjetë vjet që po jetoj dhe një ditë të bardhë se kam parë. Vetëm brenga, lotë... Jetë qeni. Ja, këtë kam parë.

— Do të vij në ditë të bardha dhe për ne, baba. Do të vij në.

— Hëm, — shfryu Qerimi. — Do të vij në kur t'i vihat flaka botës.

Ai dukej si një udhëtar që ka humbur rrugën, që vdes nga etja dhe uria, por që papritur dëgjon fyellin e bariut.

I ra ballit me pëllëmbë sikur të ndodhej përpara një hataje. Damarët në tëmtha iu frynë dhe lëshoi një pshe-  
rëtimë.

— Pse botës, baba? U duhet vënë flaka vetëm atyre që shkaktojnë këto vuajtje. Fashistëve, bejlerëve dhe



agallarëve që janë bashkuar me armikun... Ja, bie fjalla, Myrto me shokë.

— Të pasur e të varfër ka pasur gjithmonë që kur është krijuar bota...

— Ka pasur dhe ka, por s'do të ketë, — e ndërpreu Rustemi, i bindur se shumë gjëra do të ndryshonte luf-ta e re që kishte nisur maleve.

— E, more, po s'e bëjnë dot këtë, — psherëtiu Qerimi e një çehre tjetër i ra në fytyrë. — Më mirë lëri këto punë, o bir, dhe fjalë të tilla të mos dëgjoj më. Pa më thuaj kush ta këtë bërë këtë? Ja, për këtë di gjë të më thuash? Pa do të vijë kështu e do bëhet ashtu, janë përallalla. Nuk ngopet i urituri me lugë zbrazët...

— Po ç'të bëjmë atëherë, të rrimë duarkryq? Të thërrsim dhe ne si Myrto Grenza: «Rroftë Divizioni Venecia që na ka pushtuar vendin»!?

— Shët! Mos bërtit. Më duket se prapa derës ka njerëz.

Në çast u hap porta e në oborr u fut Myrto Grenza me Zeqon.

— Hë, more Qerim, ç'thotë ky çapkëni yt?, — e pyeti Myrtoja si me të qeshur, por dukej se ishte tërë hundë e buzë. Zemra i rrihte fort në kraharor.

Rustemi ishte truppakët e thatim. Faqet i kishte të futura përbrenda, ndërsa sytë e tij të vegjël e vigjilentë vërtiteshin në zgavrat sikur përpiqeshin të provonin mundësitë për të vështruar në të gjitha anët dhe në të njëjtën kohë.

«Çfarë dhelpre», — mendoi Myrtoja me vete duke mos ia ndarë sytë Rustemit.

— E ç'të thotë, o zoti Myrto, — iu përgjigj Qerimi dhe u mundua të mos i përulej siç e donte radha e tij. — Ja, po bisedojmë për atë drej misra. Mirë ata që i kemi nën ujë dhe i vadisim, po ç't'u bëjmë atyre të tjerëve që

na u thanë. Epo dhe koha na ka dënuar, e hëngërt dreqi e hëngërt, — u ankua Qerimi, pastaj i dha urdhër të birit të nxirrte një rrobë për të ndenjtur nën hijen e arrës.

**Rustemi shtroi një qilim të vjetër dhe bëri të lar-gohej, sepse i ati ia bëri me kokë që t'i linte vetëm. Diçka e fortë ziente brenda qenies së tij, diçka që mudohej të dilte dhe të mernte udhë.**

Myrtoja me Zeqon u ulën në qilimin zhele-zhele si në gjemba.

— Hajde, ulu dhe ti, — i thirri Myrtoja Rustemit. — Ti je burrë tani, mashalla, mos të marrsha në sy. E që thua ti, Qerim, — vazhdoi të fliste Myrtoja, — misrat vërtet na u thanë, po do t'i gjendet çairi. Nuk të lë Myrtoja të vdesësh për bukë. Apo jo more trim i Myrtos, — iu drejtua Rustemit.

Rustemi mblodhi supet. Thellë në shpirt ai asnjë fjalë s'i besonte Myrtos dhe shpesh, kur e vështronte, thoshte më vete: «Ki mendjen dhe ruhu nga ky gjarpër, baba!»

— E që thua ti, Qerim, të gjitha do të rregullohen, po ç't'u bësh të tjerave që s'na lënë rehat. Rri, or, shiko punën tënde, mos trazo që të mos të trazojnë. Bëhu mik me të gjithë, të të duan të gjithë. E, që t'i vëmë kokë fjalës, ç'u duhet atyre që të merren me kalamanllëqe, — tha e hodhi sytë nga kodra e Gorricës dhe ndjeu një tronditje. — Or, po se ç'janë ca zgjebarakë që kërkojnë t'i vënë zjarrin tërë krahinës, që i përpiftë dheu i përpiftë, — e ngriti zërin Myrtoja. — Ja, kur po vinim te ti, dëgjuam atë të paudhin e Tasim Kurtit, Dinin, që ia kishte marrë një kënge:

*Tym e flakë qielli i Shqipërisë,  
po i vjen vdekja robërisë*

.....



Epo kësaj ç'i thonë?, — pyeti Myrtoja e qeshi me zor. — Or, po nga i gjejnë dhe kush ua mëson, xhanëm?! Çuditë, për perëndi, çuditë si e lejon ai tutkun Tasim?!

Fytyra e delirë e Rustemit u bë flakë e kuqe. Ai që s'ishte trembur kurrë në jetë, tani e vështronte me frikë dhe me urrejtje Myrton, sepse e ndjeu se kjo vizitë kishte diçka ogurzezë. Dhe kujtoi të atin kur një ditë i kishte thënë: «Dëgjo, Rustem, dëgjo, ty të kam djalë të vetëm».

— E, more Qerim — vazhdoi Myrtoja — se mos është vetëm Dini, ka edhe të tjerë. Ka filluar të lëvizë rinia. Mirë më tha një ditë nënprefekti, zoti Fate: «Fajin e keni ju që nuk merrni masa t'i vini në zap ata maskarenj që turbullojnë dynjanë. Gjejini, ore, cilët janë ata të poshtër dhe dorëzouani italianëve, se i bëjnë sus ata. Po s'c bëtë këtë gjë, një ditë dhe ju do ta pësoni, do të digjet dhe i njomi për të thatin. Ata janë midis jush dhe lëvizin nën hundët tuaja». Po unë mblodha supet e s'i thashë gjë. E për kë t'i thoshë, mor jahu? Më vjen keq për fshatarin tim, i dua si fëmijët e mi, por hajde thuaju dhe merru vesh me ta, të kam rixha... — Si heshti një çast, shtoi duke iu drejtuar Zeqos: — Ja, Qerimi i shkretë mezi ndërtoi këtë shtëpi, mezi e ka vënë këtë plaçkë e maçkë dhe një ditë të bukur t'i digjet shtëpia e t'i rrënohet prokopia, e pse? Nga një kokëkrisur, nga Din Kurti. Do të thuash ç'lidhje ka Qerimi me këtë. Ah, more vëllezër, kur vërshon lumi dhe del jashtë shtratit të tij, për lan ç'gjen përpara. Kështu dhe ushtria italiane, po erdhi në fshat, lumi që na mori. Apo nuk është kështu, more Qerim?

— E ku di unë i shkreti ç'të them, — u përgjigj Qerimi, po nuk mblodhi supet siç e kishte zakon. Biseda me të birin e kishte gërvishur atë kore të trashë që ia kishte zënë sytë.

— Po ti, more trim i xha Myrtos, ç'thua?, — iu drejtua Rustemit.

— Unë ç'them? Po, meqë më pyete, them se lumi na ka marë me kohë, o xha Myrto, që kur vendin tonë e okupoji fashizmi. Lumë më i madh se ky s'mund të vijë tjetër.

Qerimi i kafshonte buzën që ai të heshtte por Rustemi qe ndezur. Donte të shpërthente.

— E di, e di, trim i xha Myrtos, e di, — e ndërpreu Myrtoja, fytyra e të cilit e humbi gjallërinë e u bë e vrazhdë. — Lufta, more djalë, është si ai lumi i rrëmbyeshëm që ecën me vrull si i tërbuar dhe përllan çdo gjë që gjen përpara. Ti e ke vështirë t'i kuptosh këto gjëra, se je i ri dhe s'të kanë rrëmbyer ndonjëherë valët e turbullta të lumit. Pa më thuaj mua dhe babait tënd se ç'na kanë parë sytë? Ja, kur po vija për këtu, m'u kujtua kur erdhën andartët grekë më 1912-1914, vranë e prenë ç'gjetën përpara, gratë dhe fëmijët e therur, shtëpitë e djegura... M'u kujtua xhaxhai yt, Ganiu, dhe m'u lëndua zemra. Kur fillon lufta, askush nuk mund të zotohet për jetën e vet...

— Epo dasmë pa mish nuk ka, o xha Myrto, — e ndërpreu Rustemi. — Po a s'më thua, se u bëra gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe s'ma ke parë ndonjëherë derën, ç'të sollti sot në shtëpinë time?!

Myrto Grenza u zverdh, se nuk e priste kurrë një fjalë të tillë. Çudi si e mbajti veten dhe, për ta mbuluar turpin që s'e mbante dot, u tall.

— Që kur qenka bërë shtëpia jotja, unë e di që kjo shtëpi është e Qerim Turkeshit dhe jo...

— Ç'është e tim eti, është dhe imja, — u përgjigj Rustemi.

— Ashtu. Mirë pra, dëgjo e mbaji mend fjalët e mia: — erdha të të këshilloj, se, me sa kam vënë re, si shumë përzihesh me atë djalin e Tasim Kurtit. Në të dhimbsen shtëpia, babai, nëna dhe motrat e tua, mos u përzie me ata që e kanë veshur pallton së prapthi dhe s'u dhimbset asgjë. Pa mendo njëherë për Qerimin e shkretë,



se të ka djalë të vetëm, mezi të rriti dhe të bëri burrë. Dëgjomë mua, se të kam si djalë. Shiko punën tënde dhe hap sytë. A mos bëj keq që të këshilloj?

Rustemi mezi po e përmbante veten. Myrto Grenza e vuri re dhe në çast i lindi dëshira që ta tallte Rustemin, ta mërziste, ta nervozonte. Me kujdes ai liroi jakën e këmishës, sikur ajo t'i zinte frymën, dhe vazhdoi: — Eh, sa ngatërresa po na shkakton ai djalë. Ai s'bën gjë tjetër veçse njetos gjithë fshatin. Po të marrin vesh ata të qytetit, do të na shikojnë shtrembër të gjithë. Çdo gjë ka kohën e vet. Nuk i bihet murit me kokë... Kur të vijë koha për luftë, edhe atë do ta bëjmë, por ajo do burra me mend në kokë e jo kalamanj, të fryrë nga mendja si Din Kurti.

Rustemi nuk duroi dot dhe pa u trembur ia ktheu:

— Sido që të jetë, sido që të ndodhë, vetëm ju nuk do t'u shikojnë shtrembër, — por nuk vazhdoi më tutje, sepse në oborr hyri i biri i Zeqos, i cili i tha Myrto Grenzës se dikush e kërkonte. Qerimi vështroi të birin në fytyrë dhe u zverdh nga parandjenja e ndonjë fatkeqësie. Por tani atij s'i mbetej gjë tjetër veçse të shkonte pas të birit. Djali i tij i vetëm mbetej gjithmonë po ai, ai Rustemi i vogël që donte të bënte punëra të mëdha. «Çudi si paska ndryshuar kështu, pa u kuptuar», — tha me vete Qerimi.

Myrtoja e Zequa u ngritën dhe u larguan menjëherë pa thënë asnjë fjalë tjetër. Atë e habiti dhe e revoltoi shumë sjellja e Rustemit. Për atë tani çdo gjë ishte e qartë: «T'ëmën, dhe ky kopil zbatharak qenka molepsur nga propaganda bolshevike. Do të më shohin e do të dritohen para meje!».

### KAPITULLI III

Dielli lodronte mbi majën e malit Grano. Dielli le-  
varosh tani kishte lëshuar një shkëlqim të jashtëzakon-  
shëm, sikur po gëzohej bashkë me zemrat e të rinjve. Në  
sytë e fshatarëve pasqyrohej një gjallëri e madhe dhe  
njerëzit ndienin gëzim. Kodra, që një ditë më parë dukej  
tërë vrazhdësi e zymtësi, tani sa vinte e dukej sikur bë-  
hej më e madhe e më e lartë. Vetëm sytë ngjyrë hiri të  
kapiten Barxollës që nga zyra e tij kalonin me shpejtësi  
nga një kodër te tjetra dhe vështronin me mospërfillje  
kreshtën ku parrulla e lyer me gëlqere të bardhë shndriste  
si një kurorë e artë në faqe të saj. Kapiten Barxolla  
s'kishte menduar kurrë se do të ndodhte një gjë e tillë.  
Ai dukej si një fëmijë i sëmurë dhe i telekosur që s'kishte  
të shëruar. Si kishte ndodhur kjo?! Disfatë pas disfate!  
Stema dhe emblema e divizionit ishte bërë copë e thë-  
rrime. Kapiten Barxolla qëndroi për një kohë me duar  
të kryqëzuara. Ai nuk i hiqte sytë nga një pikë. U mbësh-  
tet pas kolltukut dhe mbylli sytë përgjysmë. Mendimi i  
tij i lodhur rrëshqiti mbi kazermat e ushtrisë së tij. Një  
copë herë qëndroi pa folur. Ndihmësi i tij rrinte në kë-  
mbë si i ngulur. Diku larg, në drejtim të Grykave të Da-



kës, herë më qartë e herë më mbytur filloi të vinte krisma e largët e një mitralozi.

— Ata edhe mbrëmë kanë rënë gjithë natën, — i tha ndihmësi.

Kapiten Barxolla u zgërdhi dhe sytë e tij ndeshën përsëri në parullën që po i verbonte sytë. U ngrit në këmbë dhe një copë herë i ra kryq e tërthor zyrës, duke shkelur mbi qilimin e trashë persian. U ul përsëri mbi tavolinë dhe nga sirtari nxori një hartë. Në tri-katër vende ai kishte vënë pikëpyetje me laps blu. Ato tregonin vendet ku mund të qarkullonin «banditët» ose vendet ku dyshohej se mund t'u zihej pritë autokolonave të ushtrisë. Kapiten Barxolla nuk i hoqi sytë nga ato pikëpyetje. Ç'njerëz të mallëkuar! Ç'popull i pabindur!».

Kapiten Barxollës nuk i zinin këmbët vend. Ai kishte arritur në përfundimin se e ardhmja e tij ishte në rrezik. Në qoftë se ai edhe në këtë rast do të pësonte disfatë, shifat e tij do ta merrnin me sy të keq. Po ta donte puna, ata mund ta sakrifikonin atë... Atëherë ai do t'i thoshte lamtumirë ëndrrës për grada dhe ofiqe më të larta. Do të ngryste ditët si njeri i dështuar. «Jo, kjo nuk do të ndodhë kurrë». Atë do ta ndihmonte edhe organizata e Ballit Kombëtar që, sipas tij, ishte një nga organizatat më të forta dhe më me influencë në tërë vendin, sepse edhe Balli Kombëtar kishte të njëjtat interesa, për këtë ai s'kishte asnjë dyshim. «Eh, sikur t'i shtie në dorë ata, sikur të gjej fillin e kësaj rrjete të fshehtë komuniste, do të bëj atë që edhe eprorët e mi në Tiranë të çuditën kur të dëgjojnë». Ky mendim e kënaqi kapiten Barxollën, i cili kishte ndër mend të kërkonte largimin nga kjo krahinë pasi të kishte qeruar hesapet me këtë «banditë» të pakapshëm.

Duke rikujtuar dhe një herë të kaluarën dhe punën e tij të spiunazhit, kapiten Barxolla vendosi t'i jepte rëndësi më të madhe punës subversive e agjenturale në radhët e komunistëve dhe të aktivistëve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në atë krahinë. Nga studimi që i kishte bërë këtij problemi, ai e kishte të qartë se komunistët dhe aktivistët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare nuk ishin njerëz si ata «demokratët» ose «nacionalistët» e Ballit Kombëtar me programin e tyre, të cilët i njihte mirë zbulimi italian, apo personalitetet si të organizatave të mëparshme në regjimin e mbretit Zog, ku kapiten Barxolla në atë kohë kishte qenë për një kohë në Shqipëri si «profesor fizikulture». Dhe, tek mendonte se si të organizonte punën për të futur agjentët e tij në radhët e komunistëve e të çetës partizane, iu bë e qartë se duheshin gjetur njerëz të lidhur në një mënyrë ose tjetrën me komunistët dhe me çetën partizane e në të njëjtën kohë të ishin të tillë që të mos dyshonte njeri se ata i shërbenin spiunazhit italian. Mirëpo në këtë drejtim ai po haste vështirësi, nuk po gjente kandidatë të përshtatshëm. «E pse të mos përdor Sevon», — tha me vete. — Ndoshta me anën e tij mbase arrij të tërheq ndonjë agjent të vlefshëm nga radhët e komunistëve. . . Por, përpara se ta vë në zbatim këtë plan, duhet ta provoj se sa i vendosur dhe guximtar është ai që t'i shërbejë deri në fund spiunazhit italian. Komunistët shqiptarë janë të vendosur e fanatikë të atillë që nuk peshojnë as kokën përpara idealit të tyre, për të cilin ata luftojnë! Në vështirimin e parë ata duken njerëz xhahilë, të lindur vetëm për aventura, pa praktikë e përvojë organizimi e drejtimi, kurse në të vërtetë kjo s'është aspak ashtu. Po qe se ata i vihen një pune, e kryejnë deri në fund, pa llogaritur se me çfarë çmimi e paguajnë». Mendime të errëta i vinin dhe i iknin tek sillte ndër mend ngjarjet e ndodhura. Kapitenit i tingëllonin ende në vesh



fjalët e një komunisti të burgosur kur e nxorën për ta pushkatuar. «Qëlloni, fashistë, sa të doni! Qëlloni! Unë e mora hakun tim me sa pata mundësi, kurse shokët e mi do ta çojnë deri në fund». Dhe për një kohë të gjatë para syve të tij mbeti e shfaqur figura e këtij komunisti trupmadh e shpatullgjërë si dhe shikimi i tij i ashpër dhe tallës. Papritur ndjeu një të rrëqethur në trup dhe kjo sikur e solli në vete. Në fund të fundit e pse të mos e provonte dhe një herë Sevo Malukën përpara se të vinte në zbatim planin e tij?...

Sevo Maluka zbatonte me kujdes udhëzimet që kish të marrë nga kapiten Barxolla dhe, kur i binte rasti të takohej me Stiljanin, mendohej t'ia sillte bisedën në temën e dëshiruar dhe të nxirrte nga bashkëfolësi ndonjë gjë në lidhje me ngjarjet e ndodhura. Dhe zemërimi, me të cilin fliste ai për poshtërsitë e italianëve, që arrestonin e burgosnin të rinj e të reja, burra e gra, të cilët i torturonin, dukej se ishte sa për sy e faqe. Stiliani më shumë nga çdo gjë u çmonte njerëzve singeritetin. Atij i vërtiteshin ndër mend fjalët që i pat thënë dikur Dini: «Duhet pasur shumë kujdes në marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Sekretet nuk i thuhën askujt, as shokut më të ngushtë, në qoftë se nuk ke lidhje me të».

Sevoja filloi të tregohej më aktiv dhe nisi të sillej poshtë e lart, të dëgjonte bisedat e fshatarëve, të punëtorëve, zanatçinjve, studentëve dhe përpiquej të mësonte ndonjë gjë të dobishme për t'ia bërë qejfin kapitenit. Por këto përpjekje jo vetëm që nuk i dhanë asgjë, por patën edhe pasoja të rrezikshme...

Pasi kishte ndenjur disa ditë në shtëpi, Sevo Maluka ndodhej tani përballë kapitenit të kuesturës.

— More Sevo, — tha kapiteni — fytyra e të cilit mori pamjen e një njeriu të habitur, — ç'të ka ndodhur kë-shtu? Apo je rrëzuar gjëkund?!

— Ç'rrëzim, zoti kapiten, luftë e vërtetë me bandi-tët.

Kapiten Barxolla nxori si me nxitim një cigare dhe e ndezi.

— Para katër ditësh, — vazhdoi të fliste Sevo Malu-ka, duke marrë frymë me vështirësi, — më dolën dy vetë nga Rruga e Bërdushës, në hyrje të qytetit. Ata më kapën në befasi në errësirë. Njëri, me trup të gjatë, më kapi me duar dhe më shtrëngoi si me darë, kurse tjetri, me trup të shkurtër, por të lidhur dhe të fortë, më zuri gojën me shami. Fill pas kësaj një grusht i fortë ra mbi kokën time. «I poshtër, njeri i ndyrë», — më shtynte e më shante ai me trup të shkurtër, duke e shoqëruar çdo fjalë me grusht në kokë. Goditjet ishin aq të forta, sa unë bija herë në një anë dhe herë në anën tjetër, tamam si dordoleci që s'e kanë ngulur mirë.

Kapiteni thithte me etje tymin e cigares dhe shtrën-gonte grushtin mbi tavolinë sikur donte të mbyste di-kë!

— «Ti akoma s'e di se sa të fortë jemi ne!», — m'u kërcënua ai me trup të shkurtër. — Kudo ne kemi shokë. — Ne të gjurmojmë në çdo hap! Do të të vrasim fare po s'ndenje urtë». — Kapiteni dukej sikur i vinte shumë keq për atë që i kishte ndodhur Sevos. Dhe krejt papritur për-plasi grushtin në tavolinë, u ngrit me vrull dhe filloi të vente e të vinte nëpër zyrë. — Ata më lëshuan dhe ua mbathën tatëpjetë arave në drejtim të fshatit Bërdushë, se dëgjuan zhurmën e një makine. Mund të më kishin vrarë. Këta duhen zbuluar, zoti kapiten, dhe duhen futur në burg.



— Mirë, mirë, — e ndërpreu kapiteni kur pa që Sevoja po e ekzagjeronte ngjarjen që i kishte ndodhur. — Ti do t'i zbulosh, s'ka kush tjetër t'i zbulojë. Po hajde, shko shërohu dhe fillo nga detyrat që të kanë ngarkuar.

Kështu e priti dhe e përcolli kapiten Barxolla Sevon.

Pasi doli Sevoja, kapiteni tha me vete: «Qenka me të vërtetë besnik dhe i vëndosur deri në fund t'i shërbejë zbulimit italian», — e i ndritën sytë nga gëzimi.

Koha ndiqte rritshëm e saj të lartuar e plot tubu-  
llit.  
Atë mërmëje xha Tasimi, i ati i Dini, u krijoi në  
shpirt shpirt i mëkësht. U u këmbëkryq në anë të var-  
tës dhe po i dritshëmigat nënën pas tjetër. Anës xha-  
rit këndonte avulli i gjymit prej bakri, sikur pipoj ndo-  
në këmbë.  
Ashtu ishte xha Tasimi, njëherë, i heshtur i për-  
mbajtur e pak i llohtë edhe me të shpirt dhe me të mënjë  
e tij prandaj dhe me s'guxonin të flasin për atij Dini shi-  
konte lart e lartur të babait, vudhat e frygës së tij  
që kështu e lundit i denjë shuar, vështronte sytë e tij gjith-  
monë të pengosur dhe ngapë k'listet, i duket sikur men-  
dimer i pikonin drojt e në zemër dhe ia rëndonin atë dhe  
më shumë.  
Kur Tasim Kurti nuk ndodhej në shpirt, të katër të-  
mijt e tij loxin të lirë këndonin, bënin rërmëje dhe e  
këmbin shpirtë përmbys. E shodja e xha Tasimit ishte  
më e çelur. Herë-herë bënte ndonjë shaka me të mënjë. Në  
kohën e të vjetërave i vinte të zhvishnin misër deri vonë.  
Dhe në lshat Tasimit të gjithë — in kishin frikën. Kur  
dinte lshat për vaxhdësinë e xha Tasimit, thuhet se ai  
e kishte për lshat «Ashtu ka qendë dhe i ati e sic tregojë»

#### KAPITULLI IV

Koha ndiqte rrjedhjen e saj të trazuar e plot turbullira.

Atë mbrëmje xha Tasimi, i ati i Dinit, u kthye në shtëpi shumë i mërziur. U ul këmbëkryq në anë të vatrës dhe po i dridhte cigaret njëren pas tjetrës. Anës zjarrit këndonte avulli i gjymit prej bakri, sikur piquej ndonjë kërmill.

Ashtu ishte xha Tasimi, hijerëndë, i heshtur, i përmbajtur e pak i ftohtë edhe me të shoqen dhe me fëmijët e tij prandaj dhe ata s'guxonin të flisnin para tij. Dini shikonte faqet e fishkura të babait, rrudhat e fytyrës së tij që kohët e fundit i qenë shtuar, vështronte sytë e tij gjithmonë të brengosur dhe, ngaqë s'fliste, i dukej sikur mendimet i pikonin drejt e në zemër dhe ia rëndonin atë dhe më shumë.

Kur Tasim Kurti nuk ndodhej në shtëpi, të katër fëmijët e tij loznin të lirë, këndonin, bënin rrëmujë dhe e kthenin shtëpinë përmbys. E shoqja e xha Tasimit ishte më e çelur. Herë-herë bënte ndonjë shaka me fëmijët. Në kohën e të vjelave i vinte të zhvishnin misër deri vonë.

Dhe në fshat Tasimit të gjithë ia kishin frikën. Kur binte fjala për vrazhdësinë e xha Tasimit, thuhej se ai e kishte për fis. «Ashtu ka qenë dhe i ati e, siç tregojnë



të vjetrit, edhe i gjyshi», kurse në të vërtetë xha Tasimin e kishte bërë të vrazhdë vetë jeta e ashpër nëpër male, Xha Tasimi kishte punuar gjithë jetën me thonj e me dhëmbë, kishte vënë disa kokë bagëti dhe kishte ndërtuar një shtëpi. Në moshën më të re xha Tasimi kishte marrë rrugën e kurbetit. Deri në Australi u degdis, duke i rënë poshtë e përpijetë, po kudo që i huaj dhe asgjë nuk fitoi përveç kallove të duarve dhe heshtjes buzë oxhakut që gjithnjë e shqetësonte aq shumë të birin, Dinin, i cili e shikonte më tej e më thellë jetën e njerëzve që kur kishte nisur të punonte në terren me rininë komuniste. Bile Dini kishte vënë re se kohët e fundit i ati e donte më shumë dhe shpesh ia dëgjonte dhe fjalën. Bisedonte me të si me ndonjë shokun e tij. Dini e ndjente dhe e kuptonte se i jati kishte nisur t'ia dëgjonte fjalën, sidomos pas asaj dite kur e gjeti duke lexuar librin «Proletarë të të gjitha vendeve bashkohuni», e «Historia e shoqërisë njerëzore është historia e luftës së klasave». Pas këtyre librave Dini u dha me mish e me shpirt dhe u lidh edhe më shumë me hallet e popullit. Ai bisedonte me këdo për librat që lexonte edhe me të atin, edhe me mësuesin, Pali Duron, i cili vazhdimisht i jepte libra të ndryshëm që përhapnin idetë komuniste. Kështu dalngadalë, pa e kuptuar as ai vetë, idetë lidheshin njëra me tjetrën e i formuan atë bindje të brendshme se bota që ndërtuar shtrembër, mbi disa binarë të kalbur, dhe se kjo duhej shkallmuar nga themelet. Por kishte dhe disa gjëra që ai s'u hynte dot menjëherë brenda, por s'i vinte rëndë të kthehej e t'i rilexonte, ose të pyeste Palin dhe ato që mësonte nga ai, nga librat e nga broshurat e ndryshme, nuk mbeteshin brenda tij. Kur lexonte e diskutonte me Palin probleme të luftës e të ndërtimit të shoqërisë së re, e ndiente veten më të fortë. Pali ishte njeri i qetë e modest, por aktivist energjik dhe largpamës. Në mes të shokëve ai sikur nuk dallohej nga

të tjerët, por në çdo vështirësi shokët i drejtoheshin patjetër atij. Edhe Dini përpiquej të imitonte dhë të ndiqte shembullin e tij, kudo e për çdo gjë. «Eh, sikur të dija gjysmën e asaj që di Pali! Për asgjë tjetër s'do të ëndërroja në botë. Sa shumë ditka ky Pali», — thoshte shpeshherë me vetë.

Dhe i ati mendonte se kushedi ç'dinte Dini nga ata librat. «Ashtu më paç uratën, ashtu, — dhe e puthte në ballë. — Njeriu pa gramë është si njeriu pa sy. Ai që nuk di të shkruajë e të lexojë, jeton kot», — i thoshte sa herë që vinte fjala. Dhe me të vërtetë, për shkollë e dije xha Tasimi kishte bërë përpjekje të mëdha, por ai s'kishte pasur mundësi ta shkollonte më shumë të birin, përveç se me dy klasë të mesme.

Dini vendosi ta pyeste, të thyente heshtjen e asaj nate, aty buzë vatrës.

— Me sa duket qenkeni ndarë keq nga mbledhja, baba.

— Lëre, mos e pyet, keq po venë punët, mor bir, — tha ai dhe hapi prapë kutinë e duhanit, drodhi cigaren dhe vazhdoi bisedën: — Na trulllosën sot. Duan të regjistrojnë ballistë edhe nga fshati ynë, po, se ç'do të bëjnë këta ballistë, dreqi e merr vesh, demek dreqi, se, me ç'dihet, ata, ia kanë hipur gomarit së prapthi.

— Po si u ndatë, ç'vendime u morën, — e pyeti Dini e i erdhi keq që s'qe ndodhur në atë mbledhje.

Ç'e pyet? Nga theva këmbën e vajta. Iu qepën Qerimit, të shkruhet që të shkruhet me Ballin. «Po dale, ore, pse të shkruhet me Ballin, — e mora fjalën unë që deri atëherë kisha heshtur. — Në doni të luftoni për këtë vatan, bashkohuni me partizanët. Ç'është kjo organizatë Balli Kombëtar që deri sot s'e ka shkrehur asnjëherë?!» Dhe Myrto Grenza filloi të më mbushte mendjen se Balli Kombëtar ishte ajka e popullit, se partizanët, ata zba-



tharakë, siç i quajti ai, qenkëshin të gabuar dhe se duhej përgatitur kundër grekut e serbit. Ai bam në të tijën e unë bam në timen. U ndamë keq. Por kur më tha babai i teqesë, Muharremi: «E do apo s'e do Shqipërinë?», më hipën xhëndet në tru dhe ia prita: «Shqipërinë mos ma zër në gojë. Po të mos e doja Shqipërinë, nuk luftoja me komitetin më 1913-1914. Unë jam kundër teje dhe zotit Myrto që më flisni si e ëmë e Zeqos majë thanës. Neve na ka hyrë ujku në vathë, ju thoni t'i kërkojmë gjurmët...». Më vinte ta kapja për mjekre e t'ia këpusja si të cjamin. Pa le, Myrtoja u xhindos fare kur dhe Qerimi ua përplasi në fytyrë.

E shoqja e xha Tasimit çori faqen.

Injoranca dhe vendi i «shenjtë», si e quanin teqenë, kishin bërë punën e vet me besimtarët. E ç'nuk të zinin veshët për teqenë: flitej se atje një të verbri i kishin ardhur sytë, një kurrizoje i qe drejtuar trupi, një i çalë kishte filluar të ecte mirë. Teqeja gumëzhinte si një koshere bletësh nga besimtarët. Ndaj dhe t'i kundërshtojte baibait konsiderohej si kundërshtim ndaj zotit.

— Si e paske prishur aq keq punën me njeriun e përrëndisë?, — i tha ajo e trembur, pastaj i hodhi një vështrim Dinit dhe mblodhi supet si me qederosje.

Dini ziente përbrenda.

— Sa mirë ia paske bërë, — i tha ai të atit, i cili i kishte sytë tek e shoqja që ishte zbehur.

Xha Tasimi e kuptoi frikën e saj dhe shtoi:

— Isaf, mua më kanë rënë kockat për vatanin tim e ai më thotë: «E do apo se do Shqipërinë». Na, të placin, t'i thuash. Për besë, sikur të isha vetëm, do ta zija për mjekre që të çuditëj bota. Le që siç ia ka hipur mushkës së prapthi, s'ka për të shpëtuar, jo! Dikush nga ju mund të thotë: Ç'pati ky Tasimi që mori flakë kështu?

Mora flakë, se kam një plagë të vjetër dhe, sa herë shoh baba teqenë, nis e më rrjedh. — Dhe xha Tasimit, që dikur kishte qenë besimtar i teqesë, iu mjegulluan sytë nga një ngjarje e largët dhe prapë heshti, aty buzë vatrës, e iu duk sikur po rishikonte dhe një herë atë që kishte parë vite të shkuara:

«— ... Aman, lëshomëni!, — kishte dëgjuar një klithmë nga dhoma ku babai «dëgjonte ankesat e besimtarëve të vet», «shëronte» dhe i «bekonte» ata.

Ai xha Tasimi, djalë i ri, asokohe i qe afruar dhomës së shenjtë dhe kishte qëndruar si i ngrirë në cep të saj. Atij as që i kishte shkuar mendja për të keq.

«Ta hap derën e të shoh se ç'bëhet?, — kishte thënë me vete. — Jo, — kishte kundërshtuar prapë veten, — nuk bën. Brenda është babai, kushedi se si është puna. Po të futem, prishet besimi». Dhe ashtu, mendueshëm, kishte dashur të largohej, por në çast kishte dëgjuar një klithmë e zhurmë tjetër, që afruar dhe qe struktur pas derës.

— Bijë e perëndisë, — qe dëgjuar zëri i babait. — Duro, vetëm kështu lahen gjynahet, qofsh e bekuar. Atë që kundërshton, e ndëshkon zoti.

Tasimi i ri e i fuqishëm s'kishte duruar dot, që ngritur dhe kishte vënë syrin në vrimën e çelësit.

Babai vështronte përmbi syze tamam sikur në botë të mos kishte tjetër njëri përveç atij. Dritaret e vogla linin të hynte një dritë e zbetë që i jepte dhomës një hije gjumëndjellëse.

Heshtje.

— Ç'është kjo, përse kundërshton?, — s'kishte duruar dot e kishte thirrur prapë babai i teqesë. Gruaja qe drodhur dhe nuk kishte dhënë asnjë përgjigje. Të dy kishin rënë në heshtje. Kishte kaluar një minutë. Babai ki-



shte ngritur sytë sikur t'i falej allahut. Gruaja i kishte kthyer kurrizin. Babai kishte sharë ashtu siç shajnë xhambazët e kuajve kur ndodhen përpara një mëzi të pabindur. Pastaj ai kishte dashur t'i mbushte mendjen duke i thënë se do të ishte një ditë e shënuar për të. Dhe, po të mos plotësonte dëshirën e njeriut të shenjtë, atëherë do të mundohej në sfilitje të përjetshme, në skëterrë. Gruaja kishte rënë në mëdyshje.

— Ç'mëkate ke bërë, o bijë e perëndisë, që i paudhi të shtyn të kundërshtosh njerëzit e shenjtë? Dëgjoje, bindju dhe përujtu njeriut të shenjtë. Dhe mos harro se je brenda në teqe, e cila s'bën gjë tjetër veçse i shpie besimtarët e saj në lumturi. Te ti lufton e mira me të keqen. Me kë do të bashkohesh ti? Me të keqen? Hajde, o bijë e perëndisë, mos kundërshto. Allahu i vë në provë njerëzit për të parë se në cilën udhë do të ecin. I paudhi e tërheq njeriun në mëkat, njeriu i perëndisë i flet të hapë sytë e të ecë në udhë të mbarë.

Babai i qe afruar, i kishte hedhur dorën, e kishte tërhequr pas vetes dhe kishte zënë ta përkëdhelte me zor.

Gruaja i kishte dhënë një të shtyrë. Qe dëgjuar një zhurmë akoma më e madhe.

— «Çfarë turpi?, — kishte thënë Tasimi me vete e ngaqë s'kishte duruar dot, kishte vendosur të hynte brenda. Në çast dera qe hapur dhe gruaja e re, e bëshme dhe e bukur, por e zbetë në fytyrë, sikur t'i kishte ikur gjaku, kishte dalë me rrëmbim. Ajo ishte e shoqja e Qerim Turkeshit, që s'kishte veçse disa muaj martuar.

— O perëndi, — kishte filluar të shfrynte ajo e kishte marrë frymë thellë sikur të kishte dalë në ajër. — Pse, për këtë maskarallëk kam ardhur unë në teqe? Qe mbështetur pas murit të korridorit dhe aty ia kishte plasur të qarit.

Tasimi i qe afruar dhe i kishte thënë t'i tregonte ç'kishte.

— Do të flas, do të them gjithçka dhe ti... ti e di vetë, — po s'mund të vazhdonte më gjatë, se nëpër qerrikë po i përpëliteshin lotë.

— Fol, pra, ç'të mundon kështu?! Fol pa drojtje!

Gruaja kishte marrë frymë thellë dhe sikur qe lehtësuar. Ajo dukej si një lule.

— Hë, pra, fol?, — i qe lutur Tasimi.

Ajo kishte ulur sytë poshtë, sikur t'i kishte rënë gjësendi.

— O perëndi!, — kishte thirrur ajo pas pak. — Nuk e besoja kurrë që njeriu i perëndisë, që mos qoftë, të mashtrrojë, të gënjejë në mënyrë kaq të poshtër e të turpshme! Ah, jo! Kjo s'është dëgjuar kurrë! Nuk e dija të ishte barbar, i pabesë dhe i shthurur gjer në këtë pikë! Njeriu i perëndisë paska në shpirt gjarprin!

Pa mbaruar mirë fjalën, kishte kërcitur dera e në korridor kishte dalë babai i tronditur. Në qafë i varej një gur hajmalic me një zinxhir të hollë prej argjendi, pa farë bukurie. Me dorën e majtë fërkonte mjekrën. Flokët i kishte të ashpër e të rrallë si qimet e barit në skërkë e sytë të egërsuar e të skuqur nga nervozizmi.

— Ja e paudha, — i kishte thënë ai një dervishi që po ngjitej shkallëve përpjetë. — U plaka dhe nuk kam parë e dëgjuar që besimtari të mos i bindet njeriut të perëndisë. Unë i thashë: «Shtrihu në këtë vend të shenjtë, ashtu siç bëjnë të gjithë besimtarët», kurse ajo u ofendua! E mori për të keq. Mallëkuar qofsh që nuk beson njeriun e perëndisë. Nxirre mëkatoren jashtë, — kishte urdhëruar ai dervishin mjekërthinjur veshur me të bardha dhe kishte ndukur gjoksin si i pikëlluar. Çallma jeshile bënte kontrast me ngjyrën e fytyrës dhe me mjekrën e bardhë që shtrihej krela-krela mbi gjoks.



Fytyra e babait herë zverdhej, herë nxihej. Në mes të vetullave i dukej një rrudhë si vijë uji. Tërë ajo hije madhështore që kishte pasur më parë kishte marrë fund. Tasimi që rrinte përballë gruas shikonte vetëm lëvizjet plot zemërim të babait, shikonte se si tundej hajmاليا mbi gjoks e çallma mbi kokë. Pastaj babai kishte ngritur kokën lart si për të treguar se me trup ishte atje, ndërsa me shpirt ndodhej atje lart, në qiell. Kishte filluar të murmuriste:

— Oh, — kishte rënkuar gruaja dhe, e shtyrë nga derishi, kishte dalë jashtë.

Babait i qe varur koka. Sytë i kishte gjak të kuq si të një qeni të tërbuar dhe, ndonëse ishte duke folur me përrëndinë, kishte ndjekur me vështrimin e tij të zilepsur hapat e hijen e gruas. Si qe larguar gruaja, babai qe shkëputur dhe nga perëndia e kishte folur gjithë inat:

— Dëgjo këtu, djalosh, dhe mbaj vesh mirë: vëri fre gjuhës e shiko se, po llape poshtë e përpjetë, në mos të çmendtë zoti, do të të çmend unë. Ik tani e mos u ndiej i gjallë e mua mos më dil përpara».

Tasimi do të kishte bërë gjullurdi të madhe për këtë ndodhi, por i vuri fre gojës vetëm e vetëm se ajo ishte gruaja e Qerim Turkeshit, gruaja e bashkëfshatarit të tij. Nga ajo ditë atij i rrëqethej mishtë kur shikonte babanë e teqesë, dhe gjithnjë i bënte bisht, për ja, në mbledhje qenë ndodhur ballë për ballë dhe ndodhi ajo që ndodhi. Të gjithë në shtëpi i mbajtën iso heshtjes së plakut.

— E paske ndezur keq me babanë, — s'duroi e tha e shoqja pas pak.

— Nuk munda të hesht, oj grua, — mori zjarr prapë xha Tasimi. — Si, moj, të ngrihet babai i teqesë e të thotë se qëndrimi që mbaj unë dhe djali im është antishqip-tarizëm dhe kundër fesë? Epo hajde duroje, të kam rixha.

S'durova e i thashë në sy të të gjithëve: «Mbylle atë kamare, se të bëj atë që s'ta pret mendja, pa le të jesh baba teqeje!». Ja, kështu i thashë. Duhet të kisha thënë dhe më shumë, — psherëtiu xha Tasimi dhe kërkoi prehje në sytë e të birit, Dinit.

— Po ti ç'thua, bir?

— Tani fshati u nda më dysh, — iu përgjigj Dini. — Thika ka arritur në palcë.

— Fshat i lig, — e ndërpreu xha Tasimi dhe e hoqi fjalën zvarë.

— Këtu nuk është punë fshati, i mirë apo i lig... Nuk duhet të ngatërrojmë fshatin me disa njerëz...

— Puna është se u përçamë, ta marrë djalli, ta marrë, — tha xha Tasimi e psherëtiu thellë siç mund të psherëtitë njeriu i lodhur e plot brenga jete.

— S'do mend që u përçamë! Ata me okupatorët e ne me Partinë Komuniste, — e mori fjalën Dini për ta qetësuar të atin.

— Po mirë, kështu do të mbetet ky fshat, i përçarë?!, — pyeti xha Tasimi dhe vetullat iu shembën rëndë mbi sy.

— Tani për tani kështu do të mbetet derisa të kuptojnë, — iu përgjigj Dini.

— Në djall të venë, — shfryu xha Tasimi, — nejse, sido që të bëhet, sido që të ndodhë, ne me Partinë do të qëndrojmë. Asaj i kemi dhënë fjalën.

Dini qeshi.

— Pse qesh?, — pyeti i habitur xha Tasimi.

— Po këtu nuk është puna se kemi dhënë fjalën, baba, — e ngriti zërin Dini, — po pa Partinë asgjë s'mund të bëhet. Ne do të ishim ashtu siç ishim. Do të rrinim si thëngjilli në hi. Ai nuk do të shuhej, por edhe flakë s'kishte për të marrë kurrë...



I ati mbeti gojëhapur përpara këtyre fjalëve që ai i tha me aq siguri, me aq bindje dhe me aq qartësi. Nganjëherë Dini i thoshte dhe ca gjëra që xha Tasimi s'i kuptonte, por që e ndiente dhe e shihte se ishte e drejtë.

— Tani i ke rënë më të, të pastë babai, të pastë, — tha dhe e kapi të birin për qafe, ia mbështeti kokën në gjoksin e tij dhe e ndjeu se kishte bërë gabim që kishte heshtur kaq e kaq vite.

## KAPITULLI V

Në fshat kishte ardhur nënprefekti, zoti Fate Ymeri. Ai ishte veshur me një kostum gri dhe në kokë kishte ngjeshur një republikë në të njëjtën ngjyrë. Fatja e Myrtoja ishin njohur që në Itali, kur qenë studentë. Fate Ymeri në Fakultetin e Drejtësisë, ndërsa Myrto Grenza në atë të Agronomisë. Që të dy thuhej se ishin agjentë të OVRA-s. Ata ishin ulur në oborrin e shtëpisë nën hijen e një arre të madhe e po bisedonin. Fshati Lenicë shtrihej përfund malit Grano, në një vend të sheshtë, rreth e përqark me kodrina të bukura e të pyllëzuara. Ai kishte katër lagje. Një lagje e ndante një përrua i vogël, po, kur binin shirat dhe shkrihej dëbora, ai fryhej tej e përtej dhe shpeshherë bëhej i rrezikshëm. Toka e fshatit ishte pjellore, por pjesën më të mirë dhe më të madhe të saj e zotëronte Myrto Grenza. Banorët e tjerë të fshatit nuk e siguronin bukën e vitit. Shtëpia dykatëshe e Myrto Grenzës, e mbuluar me llamarinë, me dritare të mëdha, me oborr të thurur me avlli të larta shquhej e zotëronte mbi gjithë shtëpitë e tjera të fshatit, që shtriheshin djathtas, majtas e mbrapa saj, shtëpi përdhese, të mbuluara pjesërisht me kashtë e pllaka guri dhe që dukeshin sikur kërkonin t'i bënin ballë një kërcënimi që u kanosej vazhdi-



misht. Edhe tymi që dilte nga oxhaqet sikur dëshmonte për varfërinë e tyre.

Myrto Grenza fliste gjithnjë me zë të lartë. Duke biseduar në mënyrë shumë të përzemërt, morën rrugën për në bahçe. Kështu bënte gjithmonë Myrtoja me miqtë e rrallë, i shpinte në bahçen e tij të madhe përpara shtëpisë, e cila përfshinte disa dynymë tokë. Atje Myrto Grenza kishte mbjellë lloj-lloj pemësh. Pjergullat e ngritura me listela mbulonin pothuaj tërë sipërfaqen. Thuhej se vetëm me të ardhurat e asaj bahçeje mund të jetonte i gjithë fshati.

— Ja, kjo është bahçja ime, — tha e tundi kokën në shenjë mburrjeje duke vështruar mollët, dardhët e kumbullat që atë vit ishin ngarkuar jashtë masës.

— Me të vërtetë paske bahçe të madhe, — u çudit nënprefekti.

Me lëvizjen e vetullave dhe të hundës Myrto Grenza siç dukej shprehu se ishte i një mendjeje me të, por s'tha asnjë fjalë në përgjigje të mikut.

— Pasuri e madhe, — shtoi pas një pauze të shkurtër nënprefekti, — ke punuar me mend!

Myrto Grenza u kënaq edhe më shumë nga fjalët, me të cilat miku vlerësoi bahçen. Nxori nga xhepi një kuti cigaresh, e hapi dhe ia zgjati nënprefektit. Të dy zunë të thithnin cigaret e nderura, ndërsa sytë u mbetën te degët e mollëve, të dardhëve, kumbullave e hardhive që vareshin deri poshtë. E ashtu të dy qëndruan pranë njëri-tjetrit si të humbur në mendime.

Më në fund nënprefekti u kthye nga Myrtoja e, duke vazhduar bisedën e lënë përgjysmë, pyeti:

— E, keni zbuluar gjë?

— Asgjë, — u përgjigj Myrto Grenza dhe psherëtiu në shenjë keqardhjeje. — Por jam i sigurtë, — vazhdoi ai,

— se, në këtë çështje, duhet të ketë gisht dhe Din Kurti? Ndoshta dhe ndonjë tjetër.

— Dinë të fshihen qerratanjtë, dinë, — e ndërpreu nënprefekti si për të paralajmëruar Myrton. Thithi përsëri cigaren e vazhdoi: — Po më të zotë e më dinakë janë ata që i pregatisin, ndaj duhet të kapim fillin. Vetëm duhet kujdes, punë e dinakëri.

Kjo vërejtje nuk i pëlqeu Myrto Grenzës, i cili u vrenjt në fytyrë, hoqi cigaren duke nxjerrë tym nga hundë, e hodhi përtokë dhe e shkeli me këmbë.

— Ju mendoni se unë s'kam qenë aq sa duhet i kujdesshëm?, — pyeti Myrto Grenza duke i dhënë fytyrës një shprehje zemërimi e fyerjeje.

— Nuk e thashë me atë kuptim, — iu kthye nënprefekti dhe bëri buzën në gaz që të mos e zemëronte Myrton. — Po ja që komunistët po veprojnë nën hundën tonë. Dhe në këtë duhet ta pranojmë. Komunistët çdo ditë sikur po shtohen, çdo ditë po veprojnë. Fjalët e Tasim Kurtit ishin fjalë komunistësh. Ata kudo kanë jatakët e tyre. Ku jetojnë e ku hanë ata?! Ja, bie fjala për atë dobiç dobiçin Pali Duron, hija e tij vërtitet si fantazmë kudo. Edhe nëpër Lenicë. Bile thuhet se vjen dhe në qytet! Por s'ka faj ai, fajet i kanë ata kopukët tanë që s'c siguruan si duhet kur e arrestuan e ai gjeti rastin e na bëri glasën. Dhe hajde fol tani të kam rixha.

— Ne jemi, si i thonë fjalës, një vrap pele larg qytetit... Kush guxon të livadhisë si t'i dojë qejfi nëpër Lenicë?!, — pyeti Myrto Grenza për të larguar dyshimet e nënprefektit.

— Ata janë të guximshëm, — nguli këmbë nënprefekti. — Do të vijmë ndonjëherë papritur e s'është çudi të na nxjerrin nga shtëpia në brekë, jo këtu në Lenicë, por edhe në qytet.

— Vërtet, të guximshëm janë, por mua s'ma ha men-



dja të vënë kokën në rrezik. Vetëm në kanë vendosur të lënë kockat.

— Përderisa kanë dalë malit, kanë vendosur edhe të lënë kockat. E ç'do të humbasin ata? Dje më lajmëruan se kishin dezertuar disa ushtarë dhe kanë kaluar këtej nga Lenica.

— Mirëpo ku e gjejnë këtë forcë e guxim xhanëm! Vallahi për të luajtur mendsh është, — tha Myrtoja e përplasi grushtin mbi parmak të verandës.

— Mos e bëj djallin më të zi se ç'është, — zgjodhi fjalët nënprefekti, e, për t'ia ngarkuar barrën Myrtos, u detyrua të zbuste rrezikun e komunistëve. — Nejse, dhe ne s'jemi të dobët, s'jemi vetëm. Kemi goxha Itali përpara, pengesat do të sheshohen, çrregullimet do të rregullohen. Kjo që të ruajmë se kush lëviz e ç'thonë s'është gjë fare. Neve na presin beteja më të vështira, më të rrezikshme. Dhe do t'ua thyejmë kokën. Apo s'është kështu?

— Ja, kësaj i thonë punë me mend, — tha Myrto Grenza, — por, siç e thatë dhe vetë pak më parë, duhet të kalohet në masa praktike qoftë edhe sikur të mos qëllojmë në shenjë. Raprezaljet kanë edhe ato efektin e tyre. Si të themi, druri ka dalë nga xheneti. Veç me mend në kokë. Hidh gurin dhe fshih dorën. Italianët përpara dhe ne mbas tyre.

Nënprefekti shtrembëroi pak buzët, thithi për të fundit herë cigaren dhe e flaku tutje. Fytyra e tij e zeshkët dhe e gjatë u mblodh.

— Drejt e ke! S'ka kuptim të qëndrojmë akoma në pritje e me duar kryq. Unë kam folur me kapiten Barxollën dhe nesër ose pasnesër do të ndërmarrim një operacion ndëshkimi në ato fshatra që janë kthyer në jatakë të komunistëve. S'kemi ç'të presim më. Parrullën e Divisionit Venecia e fshinë. Dje në mbledhje për regjistrim me Ballin u ndamë më dysh, traktet po valojnë, komu-

nistët hyjnë e dalin nëpër fshat si në shtëpinë e tyre. Edhe në Lenicë do të vijë karabinieria e të shkretojë shtëpinë e Kurtëve dhe të ndonjë tjetri që ju e shihni të nevojshme, kurse atë të birin e Tasimit, Dinin, i cili është parë të lëvizë dhe në qytet, do t'u them ta varin në rrugë në mes të pazarit që ta hanë grenzat.

— Kjo duhej bërë më parë, — e ndërpreu Myrto Grenza dhe i ndritën sytë nga gëzimi. «Tani më erdhi dita t'ia marr arën Tasim Kurtit», — mendoi. — Domethënë nesër ose pasnesër, ë?, — tha i gëzuar e ngriti zërin sikur bashkëbiseduesi të ishte shurdh nga veshët.

— Po, — dhe nënprefekti ngriti gishtin në shenjë paralajmërimi. Veç mengadalë, — këshilloi shoku, — mos bërtit kështu e askujt mos i thuaj asnjë fjalë, bile as njerëzve tanë më të besuar. E keqja është se ne murmurisim shumë me njëri-tjetrin dhe kjo na ka dëmtuar rëndë. Është koha që duhet të heshtim më shumë se kurdoherë tjetër, sepse aty ku ka zë dëgjojnë jo vetëm muret, por edhe drurët jashtë. Komunistët kanë njerëzit e tyre, lidhjet e tyre. Pa dale, se s'të kam pyetur ndonjëherë, ky punëtori yt që ma dërgove pardje me atë plaçkën është njeri i sigurtë dhe i besimit?

— Cili? Veloja? — Për një çast Myrto Grenza heshti, pastaj vazhdoi: — Ku merr vesh ai nga politika!, — dhe tundi dorën si për të larguar atë dyshim. — Veloja është si Raxhoja.

— Si kush?

— Si Raxhoja, qeni që ruan bahçen. Njanjëherë i ngatërroj të dy. Njëherë i thirra Velos me këtë emër.

— E ai, ç'tha, ç'bëri?

— Hiç, ktheu kokën, dëgjoi porosinë e vajti dhe e kreu.

Të dy ia dhanë të qeshurit.



Veloja s'i kishte mbushur të dyzetat. Ai ishte nga fshati Pulah i Korçës. Në shtëpi kishte një vajzë 12-vjeçe, nënën plakë dhe një djalë që një vit më parë ia kishin marrë ushtar. Qysh të ri e kishin sfillitur hallet. Veloja ishte isi zog, sot këtu e nesër atje. Qe endur poshtë e për-pjetë, por asgjëkund dhe tek askush nuk kishte gjetur punë që të hante për vete e t'i tepronte diçka për të çuar në shtëpi. Ai qe lodhur e kapitur duke bredhur me ditë të tëra nëpër qytet. Kudo që vinte, i jepnin të njëjtën përgjigje: «S'ka punë». Ku të shkonte, kujt t'i drejtohej? Po të kishte në xhep paratë e udhëtimit, do të ishte larguar nga vendi, nga fëmija, megjithëse çmendej nga malli për ta. Do të kishte shkuar larg, shumë larg, ashtu siç kishin bërë dhe shumë të tjerë. As vetë nuk e dinte se ku. Qoftë edhe prapa diellit apo hënës, mjafton që të gjente punë. Dhe ja, atë ditë kur Veloja qe kthyer në shtëpi dhe gjithë bota i dukej shkretëtirë, gruaja e tij i kishte sjellë në jetë fëmijën e tretë. Si do të bënte për ta ushqyer fëmijën e gjirit? Sikur gruaja të mos i lindte fare, ai do ta ndiente veten të lumtur. Por ja që ajo i lindi. Fëmija i solli brengë të reja në shtëpi. Fill pas lindjes gruaja s'ishite në gjendje të kthente kokën nga fëmija që qante pa pushim. Ajo ua kishte ngulur sytë pa ndjenja trarëve të shtëpisë dhe priste vdekjen. Veloja e kuptoi se gruaja ishte në agoni dhe në kulmin e dëshpërimit i erdhi ideja e vetëvrasjes. «T'i jap fund jetës dhe të shpëtoj një herë e mirë nga të gjitha vuajtjet», — mendoi, por e ndalën sytë e vegjël dhe të përbotur të dy fëmijëve të tjerë dhe të nënës plakë. Si duket edhe ata e kuptuan që e ëma do t'u vdiste dhe se këtej e tutje s'kishte njeri tjetër kush të kujdesej për ta, përveç Velos. Ata kishin dy ditë që s'kishin vënë në gojë asnjë kothere bukë dhe Velos i therte në ze-

mër. Dhe ja, pas dy ditëve, mbas vdekjes së gruas Veloja qe pajtuar hyzmeqar te Myrto Grenza. Eh, ç'luftë kishte bërë ai për të rritur ata fëmijë të vegjël!

Veloja ishte i pashëm, fjalëpakë dhe dukej sikur nuk ua vinte veshin të tjerëve kur flisnin ose pëshpërisnin. Nuk kishte shkollë, por ishte shumë i zgjuar. Shkrim e këndim kishte mësuar nga një punëtor i gurores, i cili dalngadalë filloi t'i fliste Velos edhe për shumë gjëra të ndaluara, të cilat Veloja i ndiente por nuk dinte se si mund të shpëtonte prej tyre.

Myrtos i kishte pëlqyer Veloja dhe ai shtirej sikur e trajtonte si njeriun më të afërt të tij. Dhe ja, një ditë i kishte hapur barkun kundër Tasim Kurtit dhe të birit, Dinut. Myrtoja e «donte» Velon dhe sepse ai ishte punëtor i madh. «Pa Velon nuk mbahet dot kjo shtëpi me këtë gjë të gjallë dhe tokë që kam unë». — I thoshte këto fjalë sa herë i binte rasti.

— Po i biri i tij është në burg ama, — i tha nënpre-fekti mbas një heshtjeje.

Veloja ndjeu një të rrëqethur me të dëgjuar të flitej për të birin. Nga sytë i rrodhën lotë. Çështja e të birit e kishte merakosur së tepërmi. Ai ndiente mall të madh. Në kokë i zienin gjithë ato mendime të fshehta e plane të rrezikshme për të shpëtuar të birin. Për një kohë sytë i mbajti të mbërthyer diku në një pikë sikur atje të ishte shkruar ose po shkruhej se çfarë duhej të bënte.

— Po, — iu përgjigj Myrtoja, — veçse ai nuk është futur për politikë. Seç ka bërë djalli ca budallallëqe në ushtri dhe e kanë futur në burg. Më duket se për rrahjen e një nënoficeri italian. Seç e kishte sharë dhe ai ia kish-te përveshur turinjve, por shyqyr që s'e vrau! E ka ters të madh atë djalë. E njoha mirë edhe atë, se erdhi e punoi disa behare me radhë tek unë, para se sa ta merrnin ushtar. Edhe Veloja është një çikë gjaknxehët. Po e shkele



në kallo, gjëmën të bën, po është i drejtë dhe i ndershëm sa s'ka ku të vejë, ja, i tillë është ai. Apo s'këndon bukur qerratai, bilbil është, bilbil. . .

— Nuk është kjo e tëra, jo, — e ndërpreu me bindje nënprefekti. — I biri në ushtri u përzie edhe me punët e fshehta të komunistëve; por s'jemi ne të zotë të zbulojmë, dhe ata e dënuan vetëm për rrahje e fyerje të një graduati me dy vjet burg.

— Mund të jetë edhe kështu, — pranoi Myrto Grenza, — por te Veloja kam besim të madh dhe s'kam vënë re asgjë të dyshimtë. Ai ka mbi gjashtë vjet që punon tek unë. E ka mbajtur barkun e fëmijëve me bukë vetëm nga lëmoshat e mia. Ehu, sa herë është grindur me qentë për kockat, copat e bukës dhe të mishit, të hedhura nga të tjerët. Ndaj dhe nuk e harron Veloja të mirën dhe nderin që i kam bërë unë. . .

«Ama të bukur nder», — tha Veloja me vete dhe u krcdh në mendime.

*I ziu që kur kam lerë,  
h'yzmeqar derë më derë,  
në agallarë e bejlerë,*

I erdhën ndër mënd vargjet e një kënge e këndoi me mend pa zë.

Veloja kishte kohë që kishte rënë në prehrin e mendimeve. Diçka në brendësi të tij ishte thyer. Kishte kohë që një ndjenjë drobitjeje dhe vetmie e mbështillte gjithnjë duke mos e lënë të qetë. E megjithatë ai ende jetonte si një njeri i qetë, i urtë dhe i përlulur. Sidoqoftë në një kohë kur ishin pa punë gjithë ata njerëz, ai kishte punë dhe hera-herës vinte në shtëpi e u shpinte nga një qeskë me bereqet e ua zinte frymën fëmijëve me bukë. Dhe kjo e kënaqte Velon. Ditët dhe netët kalonin me ra-

dhë si ngahera. Veloja rronte në mes të njerëzve që atij i dukeshin seriozë, të qetë e zemërmirë. Veloja i përulej fatit, siç kishin bërë që në kohët më të lashta shumica e njerëzve, pothuajse pa bërë asgjë për të ndryshuar gjendjen, pranonte fatin që i ishte caktuar qysh në ditën e lindjes, u bindej dhe u përulej bejlerëve, sepse kështu ishte thënë dhe shkruar nga zoti, ashtu siç kishin jetuar dhe jetonin shumica më e madhe e njerëzimit. Puna e mbante lidhur me disa zinxhirë të padukshëm. Ai që munduar të sqaronte ç'ishte kjo gjë që e mundonte, por më kot. Këto ia kishte thënë Dinit një ditë. Dinit i pëlqente dhe s'kishte kënaqësi më të madhe sesa të bisedonte me njerëzit, i pëlqente të dëgjonte historitë e jetës së tyre, ankimet, telashet dhe hallet e tyre. Por edhe Velos ia kishte ënda të mësonte e të dëgjonte fjalë të tilla që i hapnin sytë e i tregonin të vërtetën. Përpara syve të tij hapej tabloja e qartë e jetës njerëzore. Por nga pak Veloja kishte filluar të kuptonte dhe ndiente në kurrizin e tij synimin e poshtër për ta mashtruar njeriun, për ta mjellë e për të nxjerrë prej tij sa më shumë fitime. Dhe ai kishte filluar të mos pajtohej me këtë gjendje poshtëruese. Atij po i hapeshin sytë dhe në shpirt po i ndizej një flakë e pashuar. «Përse të jem kështu?, — pyeste veten e kërkonte të mbrohej në mes të një dëshpërimi të pafund. — Kështu duhet! Skllavi i parmendës, i arës, i kazmës e i lopatës së Myrto Grenzës. Pse të rropatem pareshtur nga mëngjesi deri në mbrëmje? Vetëm për një kafshatë bukë, pa u çlodhur kurrë, veçse në gjumë! Ç'jetë e mjeruar, poshtëruese! S'të lënë të flasësh, të këndosh, të këndosh e të thuash atë që të do zemra. Pse të mos jem dhe unë si të tjerët? Nejsë, s'jam vetëm. Si unë ka plot, me qindra, me mijëra. Hej, drej o punë». Dhe kështu ai ulte kokën e punonte e, ngaqë i dukej sikur ishte në fund të një humnere të errët e të thellë, e kujtonte me hidhërim tërë jetën



që kishte kaluar. «Pse të mos ngrihemi, t'i shtypim ata dhe kështu merr fund fukarallëku? Apo kështu është shkruar? E, botë, botë, si të kanë ndërtuar, fare anapolla! Të mbyllësh gojën, të shtrëngosh rripin, i varfër përgjithmonë! Kështu është shkruar», — thoshte e ngaqë nuk dinte ç'qëndrim të mbante ndaj këtyre ndjenjave e mendimeve që binin në kundërshtim me njëri-tjetrin, ulte kokën e vetëm punonte. Bile nuk mendonte as për lodhjen. E harronte atë, ashtu si harronte numrin e ditëve, të muajve e të viteve që punonte te Myrto Grenza. Biseda me Dinin, arsye-timet e tij me jetën dhe mbi vuajtjet njerëzore, mbi okupatorin i kishin lënë Velos një përshtypje të pashlyer. Kjo kishte bërë që ai ta donte shumë Dinin. I pëlqente të folurit e tij të qetë, e ajo dashuri që ai ushqente për të tjerët si edhe këshillat e tij fare të thjeshta. Dhe pas këtyre bisedave Veloja kishte menduar gjatë si atëherë kur punonte në gurore e dëgjonte fjalët e Aliut, të cilat ai për një kohë të gjatë pothuajse i kishte lënë në harresë, në fund të mendjes së tij të drobitur nga lodhja, nga pasiguria, nga ajo nevojë e domosdoshme e sigurimit të një copë buke për fëmijët që kishte në shtëpi, larg. Po jeta bënte të sajën dhe ja tani fjalët e Dinit e bënë Velon që të çohet më këmbë dhe ta ndiente veten përherë e më të fuqishëm. Sido-mos nga leximi i trakteve, Velos i qe ngrohur zemra, i qe në hapur sytë dhe e kishin mbushur plot me dritën e së vërtetës. Ndiente zjarr përbrenda. Tani fjalëve: «I ziu që kur kam lerë, hyzmeqar derë më derë. . .» kishte filluar t'u jepte një kuptim tjetër, atë që duhej, edhe kur punonte në arë, edhe kur mbante pleh, kur korrte grurë, bar e jonxhë, kur vilte misër, rrush kumbulla dhe mollë. Në ditët dhe javët që rrodhën më vonë ai dëgjoi për dhjetarët që ishin përzënë nga fshatrat, për depo të shqyera, për marrjen e bereqetit dhe ndarjen e tyre të varfërve nga partizanët dhe ilegalët, për atentate kundër spiunëve dhe nje-

rëzve të shitur te fashizmi, dhe i kishte thënë vetes: «Kurse unë rri mënjanë e shtoj pasurinë e Myrto Grenzës». Nga ato pak gjëra që kishte dëgjuar e mësuar e ndiente se njëkohësisht me luftën që kishte filluar kundër fashistëve okupatorë e tradhtarëve të vendit do të sillte dhe shpëtimin e tij. Pastaj iu kujtua se dikur Dini, duke ngritur gishtin tregues të dorës së tij të djathtë sikur do të paralajmëronte për diçka, i pat thënë: «Myrtoja është i pasur dhe këtë pasuri ai e ka vënë nga puna dhe djersa e të tjerëve. Ja, bie fjala edhe nga ti. Ja pra si është ndërtuar bota, e cila duhet përmbysur». Velos në fillim i dukej si diçka e pamundur që të përmbysesh çdo gjë që ishte ndërtuar së prapthi. Një botë e tërë mendimesh gjemonte e ziente brenda tij. Ato kishin lëshuar rrënjë të thella.

Në hijen e pemës Myrto Grenza e nënprefekti vazhdonin bisedën. «Dhe unë me këto mendime», — tha me vete Veloja e u mundua të dëgjonte se ç'do të thoshin ata.

— Ashtu, ashtu, — e ngriti zërin nënprefekti, — por mos harro se pikërisht komunistët këtyre si Veloja yt po u turbullojnë mendjen për një jetë më të mirë, ku të gjithë të kenë, ku të gjithë të jenë të barabartë, si beu dhe harbuti. Komunistët synojnë të bëjnë për vete në radhë të parë punëtorët, sepse ata përbëjnë kockën e Partisë Komuniste. Kujto parullën e bolshevizmit ndërkombëtar: «Punëtorë të të gjithë vendeve, bashkohuni».

— Ai nuk di gjë tjetër, veçse punë dhe vetëm punë, — e ndërpreu Myrtoja, të cilit nuk i pëlqente t'ia shanin Velon, i cili bënte pothuaj gjithë punët më të vështira.

— Po, të gjithë ata që merren me këso punërash janë punëtorë të mirë e të kujdesshëm, fjalëpakë. Ku dihet, dhe aq besim nuk i duhet dhënë, ki kujdes, — e këshilloi nënprefekti.



Në fjalët e tij Myrtoja vuri re një notë të lehtë kërcënimi që e bëri të mendohej seriozisht.

— Ju i dini më mirë këto punë, zoti nënprefekt, — filloi të fliste pas pak Myrto Grenza. — Sytë tuaj janë më të mprehtë se tanët. Ju e shikoni si në pëllëmbë të dorës edhe atë që është larg, edhe atë që është afër. Dhe s'ka se si të jetë ndryshe. Juve ju kanë ngarkuar detyrën e nderit që të siguronit qetësinë e tërë krahinës. Dhe, nëse ne e ndiejmë veten të qetë në shtëpitë tona, këtë ju detyrojmë juve dhe vetëm juve.

Nënprefektit iu bë qejfi, ndaj dhe i hodhi dorën në sup Myrtos.

Të dy qëndruan pak kohë në heshtje. Biseda nuk ecte; një e dy ndërpritej. Nënprefekti shtrëngoi nofullat dhe vështrimin e tij të vrenjtur e të palëvizshëm e fiksoi në drejtim të shtëpisë së Din Kurtit. Ndezi dhe një cigare tjetër. Pastaj e kaloi bisedën në çështjen e të dhjetave. Edhe në fshatra të tjera kishin hasur në kundërshtime, por Veloja tanimë s'e kishte mendjen atje. «Bjerini legënit, bjerini», — thoshte ai me vete dhe humbi në mendime të tjera.

Mbasi hëngri drekë, nënprefekti u largua për në qytet. Pasdite Myrto Grenza i hipi kalit dhe tha se do të shkonte për një punë në fshatin Bërdushë. Në goftë se do të mbaronte punë, do të kthehej në mbrëmje vonë. Me t'u larguar Myrtoja, Veloja qëlloi të vinte vërdallë nëpër kopsht duke u munduar të gjente rrugë shpëtimi për Dinin. «Nesër në mëngjes karabinierët do të vijnë në Lenicë, do të futen në shtëpinë e Dinit e do ta djegin. Ndoshta mund ta kapin dhe atë. Sa e tmerrshme!». Veloja u drodh i tëri dhe zuri kokën me të dyja duart, sikur kjo do ta shpëtonte nga kjo andrrallë. Ai nuk donte të besonte se karabinierët do të kapnin Dinin. Ai kishte dëgjuar se të arrestuarit, mbasi i torturonin, i internonin ose i pushkatonin. Me

siguri kështu do të bënin edhe me Dinin, në mos më keq, do ta varnin te sheshi i pazarit.

Veloja vështroi edhe një herë rreth e rrotull dhe mendohej të shkëputej nga ky mendim që po e torturonte, por më kot. Mos ishte më mirë të vente që tani e t'ia thoshte të gjitha Rustemit dhe ai ta këshillonte se ç'duhej të bënte? Me një lëvizje të dorës Veloja sikur deshi t'i largonte të gjitha ato mendime. «Jo, jo, — tha Veloja me vete. — Me t'u errur, kur të bjerë Myrtoja në gjumë, do të vete te Dini e do t'ia them të gjitha. Tani nuk bën të më shohin që të vete tek ai. Myrtoja do të dyshojë për mua, kur plani i tyre të dështojë, të mos e kapin dot Dinin». Sa më shumë kohë që shkonte, aq më shumë shqetësohej Veloja. Në rrugë fshatarët që vinin prej fshatrave të ndryshme tregonin për shtëpi të djegura e për familje të internuara. Dhe ja tani këto do të ndodhnin edhe në fshatin Lenicë.

«— Jo, kurrë», — tha Veloja e, ngaqë nuk rrinte më dot në kopsht, u nis për në shtëpi e u ul në shkallët e jashtme e aty ndenji, aty priti sa të errej për të lajmëruar në fshehtësi Dinin. Rrinte i heshtur e mendonte copa-copa jetën e tij që i kishte vajtur ashtu e hidhur e larg njerëzve më të dashur, nënës e fëmijëve të tij. Që nga shkallët e shtëpisë ku qe ulur dukej fare mirë se si binte ngadalë dhe e rëndë mbrëmja, se si mbylleshin dyert e zhdukeshin ngadalë ato zhurma jete. Veloja kishte humbur në atë buzënatë e nuk ndjeu fëshfëritjen e fustanit të zonjës së shtëpisë, gruas së Myrtos, Balit, e cila i kaloi nëpër këmbë shërbëtorit dhe e pa me bisht të syrit me atë inat të vjetër. Veloja bëri sikur nuk e pa. «Këta janë qelbur kokë e këmbë, e ç'do të presësh nga këta», — tha Veloja me vete dhe kujtoi me neveri atë histori të largët. ...

«— Velo! — thirri ajo, kur ai kaloi mengadalë për-



para derës së saj atë buzëmbremje, ja si kjo e sotmja, vite të shkuara.

— Urdhëro!

— Eja këtu!

— Erdha, — tha Veloja e hyri në dhomë me një ndjenjë habit. Ai qëndronte i qetë në këmbë. Bali për një kohë të gjatë e kishte shikuar Velon me mospërfillje, kurse tani e thërriste në dhomën e gjumit.

Ajo me ata sytë e zinj si qymyri e kapi Velon për dorë dhe e uli te cepi i krevatit. Ajo ishte tridhjetedyvjeçe, me trup të bëshëm dhe mjaft tërheqëse. Atë ditë ishte fill e vetmë. I shoqi kishte shkuar në Tiranë për t'u vizituar të mjeku; kurse të dyja vajzat i kishte dërguar tek e motra në Korçë. Veloja priste me padurim se ç'do t'i thoshte. Tek e shikonte, fytyra eshtake dhe e lëvizshme e tij pasqyronte ndjenja të ndryshme: frikë, druajtje, zemërim e turp.

— Afrohu, mos rri kështu si i ngrirë!, — filloi të fliste Bali. — Sot, s'kam qenë hiç mirë, më ka dhembur koka gjithë ditën...

— Je sëmurë?, — ia preu Veloja, e vështroi me bisht të syrit dhe u skuq pak në fytyrë. Kushdo që të ishte, po ta shihte atë fytyrë të ëmbël me sy të mëdhenj, me ato buzë të plota, me atë trup të drejtë, do të ishte turbulluar.

— As unë nuk e di se si jam kështu, — i tha ajo dhe i kapi dorën Velos dhe ia shtrëngoi me të dyja duart.

Sytë e Velos morën një pamje të rreptë, të turbullt. E vështroi zonjën me druajtje. «Po kjo, ç'djall të ketë kështu?!» — tha me vete duke u munduar të gjente shkakun e këtij ndryshimi të madh të zonjës që më parë nuk e përfillte.

— Ç'deshe?, — e pyeti Veloja dhe e tërhoqi dorën si me rrëmbim. Mendja i vente vërdallë, por e përmbajti veten. Ai as që e mendonte kurrë një gjë të tillë dhe për një çast e kishte humbur pusullën.

— Dhe tani dëgjo këtu, Velo, se s'ta kam qarë ndo-  
njëherë hallin, — filloi të fliste Bali. — Fjala që kam bur-  
rrë... Ai ka vite që më ka tradhtuar. Ai një e dy shkon në  
Tiranë. Mua më thotë se vete për t'u vizituar te mjeku,  
se vuan nga stomaku, por nuk është e vërtetë. Ai shkon  
atje, se ka ca italiane. Ka dhe një dashnoren e tij që kur  
ka qenë student në Itali. Ai dhe këtu ka dashnore ka...  
Ja, i tillë është Myrtoja im, që e shpëlaftë mortja. Pastaj  
e c' thuaj se kam burrë! Burrë sa për emër!

— Pse, për këtë më thirrë?! — ia preu përsëri fjalën  
Veloja. — Hajde, thuaj ç'ke për të më thënë, se nuk kam  
qejf që dëgjoj gjëra të tilla. Unë jam shërbëtori juaj dhe...

Po Bali nuk e la të fliste, iu afrua aq afër, sa Veloja  
u hutua nga parfumi që i ra në fytyrë, u tremb e u rrë-  
qeth kur mendonte se mund të bënte një hap të gabuar.  
Bali kishte përkulur pak trupin tek rrinte ndenjor në anë  
të krevatit dhe mendohej duke mbajtur njëren dorë te  
buzë e poshtme. Qëndronte në atë mënyrë që gjoksi i saj  
spikaste nën këmishën e hollë, po sytë e Velos qenë mje-  
gulluar. Bali donte që Veloja të ishte agresiv pa thënë  
ajo asnjë fjalë, mjaftonte vetëm që qëndrimi i saj të ishte  
një nxitje për veprim. Veloja i hutuar nga ç'po ndodhte,  
largoj sytë nga zonja e pa një mace të bukur, të zezë, me  
sy të gjelbër, që rrinte në fund të shtratit.

Bali, si e pa që Veloja qëndronte i heshtur si gur va-  
rri, vazhdoi:

— E kam dëgjuar me veshët e mi kur Myrtoja u tre-  
gonte shokëve të tij me shumë kënaqësi e me mburrje  
mrekullitë që kishte kryer natën rrëzës së mullarëve me  
bar të thatë, në livadhet me atë italjankën... Ai di t'i tre-  
gojë bukur aventurat e tij..., — shtoi Bali as e qetë, as  
e revoltuar.

A nuk ishte kjo një thirrje për veprim? Veloja qën-  
dronte i hutuar dhe ishte gati të dilte nga dhoma me vrap.



Lëvizni që të ngrihej e të ikte, po zëri i Balit e gozhdoi.  
— Të lutem mos e tepro me këtë qëndrimin tënd të ftohtë. Ti mund ta kalosh kohën si të të dojë qejfi! Je apo s'je burrë!?

Velos i hipi gjaku në kokë.

— Mos u çmende?!, — thirri dhe u ngrit në këmbë. Ai u indinjua dhe u tremb nga pasojat që mund të kishte sjellja e saj. Ai e quante të neveritshme të shkonte me gratë e botës e sidomos me gruan e zotnisë së tij. Ai kurrë s'i kishte ardhur rrotull ndonjë gruaje të huaj, ndaj u mendua e foli: — Mos më ngatërro mua me këso punësh, — e bëri të dilte nga dhoma.

— Velo, prit!, — i tha ajo si e çmendur.

Veloja u ndal duke mbështetur pëllëmbën në dorezën e derës. Ai kishte mbetur i çuditur nga ato fjalë e nuk po u zinte besë veshëve. Veloja kishte menduar se Bali e donte burrin, pavarësisht se i shoqi ishte njëzet vjet më i madh se ajo, ose të paktën kishte dhembshuri për të, sepse kishin aq vjet martuar e kishin dy fëmijë. Mirëpo ja, ajo fliste me urrejtje dhe, më e keqja, ishte se ajo po e tradhtonte.

Bali u ngrit me një lëvizje të vrullshme të trupit dhe u përpoq ta ndalte. Veloja ia mbërtheu për një çast sytë fytyrës së saj që kishte marrë një ngjyrë tjetër dhe pamja iu errësua.

— Pse sillësh kështu, Velo? Nga kush ke frikë? Hajde ta kalojmë sonte bashkë... Mos u bëj budalla, — i pëshpëriti dhe e kapi fort për krahu.

Veloja përsëri u shkëput dhe e përplasi Balin në krevat. Tërheqja e Velos i tregoi qartë Balit se ajo ishte gabuar në llogaritë e saj. Me një gulçim dëshpërimi Bali mbuloi fytyrën me pëllëmbat e duarvë.

Ajo kushedi sa herë kishte menduar të vente e t'i fu-

tej Velos në dyshek. Kishte kohë që digjej pas atij burri muskuloz e eshtak, por nuk kishte gjetur dot rastin. Pastaj Veloja largohej nga ajo si shejtani nga temjani jo se kish-të kuptuar gjë më përpara, por nuk e shihte dhe nuk e du-ronte dot Balin me ato gjestet dhe sjelljet e saj tërë naze. Veç kësaj Veloja e kishte marrë zët Balin, sepse në fillim ajo e kishte shikuar atë me mospërfillje të theksuar dhe se, sa herë që binte fjala për Velon, ajo thoshte: «Me nder, hyzmeqari im».

— Në qoftë se s'je i zoti të shkosh me gra, më mirë shko e mbytu në lumë, — thirri prapë Bali e ia dha të qarit.

Veloja nuk dinte si të dilte nga kjo ngatërresë e re. Po sikur Bali ta zbonte me të vërtetë nga shtëpia! Atëhe-rë Veloja do të detyrohej të bridhte poshtë e përpjetë për të gjetur punë. Vetëm kjo e tmerronte dhe asgjë tjetër. Por, me sa vinte re Veloja, ajo nuk do ta zbonte nga shtë-pia. Bali mendonte se në mos sot, nesër Veloja do të thy-hej. Në fund të fundit dhe ai mashkull ishte si gjithë të tjerët, e aq më tepër burrë pa grua. Dhe, meqënëse Velo-ja jetonte në një shtëpi me të, mendonte Bali, puna do t'i shkonte mbarë e asnjë fjalë e keqe nuk do të shkonte në veshin e botës dhe Myrtoja le të shkonte në djall me ato kurvat italiane. Sipas Balit, Veloja ishte mashkulli më i fortë. Ai ngjallte ndjenjat më të çuditshme në shpirtin e saj. Ajo mendonte që Veloja si burrë pa grua që ishte nuk do ta kundërshtonte propozimin e saj. Por ishte gabuar.

Veloja s'pati kohë të sillte ndër mend tërë atë ngjar-je, papritur e papandehur, pa tek ngruhej lart në qiell një shirit të ndritshëm, i cili, kur arriti në një lartësi, u shndër-rrua në të gjelbër e ra pastaj poshtë dalngadalë duke ndri-çuar për një çast fshatin që kishte rënë në errësirë dhe shkallët ku qe ulur ai. Velos kjo iu duk si një mbarësi në



rrugën e tij dhe e shkëputi përfundimisht nga filli i mendi-meve. Në atë çast iu afrua dhe Raxhoja i cili filloi të përkëdhelej. Velos iu bë qejfi nga përkëdhelja e papritur e qenit dhe pa rreth e qark shtëpisë. Drita e dhomës ku flinte Bali ndriçonte dobët. Pas pak u shua. «Tani duhet të nisem, — tha Veloja me zë sikur t'i fliste Raxhos dhe u ngrit, bëri dy-tre hapa dhe, para se të dilte jashtë, në rrugë, e përkëdheli Raxhon e ndjeu se do të ndahej përgjithmonë nga ai. Hapi portën, e la Raxhon brenda, e mbylli dhe u largua nga shtëpia. Kur doli në rrugë, ndjeu ajrin e pastër të mbrëmjes. U mbush thellë me frymë, shikoi qiellin e qëndisur me yje dhe padashur shpejtoi çapin. Prapa, në shtëpinë e Myrto Grenzës, ai kishte lënë të kaluarën, botën e plakur, botën e poshtërsive, imoralitetin, dhunën, botën e të gjitha të këqijave, botën që priste fundin e saj. Me këto ndjenja Veloja arriti në shtëpinë e Dinit e ndaloi para saj. Pranë një gardhi po kulloste një kalë. Pas një porte lehu një qen e pastaj asgjë e gjallë nuk u ndie.

Veloja trokiti në portë. Nga ana e jashtme e fshatit vinin ca zhurma të pakuptueshme dhe ai i dëgjonte ato duke ndenjur mbështetur pas portës. Dera e brendshme e shtëpisë lëvizi dhe e shkëputi Velon nga këto mendime. Pas pak u hap duke kërcitur një kanat i portës.

— Kush është?, — pyeti një zë që brenda si me të rreptë.

— Jam Veloja, — u përgjigj ai.

Xha Tasimi ngriu një çast.

— Hëm!, — murmuriti nëpër dhëmbë ai dhe ndjeu se Veloja nuk kishte trokitur për të mirë.

Dini, që kishte rënë të flinte, i ndjeu hapat e nxituar të të atit nëpër shkallë dhe u përmend menjëherë. Vuri dorën nën jastëk, atje ku vinte revolen, mbështeti shpinën mbas murit dhe qëndroi në pritje. «Ndonjë nga sho-

kët. Kushedi ç'do të ketë ndodhur», — mendoi me vete e, si pa që i ati po vonohej, u ngrit të dilte në oborr.

— Këtu është Dini?, — pyeti Veloja.

Xha Tasimi nuk iu përgjigj. Atë e mundonin disa pyetje: «Pse e do Dinin? Mos ka ngritur ndonjë kurth Myrto Grenza? Pse nuk më kërkon mua? Ky s'ma ka parë ndonjëherë derën?! Ç'e solli natën në shtëpinë time?!

— Dëgjon apo jo, — i tha Veloja i shqetësuar. — Ku është Dini?

— Pse? Ç'e do Dinin ti, ë? — Fytyra e xha Tasimit mori një shprehje shqetësimi e dyshimi akoma më të madh.

— Fol, të shkretën de, fol!, — iu lut Veloja duke e shikuar që nga koka e deri te këmbët. — Kam një punë të rëndësishme me të, prandaj erdha natën si hajdut po e kërkoj.

Xha Tasimin po e mundonte kureshtja. Ai donte të zbulonte të fshehtat e Velos, andaj po e zgjaste, por Veloja kishte vendosur që atij të mos i thoshte asgjë. Po dhe xha Tasimi nga ana e tij ngulte këmbë që të merrte vesh më parë arsyen përse e kërkonte shërbëtori i Myrtos të birin, pastaj t'i thoshte se ku ishte.

— Hajde, në ke gjë për të thënë, thuaje, njësoj është, si mua dhe atij, — foli xha Tasimi.

Që të dy, Tasim Kurti edhe Myrto Grenza ndienin armiqësi ndaj njëri-tjetrit. Ata prisnin rastin që të ndizej sherri. Në këtë armiqësi xha Tasimi fuste edhe Velon.

— Do të thuash ku është, apo të iki?, — bëri presion Veloja, po për të lëvizur nuk lëvizi.

Xha Tasimit iu nxi fytyra më keq se nata e iu shtrembërua?

— Shko, ore, se do të marrë vesh Myrto Grenza që ke ardhur në shtëpinë time dhe do të të fusë në dhe të gjallë...



Velon një çikë ta prekje, merrte zjarr si fitili i dinamitit, por për çudi heshti. Erdhi Dini. Ai e kapi Velon për krahu dhe e futi brenda në dhomë. «Ç'po bëhet këstu? Edhe Veloja qenka futur në këtë valle!?!», — u çudit Tasim Kurti dhe, ndonëse u hutua, ndjeu një gëzim të madh. Veloja ia tregoi të gjitha Dinit. Ai ishte i gëzuar për punën që po bënte.

\* \* \*

Atë e bir qëndronin në heshtje si të ngrirë. Në fytyrën e tyre nuk lëvizte asnjë muskul. Xha Tasimit disa mornica i përshkonin trupin sikur të kishte ftohtë. Dini u mbështet pas murit e filloi të mendohej se ç'duhej të bënte. Pastaj kontrolloi shtëpinë duke fshëhur një grumbull traktesh, disa libra dhe broshura propagandistike dhe çdo gjë tjetër që mund të ishte komprometuese. Hapi dritaren dhe qëndroi ashtu një farë kohe duke dëgjuar e përgjuar i shqetësuar edhe zhurmën më të vogël. Dini u mundua të kujtonte diçka të gëzuar që të kënaqte veten, por mendimet silleshin rreth asaj që do të ndodhte. Përpiquej të bindte veten që gjithçka do të mbaronte mirë. «Gjithçka u sqarua më së fundi, — tha me vete Dini e bëri lidhjen midis nënprefektit e Myrtos. — Myrtoja është spiun, spiun i ndyrë i italianëve».

Dini u shkëput nga dritarja, u ul në dyshek, rrethoi me krahet e tij gjunjët e përsëri humbi në mendime. Një hidhërim i madh i shqetësonte zemrën. Ishte aq i dëshpëruar, sa i vinte për të plasur që nuk kishte fuqi të shtypte atë forcë që do të rrëronte shtëpinë, ndoshta gjithë fshatin. Kur të gdhihej, ose të pasnesërmen që në mëngjes, në shtëpinë e tij do të shihte vetëm mure të zeza e të djegura. Gjithçka do të ndryshonte formën, do të merrte një pam-

je të zymtë. «Njeriu e ka ndërtuar këtë shtëpi. Është njeriu që do ta prishë atë. Prapë njeriu do ta ndërtojë. Le të digjet! Le të përmbysët gjithçka! Dhe jeta le të fillojë nga e para. Ah, sikur të vinin më parë partizanët, — tha me vete e u çel në fytyrë. Ngriti kokën dhe sytë i ndritën në errësirë. — Jo, — tha ai, — nuk duhet ndenjuri e prituri. Duhet lajmëruar shoku Pali dhe njëkohësisht duhet mbledhur organizata e rinisë e atje të vendosim se ç'duhet bërë. Shpejt, shpejt!», — vendosi e u ngriti.

Pas një ore në shtëpinë e Dinit u mbledh organizata e rinisë komuniste. Në mbledhje mungonte vetëm Stilian. Dini hodhi sytë nga dritarja dhe iu duk se po afronte mesi i natës. Fshati kishte rënë në gjumë. Njerëzit po pushonin mbas punës së lodhshme të ditës. Vetëm ata nuk flinin.

— Rreziku është i madh!, — e mori fjalën Dini. — Fashistët dhe ata që u shërbejnë atyre kërkojnë të trembin njerëzit. Situata e krijuar kërkon një disiplinë akoma më të fortë. Secili nga ne duhet të rrijë me sy e veshë hapur, vigjilent e gjithnjë i gatshëm, — vazhdoi Dini, fytyra e të cilit kishte marrë një ngjyrë tjetër, si të errët. Po këtë ndryshim të Dinit zor ta kuptonte çdo njeri që nuk e njihnte mirë. — Por edhe ne duhet të bëjmë diçka, atë që kemi mundësi ta bëjmë e të mos rrimë më duarkryq, sa të vijne fashistët me armë në dorë. Mendimi im është që me përjashtim të Nestit, i cili do të shkojë të lajmërojë shokun Pali, dhe me sa di unë ai ndodhet në fshatin Lushakë, të tjerët të shpërndahen sipas drejtimeve që do të caktojmë e të vënë në dijeni vetëm ato familje që janë bazat kryesore të partizanëve dhe të ilegalëve. Në qoftë se italianët



do të djegin e shkretojnë, dhe me siguri do ta bëjnë këtë, ata këtu do të synojnë, gjithë fshatin nuk mund ta djegin. Kështu, shumë-shumë do të djegin vetëm shtëpitë, po nuk do t'i arrestojnë dot njerëzit që merren me Lëvizjen.

— Ju nuk jeni i mendimit të lajmërojmë gjithë fshatin?, — e ndërpreu Rustemi.

— Jo, — iu përgjigj Dini, — nuk duhet të bëjmë alarm para kohe dhe të ngjallim panik në tërë fshatin. Pastaj një gjë duhet pasur parasysh: ka fshatarë që ende s'e kuptojnë ç'po ndodh? Madje ka dhe një pakicë që janë gati edhe të nënshtrohen, mjafton që të mos u digjet shtëpia e prokopia.

— Drejt, — tha një tjetër, — këtë do ta bëjmë ne, kurse ju, — dhe ai tregoi me gisht Dinin e Rustemin, me që jeni zënë me gojë nga nënprefekti, largohuni nga fshati derisa të kalojë kjo mynxyrë.

— Shohim e bëjmë, — iu përgjigj Dini, të cilit atë çast i dukej sikur edhe një ushtri e tërë t'i vihej prapa, nuk do ta zinte dot. Ai nuk do të dorëzohej. Gjithë fshati dhe periferia ishte e tij. Koriya dhe pylli gjithashtu.

\* \* \*

Nga lindja nisi të zbardhëllonte pak. Të gjithë shokët u shpërndanë sipas detyrave të caktuara. Dinin nuk po i durohej gjersa të gdhijej, por koha mezi kalonte. Ajo sikur hiqej zvarë. Pse nuk gdhijej menjëherë dhe së bashku me ditën të hiqej dhe ai kërcënimi i egër? Ja, mëngjesi po afronte. Mugëtira po i linte vendin gjithnjë e më shumë ditës së agimit. Po vinte koha kur fshati do të zgjohej, por jo si zakonisht.

Dielli sapo ngriti krye mbi majën e malit e pushtoi tokën me rrezet e tij. Dini mendoi të rrinte në shtëpi e t'i

qëllonte kur të vinin, por kjo ishte zgjidhja e fundit. Ai duhej të ikte që ta vazhdonte luftën e nisur e të mos rrezikohej kot. Nga larg u duk një autobлиндë që po gumëzhinte duke iu ngjitur një të përpjete. Pas saj vinin pesë makina të tjera të ngarkuara me karabinierë dhe me ushtarë. Nga autoblinda dolën dy oficerë dhe një civil. Makinat me ushtarë u ndalën në hyrje të fshatit. Ushtarët, mbasi zbritën, morën krahët dhe iu ngjitën kodrave përpjetë e zunë të gjitha hyrjet dhe pikat kyçe nga e kontrollonin fshatin si në pëllëmbë të dorës. Makina me karabinierët u ndal në mes të fshatit. Ushtarët nuk lejonin as të hynte dhe as të dilte njeri nga fshati. Më tepër ata i ruheshin një goditjeje nga partizanët dhe ilegalët e tjerë. Ardha në fshat e karabinierëve dhe disa të shtëna me pushkë, që nuk dihej përse ranë, ishte shenjë e keqe. Ishte e para herë që fshati Lenicë i nënshtrohej një dyndjeje të tillë. Prapa portave gjysmë të hapura të shtëpive qëndronin gra e vajza:

— Kanë frikë, djajtë, ndaj fshihen!, — tha me inat kapiten Barxolla, i cili ishte mësuar me ekspedita të tilla.

— Le të fshihen, s'kanë ku të futen, — u lavdërua oficeri i ushtrisë.

Nga shtëpia doli xha Tasimi. Sytë e tij ishin mbushur me hidhërim e vrer. Nuk kishte mbyllur sy gjithë natën dhe herë pas here lëpinte buzët që i qenë tharë. Disa karabinierë u futën në shtëpi me egërsi. Kapiten Barxolla, i ngrëhur si këndes, i ashpër dhe i vrenjtur, i doli përpara dhe, duke vrenjtur vetullat, e pyeti:

— Ku e ke tët bir?

— Cilin djalë? Unë kam shumë djem, — iu përgjigj xha Tasimi.

— Dinin, Dinin!

— Ka shkuar deri në Lushakë tek ime motër që është sëmurë.



— Ashtu, ë?, — u zgërdhi me zemërim kapiteni dhe, duke e marrë me mend se ky ishte një trillim sa për të hluar radhën, vazhdoi: — Hëë, ç'je ti! Ç'fshihen nën zo mustaqet e tua, — dhe ia nguli sytë në bebëzë sikur i thoshte: «Mua do të ma hedhësh ti?!». Pas këtyre fjaltëve u bë një minutë heshtje. Në atë kohë të shkurtër etësie kundërshtarët sikur po masnin forcat e tyre.

— O dorëzo djalin, ose për një orë, të shumtën për çy, shtëpisë do t'i vëmë zjarrin.

Xha Tasimi shtrembëroi kokën sikur me këtë lëvizje donte të thoshte: «Bëni ç'të doni. Mua as që më bëhet vonë fare».

Fshatarët që rrinin portave me zemër të ngrirë prisnin se ç'do të ndodhte më tej. Atyre u bëri përshtypje se xha Tasimi as nuk nxitohet, as nuk shqetësohet.

Karabinierët kontrolluan shtëpinë, por nuk gjetën asgjë. Atëherë pyetën mjaft fshatarë, por të gjithë ngrihnin supet. Pyetën me këmbëngulje e ashpërsi të gjithë njerëzit e familjes, por ata të vrenjtur u jepnin po të njëjtën përgjigje që u kishte dhënë xha Tasimi. Kapiteni i siguronte se s'do t'i bënin asgjë Dinit, vetëm sa ta shihnin, por ata nuk jepeshin. Atëherë ai filloi t'i shante, t'i frikësonte se do të digjin shtëpinë, por asnjeri nuk tundej. Kapiten Barxolla i zemëruar ngriti dorën e thirri:

— Vëri zjarrin!

Karabinierët morën një bidon benzinë nga makina, u futën brenda në shtëpi dhe e spërkatën. Një nga karabinierët ndezi një fije shkrepëse dhe e flaku përpara portës. Njerëzit rrinin të ngurosur duke pritur me ankth, se ç'do të bëhej.

Nga çatia doli një tym që u ngrit përpjetë si bisht kali. Pas disa minutash zjarri kapi gjithë shtëpinë. Trarët e tharë zunë të kërcisnin. Pas pak ranë me zhurmë, ndërsa muret me gurë filluan të nxiheshin. Shtëpia lëkundu

dej me përtesë dhe lozte nën diell. Pastaj ajo u trondit u mënjanua, humbi pamjen dhe së fundi u shemb. E shoja dhe e bija ia dhanë kujes.

— Mos qani, — u bërtiti xha Tasimi, — lotët janë një dhuratë për këta të poshtër. Edhe nga hiri diç dotë mbetet.

— Lëri llafet, po hajde tundi këmbët, — i shfryu njëri nga karabinierët dhe, duke e kapur për krahu, e tërhoqi për ta larguar nga shtëpia dhe njerëzit e familjes.

— Mos më prek me dorë!, — iu kanos xha Tasimi dhe fytyra iu drodh.

Karabinieri i dha një të shtyrë.

— Ah, kështu, ë?, — dhe xha Tasimi i dha një të pështyrë e thirri: — Në mos unë një tjetër do të marrë shpagën për poshtërsitë që po bëni.

— E shikon! Qenka komunist i vendosur plaku, — i tha oficeri i ushtrisë kapiten Barxollës.

— Vetëm plumbi duhet për njerëz të tillë, — iu përgjigj kapiten Barxolla që mendonte njësoj si kolegu i tij.

Kapiten Barxolla u tërbua nga inati.

Qëndrimi i xha Tasimit, i familjes dhe i të gjithë fshatarëve, mosgjetja e asgjëje, as e librave ilegale, as edhe e ndonjë arme gjatë kontrollit të tridhjetë e dy shtëpive, zhdukja e Dinit dhe e tetë të rinjve të tjerë që ishin deklaruar si komunistë nga Myrto Grenza, treguan hapur se ata njerëz ishin përgatitur për kontrollin. Po si dhe kush i kishte paralajmëruar? Ky mendim e çudiste kapitenin. Në sytë e tij të ftohtë e të palëvizshëm dukej zemërimi dhe urrejtja, por njëkohësisht dhe frika e hakmarrjes që ndiente. Kjo e bëri atë të mendohej se në fshat duhej të kishte një organizatë komuniste të fortë. Karabinierët i qëndronin pranë duke pritur ç'urdhra do t'u jepte. Dhe ai dha urdhër për t'u djegur dhe shtëpi të tjera.



Nëntë shtëpi dogjën ata atë ditë e arrestuan katërmbëdhjetë burra. Midis tyre dhe Qerim Turkeshi.

Të arrestuarit i morën në pyetje qysh atë natë. Liruan vetëm tre. Të tjerët i internuan në kampet e përqëndrimit. Myrto Grenza ishte kthyer në fshat vonë e shtirej si i habitur e shumë i shqetësuar, gjoja sikur dhe kjo që kishte ndodhur ishte një e keqe e madhe dhe për të. Por habia e vërtetë për të që largimi pa adresë i Velo Gorës.

IV IIIIUTPAK

\* \* \*

Pas djegies së fshatit Lenicë dhe largimit të Velo Gorës, Myrto Grenza nuk para guxonte të lëvizte vetëm si më parë. Ai kishte frikë nga partizanët dhe komunistët ilegalë. Këtë e kuptonin të gjithë në fshat. Çdo ditë që kalonte ai bëhej më i shqetësuar e nervoz. Por kjo gjendje nuk vazhdoi shumë. Pas dy javëve ai u bashkua me çetën e Ballit Kombëtar dhe atje e caktuan komandant të saj. Ai vinte fshat më fshat dhe e paraqiste veten si një «nacionalist» të ndershëm, komandant të zotin, ndërsa Ballin Kombëtar si të vetmen forcë politike dhe të armatosur që i kishte dalë për zot vendit që ta «çlironte» nga zgjedha e huaj. Por, sipas tij, akoma s'kishte ardhur koha për t'ia bërë fora. Myrto Grenza shfrytëzonte emrin e të atit që njihesh në tërë krahinën si një patriot, i cili kishte punuar e luftuar për Shqipërinë.

## KAPITULLI VI

Kaluan dhe tre muaj të tjerë Dimri ia kishte lënë vendin pranverës.

Mungesa e hënës dhe dritat e rralla e të vogla të dritareve sikur e shtonin qetësinë e natës. Rrugëve nuk shihej frymë njeriu. Vetëm qentë bridhnin e lehnin rrugëve të qytetit. Në ballkonin e kuesturës varej flamuri me sëpatën e fashizmit. Në hyrjen kryesore rrinte një polic i armatosur, i veshur me të zeza. Dinit dhe Nestit të ngarkuar me detyrë u vështirësohej puna, por ata shfrytëzonin shtëpitë me mure të vjetra, dyqanet e vogla me të hyra e të dala ku formoheshin hije të thella. Të dy rrinin e vështronin në terrin e natës në drejtim të kuesturës. Çdo gjë ishte e errët dhe e qetë, vetëm yjet, si të ishin qenie të gjalla, xixëllonin në qiellin e zi dhe u dukej sikur ua bënë me shenjë, si të qenë sy. Ishte natë e bukur dhe e ngrohtë që dukej sikur të ftonte për të dalë jashtë.

Kishte kaluar mesi i natës dhe ja, në kalldrëmin e gurtë u dëgjuan zhurmë këpucësh. Nuk kishte dyshim që në ato orë të vona, ku qarkullimi i popullit ishte i ndaluar, do të ishte patrulla ushtarake fashiste. Kur patrulla u afrua, ata u strukën te dera e dyqanit e u bënë njësh me të. Patrulla kaloi pa i vënë re. Hapat jehuan në anën



e kundërt të qytetit sa u shuan fare. Të dy shokët qëndruan në heshtje. Nga rrugica përkarshi u duk një hije që ecte me hapa të lehtë. Dini e vuri re dhe preku dorën e shokut. Ai ia ktheu shtrëngimin duke i dhënë të kuptojë se e kishte parë. Të dy përqëndruan vëmendjen. Njeriu ecte rrëzë mureve si i trembur. Hera-herës ndalonte, përgjonte e, kur u bind se s'kishte njeri, kaloi rrugën dhe hyri në ndërtesën e kuesturës. Roja nuk e ndaloi.

Ata prisnin me padurim kthimin e tij. Dinit i vinte shumë inat. Sikur të lejohej, ai do ta mbyste me dorën e tij atë qen. E kishte pasur shok fëmijërie, por ja që ishte bërë spiun i fashistëve. «I poshtër! Tani u vërtetuan gjithë dyshimet», — tha Dini me vete kur Sevoja hyri në kuesturë. Dinit iu kujtuan bisedat me të, ku ai fliste me entuziazëm për fashizmin, për idetë fashiste, për pushtuesin italian që e quante shpëtimtar për popullin tonë, që do t'i sillte përparimin; kurse Lëvizjen Nacionalçlirimtare, traktet, çetat, aksionet i quante kalamallëqe që i sillnin dëme popullit. Dinit iu kujtuan fjalët që i kishte thënë shoku krahinorit, Pali Duros: «Sevoja është fashist, mund të jetë dhe spiun i SIM-it. Duhet ta kontrollojmë». Iu kujtuan dhe takimet që pati Nesti me Sevon pas hedhjes së traktit të parë. Me lajka e me provokime deshi të zbulonte nga Nesti se ç'dinte për këtë, kush mund ta kishte bërë e kush mund ta kishte hedhur. «Dhe ja përfundimi, — tha Dini me vete. — Ai shkoi në kuesturë. Përse shkoi vallë? Çfarë bën atje? Me kë është takuar? Çfarë raporton?!». Mendimet iu prenë në mes, se pa Sevon të dilte nga kuestura.

Mbasi u zbulua që Sevoja shkoi në kuesturë, shokët po mendonin se ç'duhej bërë e çfarë masa duhej të merr-

nin. Dini i veshur si hamall kishte dalë në pazar dhe me duart në xhepa vinte vërdallë.

Pazari ishte në qendër të qytetit e ishte mbushur me pislleqe. Kushedi sa kohë kishte pa fshirë. Një i verbër ishte ulur mbi një gur dhe ia kishte marrë një kënge me të qarë, kurse një opingar shtegtar po rrinte si një plakush i mjerë e priste t'i shpinin pazarakët ndonjë opingë për ta qepur. Ai kishte një fytyrë të vrarë nga lija. Më tej qëndronte një grua fallxheshë që thërriste me të madhe:

— Urdhëroni e provoni fatin, urdhëroni!

Italianët shtyheshin me njëri-tjetrin, kush e kush të shtinte më përpara fall. Më tutje dy hamaj po ziheshin me njëri-tjetrin për shkarkimin e një qerreje me bereqet. Një lypës me dy fëmijë të vegjël ulur në shkallët e përmendores u ndente dorën kalimtarëve për lëmoshë. Fëmijët kishin ngritur kokën lart dhe vështronin si me çudi pranë tyre një kalë të zgjebosur që qëllonte me inat mizat me bishtin e tij. Dy xhambazë kuajsh po haheshin me një fshatar për shitjen e një mëzi. Ata pinin duhan duke lëshuar me shpejtësi dhe tërë inat shtëllunga tymi. Nëpër rrugët kalonin të krekosur e hijerëndë oficerët e garnizonit. Në një rrugicë të pazarit, midis shtëpive të vogla e të vjetra, Dinit i vriste sytë një ndërtesë e bukur dykatëshe, e thurur me avlli të larta, të suvatuara e të lyera me gëlqere. Në një largësi fare të vogël nga ndërtesa ishte një pyll i vogël. Në atë pyll të rrallë strukur e fshehur italianët kishin vendosur nën drurët topa të mëdhenj. Grykat e këtyre topave ishin drejtuar nga fshati Lenicë dhe Dinit i dukej sikur së shpejti do të hynin në veprim. Rreth e rrotull kishtet disa kamiona të mbushur me predha. Ushtarët e caktuar në këta topa, që ishin aty rrotull, ca të shtrirë në kurriz, ca duke u thekur në diell, ca të tjerë të strukur mbi topat vetë, rrinin të shkujdesur si-



kur të ishin aty në piknik apo në panair. Dini shkëputi vështrimet nga topat e ushtarët kur vuri re se nga lagjja e sipërme po afroheshin një grup karabinierësh. Qëndroi e u habit. Në mes të karabinierëve ishte Sevoja i lidhur me pranga. «Ç'është kjo?!», — tha me vete sepse natën që kishte gdhirë, ai me sytë e tij e kishte parë kur kishte shkuar në kuesturë e kur kishte dalë së andejmi, kurse tani karabinieria e paskësh arrestuar! «Si është e mundur?! Të ketë ndonjë ngatërresë në këtë mes? Hajde merr me mend këtë! Sidoqoftë duhet njoftuar shoku Pali». Ndenji dhe një copë herë pazarit dhe pastaj u nis lagjes përpjetë. Palin e gjeti në bazë.

— Sot karabinieria arrestoi Sevon, — foli Dini i shqetësuar e i hutuar.

— Sevon?!, — u çudit Pali. — Si është e mundur, ai është njeri i tyre. Ti më the se shkoi në kuesturë. E pe mirë, apo mos të bënë sytë?!

— Oj, të parë, ai i tëri ishte, — iu përgjigj Dini. — Ne e pamë me sytë tanë dhe kjo na bindi që ai është spiun, kurse tani, ja se ç'na del!

Shoku i krahinorit ra në mendime. «Përse e komplikuan çështjen kështu?! Kjo duhet sqaruar».

— Dëgjo, Din! Tako të gjithë shokët që kanë pasur shoqëri me Sevon dhe paralajmëroi që të jenë të kujdesshëm, të punojnë dhe të ruhen. Mundet që kapiten Barxolla ta ketë organizuar vetë këtë lojë. Edhe ti duhet të ruhesh, por njëkohësisht, meqë ti ke hyrë e ke dalë më përpara në shtëpinë e tij, të informohesh përse e kanë arrestuar dhe ç'i kanë gjetur në shtëpi. Ndërsa Stiliani menjëherë të largohet nga qyteti.

Dini u takua me shokët dhe me fqinjët e Sevos. Nga ata mësoi se në mëngjes kishin bastisur shtëpinë e Sevos dhe gjatë kontrollit në një libër kishin gjetur një trakt. Kjo i dogji Dinit. Përse e mbante traktin rrufjani kur

fliste keq për to, dhe për Lëvizjen? Mbas gjetjes së traktit karabinierët kishin përmbysur shtëpinë, po s'kishin gjetur gjë tjetër, i kishin hedhur hekurat dhe me të goditura e të shtyra e kishin vënë Sevon përpara. Meqënëse iu gjet trakti, njerëzit mendonin se dhe Sevoja kishte qënë njeri i Lëvizjes, por Dini që e dinte se ç'mall ishte ai nuk e besoi. Dini takohej me shokët, merrte prej tyre lajme të reja dhe çuditej se si as kuestura, as karabinieria nuk trazuan njeri nga të Lëvizjes që Sevoja duhej t'i kishte denoncuar.

\* \* \*

Kaluan dy javë. Dini mori vesh se Sevon e kishin liruar, por e kishin torturuar për vdekje dhe ai dergjej në shtrat. Kjo ishte një e papritur tjetër. Varianti që Sevon mund ta kishin arrestuar si denoncues për shokët, u rrëzua. Qëllimi pra ishte tjetër. E çfarë mund të ishte? Dini u takua me Palin, ia raportoi të gjitha, por u çudit që Pali e ngarkoi të shkonte në shtëpinë e Sevos. Dini desh të kundërshtonte këtë, por kishte besim në fjalët e tij e s'foli. Kjo kërkonte shumë kujdes e shkathtësi. E rrah mirë e mirë me mendje këtë dhe, kur u bind që shtëpinë e Sevos nuk e kontrollonin, shkoi.

— Të shkuara, Sevo, si dukesh, a po e merr veten?

— Jam keq, Din, — iu përgjigj Sevoja. — Më kanë dërmuar krejt, më duket sikur më kanë thyer kockat e nuk do të bëhem njeri.

Sevoja mezi lëvizi nga vendi, por Dini nuk vuri re në shprehjen e fytyrës as shenjat e torturës dhe as shenjat e dhembjes, përveç fashovë, me të cilat kishte lidhur të dyja duart.

— E po, kur e ke nga dashamirësit, nuk e ndien të keqen, — e thumboi Dini.



— He, mor Din, dhe ti ke të drejtë, pata një besim qorri prej të marri ose axhamiu ndaj fashizmit. Besoja se ai do të na sillte të mira. Ashtu i kuptoja gjërat, por tani vura mend. Kjo kokë ma ka fajin, kujtoja se ata përhapnin emancipimin, gëzohesha për këtë, por ja dhe emancipimi i tyre, kërbaçi, torturat.

— Tani, pas kësaj që të ndodhi, do të thuash se e njohe kush ishin fashistët, — e ndërpreu Dini.

— Ashtu them, kam filluar t'i njoh, populli ka një proverbë: «Kush pëson, mëson».

— He, — ia bëri Dini dhe mori një pamje sikur t'i vinte keq për të, — gëzohem që më në fund i njohe. Po, as më thua, Sevo, përse të arrestuan, kush bëri ndonjë krim, se për politikë s'ma merr mendja, ti ishe profashist.

Sevoja sikur u fye nga fjalët e Dinit.

— Jo, Din, mos më thuaj profashist, se më vjen rëndë. Të paktën të mos e dëgjoj nga goja jote. Unë nuk isha profashist, por kisha disa iluzione për të dhe kjo nga naiviteti. Përse më arrestuan the? E ku ta di dhe unë, krime s'kam bërë, për të folur ti e di që unë s'flas me këdo, përveçse me shokët e mi. Kur më bastisën, u çudita. Mendoja se do të ishte bërë ndonjë gabim. Unë nuk jam aktivist i Lëvizjes që të më bastisin, po, ku pyesin ata. Hynë në shtëpi me tërsëllëmë dhe filluan të kontrollonin, kur do, për dreq, sikur t'i kishte shtyrë njeri, shkuan e kontrolluan dhe një libër ku kisha futur një trakt. Kjo i bëri që të dyshonin edhe më keq, e përmbysën shtëpinë dhe më arrestuan. . . Ja, kështu më ndodhi.

— Po atë dreq trakti ç'e doje që e mbaje, more Sevo?

— As unë nuk e di se ç'më shtyu, por më është bërë si zakon, dreqi ta hajë, që, kur shoh një gjë për herë të parë, ta ruaj, kështu dhe për traktin. Megjithëqë e dija që këto janë gjëra me zarar, e mbajta.

— Çudi, Sevo, ti nuk përziheshe me punët e Lëviz-

jes, ç'deshën me ty ata? Ç'i shtyu të vinin për kontroll?! Si duket ata s'kanë besim tek askush dhe të gjithë u duken komunistë.

— As unë s'e kuptoj dot se ç'kishin me mua. Unë deri tani kam parë punën time dhe nuk jam përzier. Nganjëherë vras mendjen se mos më ka shpëtuar ndonjë fjalë.

— Edhe në flisje, Sevo, flisje se doje qetësinë. Mirëpo kush të lë rehat?, — shtoi Dini.

— Më beso, Din, më dërrmuan kockat, mos rënç në dorë të tyre.

— Me kaq hiç asgjë. Gjene mirë që të liruan, se puna mund të shkonte dhe më keq. Por, si duket, do të kenë mësuar se kush je dhe të liruan.

— Ata s'donin të dinin se kush isha unë, por s'u doli gjë, unë s'kisha ç'të thosha, unë s'dija gjë dhe më liruan për mungesë provash. Pastaj luajti dhe ryshfeti.

Dini po e shikonte me vëmendje Sevon dhe gjithnjë e më shumë bindej se ai nuk ishte torturuar. Duke biseduar, Sevoja harroi dhembjet dhe lëvizte në shtrat. Dini pa me kujdes fashot e duarve dhe vuri re se aty ku dukeshin gishtërinjtë ishin fare të pastër e nuk kishin shenja torturash. «Ah, qen bir qeni, — tha me vete Dini, — kërkon të na e hedhësh, hë? Mirë, kujto se na e hodhe».

— A të pyesnin shumë në kuesturë, o Sevo?

— Më pyesnin, si s'më pyesnin, gjatë gjithë ditës. Kur u shkrepëj, edhe natën.

— Po përse? Ç'të pyesnin vallë, ë?

— Ç'u vinte në mendje... Për komunistët, për njerëzit e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, e ku mbahen mend të gjitha ato në gjendjen që isha unë!

— Dhe ti ua the ç'dije. Doemos, s'kishe faj, ata të torturuan, të thyen kockat, kushdo që të ishte s'kishte si vepronte ndryshe.

— E ç't'u thosha unë, se mos dija gjë!



— Edhe dije. Ne kemi folur kundër fashizmit, e kemi sharë, kemi folur mirë për Lëvizjen, apo jo?

— Jo, Din, — e ndërpreu Sevoja. — S'më paske njohur mirë, po pse, spiun jam unë që të tradhtoj shokët? Pastaj, po të kisha folur, ju do të kishit gjetur vendin, mjaftonte gjysmë fjale që t'ju hidhnin hekurat. Ah, sa të poshtër janë ata, s'i di ti jo?

Dinit i erdhi të pështirë.

«Dhe kujt ia shet këto? Mua që e pashë me këta sy kur hyri e doli nga kuestura! S'e ka për gjë kodoshi dhe thotë *nuk jam spiun, s'i tradhtoj shokët*, — mendoi Dini me vete dhe i hipi gjaku në kokë e deshi ta zinte me shqelma.

— Nejse, — foli Dini si e përmbloodhi veten, — tani bëhu mirë, pa do të takohemi prapë dhe do të llafosemi.

— Din, — tha Sevoja, — ty të falem nderit shumë që erdhe. Në raste të tilla njihen shokët. Po, dhe po të mos vije, do të të thërrisja vetë, kam një lutje për ty.

Dini ishte çuar dhe po bëhej gati t'i jepte dorën.

— Fol, ç'ke? Veç, për të lutur, mos m'u lut. A nuk kemi qenë shokë ne?

— Më fal, Din, nuk e thashë në atë kuptim. Por ja, se të kam shok për kokë, ndaj dhe dua të flas hapur me ty. Dua të lidhem me ndonjë të Lëvizjes, me ndonjë komunist.

Dini e pa ngultas dhe tha me vete: «Dashka të lidhet me ndonjë komunist. Mos është ky misioni që i ka ngarkuar kuestura dhe organizuan këtë lojë që të lidhet me ne, të futet në radhët tona?».

— Po ç'e do komunistin ti, Sevo?, — pyeti Dini. — Ti dikur ke thënë që ata janë kalamanj, duan të hahen me një qeveri të madhe, do të marrin në qafë popullin...

— Ashtu është, Din, — e ndërpreu Sevoja, — kështu thosha, por njerëzit ndryshojnë. Ato që hoqa bë-

në të jem kundër fashistëve, i urrej ata. Pastaj dhe unë dua të hakmerrem, pse kështu duarkryq do të rri unë.

— Mirë e ke ti, duarkryq s'duhet ndenjuri, por unë s'të ndihmoj dot. Nuk njoh asnjë komunist.

— Mirë, si të duash, Din! Apo s'më besoni?

— Atë fjalë mos e thuaj, — i tha Dini dhe u vrenjt në fytyrë. — Po të mos të besoja, nuk vija të të shikoja, po bëhu mirë njëherë, dil pazarit, pa përsëri këtu jemi e do të llafosemi. Rëndësi ka që të shërohesh, se, kështu si të kanë katandisur ty, do ca kohë që të marrësh veten. Vetëm një gjë po të këshilloj para se të iki: mos fol me çdo njeri kështu. Të ndodhi ç'të ndodhi, qepe.

— Falemi nderit, Din, — i tha e i shtrëngoi dorën.

\* \* \*

Sevoja, megjithëse e kuptonte që Dini nuk i besonte dhe nuk i hapej, nuk hiqte dorë nga kërkesa e tij.

Ai foli disa herë me të, e provokonte, insistonte që të takohej me njerëzit e Lëvizjes, por, kur e hoqi shpresën, i tha Dinit se kishte marrë vesh nga një shok se do ta arrestonin përsëri, prandaj duhej të dilte sa më parë në mal, partizan.

Dini nuk i dha përgjigje.

Një ditë të bukur pranvere Sevoja mori rrugën për në fshatin Lushakë te daja i tij, Neli Kreka. Si u përshëndet me njerëzit e shtëpisë dhe u çlodh nga rruga, i tha dajës se kishte vajtur të dilte partizan, prandaj donte të bashkohej me çetën.

Komisari i çetës, sa mori dijeni që Sevoja kishte ardhur në Lushakë e kërkonte të futej në çetë, i dërgoi një letër shokut të krahinorit dhe mori përgjigje që të merrej në çetë e të kontrolltoheshin veprimet e tij. Sevoja u ba-



shkua me çetën e atje tregonte torturat dhe gëzohej që i kishte shpëtuar arrestimit të dytë. Mbasi kishte kaluar nja dy javë, ai i dha një letër dajës që ta çonte në qytet. Daja letrën e mbajti aty nja dy ditë, por i biri i tij që ishte një aktivist i shquar i rinisë komuniste e lexoi dhe e porositi që, para se ta çonte në qytet, t'ia jepte komisarit. Komisari e lexoi letrën. Ajo kishte ton familjar, por disa fraza të errëta, të përsëritura. Komisari e kopjoi letrën dhe e la të shkonte në qytet me qëllim që të zbulonin se ku do ta çonin atë, por nuk e zbuluan dot. Sevoja kishte një fletore të vogël, që e përdorte si ditar. Një shoku i tij e pa që ai shkruante emrat e partizanëve dhe të fshatarëve që mbanin çetën dhe ilegalët, vendet ku ajo kalonte. Një ditë Sevoja kërkoi lejë të vente te daja për t'u ndërruar, por shokët e qytetit zbuluan se ai kishte shkuar në kuesturë. Komisari mblodhi komunistët dhe bisedoi rreth çështjes. Propozoi që të jepnin lajmin se çeta do të sulmonte një nënrepart që ishte dislokuar në afërsi të qytetit, caktoi dhe rrugën nga do të shkonte e si do ta rrethonte. Data e sulmit do të ishte pas pesë ditësh. U mblodh çeta dhe u komunikua. Një ditë para sulmit shkoi afër venddislokimit dhe vrojtonte. Në atë repart erdhën përforcime. Pra s'kishte dyshim se armiku ishte vënë në dijeni.

— Gjyqi do të bëhet në Lushakë, — tha komisari. — Ky është urdhri i krahinorit. Pas dy orësh çeta duhet të ndodhet atje?

Të nesërmen, në pyllin e Lushakës, mbi bazën e çetës u krijua batalioni partizan. Po në këtë ditë, në batalion u reshtuan dhe tre të rinj komunistë të tjerë: Din Kurti, Nesti Makashi dhe Rustem Turkeshi.

Komisari i batalionit ishte caktuar Pali Duro.

## KAPITULLI VII

... Ditët e muajt kalonin. Vjeshta sapo kishte ardhur me shirat e saj të para. Okupatori italian kapitulloi dhe vendin e tij e zuri pushtuesi i ri gjerman. Ishte ditë e zymtë vjeshte. Pemët lëkundeshin nga era. Qielli ishte i mbuluar me copa reje bojë pluhuri që ndërronin vend dhe formë të shtyra nga era. Dy aeroplanë «Junker» po vinin nga perëndimi. Herë-herë syri mezi i kapte tutje, lart në qiell. Ulërima e furishme dhe e paprerë e motorëve sikur të fuste frikën e të ngjethte mishtë. Partizanët, të shpërndarë grupe-grupe në pyllin e Zelit, ndiqnin me sy aeroplanët që kishin kaluar mbi qytet, mbi Grykat e Dakës, për në drejtim të Korçës.

— More Nesti, ç'ka Dini që rri tërë hundë e buzë, — tha Velo Gora, skuadërkomandanti i tyre, partizani më i moshuar i batalionit, kur e pa Dinin që rrinte disi i veçuar nga të tjerët, mbështetur mbas një lisi të madh.

— Pse, nuk ishte ti kur foli komisarit?, — ia ktheu Nesti.

— Jo. Si është puna?

— Komisarit e qortoi rëndë Dinin në mbledhjen e batalionit. Ai tha se nuk do ta linte më të merrte pjesë në grupet e sulmit. Do ta caktojë korrier ose mitralier me



një nga mitralozat e rëndë «Breda». Dhe mirë e ka komisari, ai s'përbahet gjëkund, mor jahu, lë pozicionin dhe lëshohet si i tërbuar përpara. Sikur i hipin xhin-det.

— I zgjuar është, i mirë sa s'i bëhet hesapi, por këtë e ka të keqe. Epo të mos i dhimbset jeta fare, — shtoi Veloja, i cili e donte Dinin si ta kishte fëmijën e tij.

— Trim i tërbuar, — ndërhyri Rustemi, — trimin nuk e zë plumbi kollaj.

— Trim, trim, po shoku Pali nuk i ka qejf trimat pa mend në kokë, — ia ktheu Nesti.

— Epo i ri, — tha Veloja. — I riu si veriu...

— Ashtu vërtet, — ndërhyri Stiliani, — por ai shumë herë ka vënë në rrezik jo vetëm veten e tij, por edhe shokët. E ka mirë komisari, duhet ruajtur Dini.

— E, po ku dëgjon Dini se, — i tha Nesti. — Ai thotë: «Sikur të më pushkatojnë, nuk vete as korrier, as mitralier. Për korrier hajde de, dhe mund të më mbushet mendja, se di unë se si bëj kur të kërcasë, po mitralier? Ku rri dot unë në një vend! Mua dhe toka s'më mban, më hedh përjetë. E shoh dhe vetë që e shkel, por nuk e përmbaj dot veten».

— Ehu, komisari të tërë kërkon t'i ruajë, — tha Veloja. — Ai nuk do t'i dalë njeriu gjak nga hundët, pa le të plagoset. E po luftë është kjo de, po, sa për Dinin, nuk e ka keq që e ka kritikuar. Do t'i lutem të ma lërë mua në skuadër. Në fshat është kujdesur Dini për mua, tani do të kujdesem unë për të.

— Na mbushe mendjen, — iu përgjigj Nesti.

— Do ta shohim, — tha Veloja me seriozitet. — More, po ku është komisari që s'po e shoh gjëkund?

— Ka shkuar në Lushakë, — i tha Nesti. — Më duket se kanë mbledhje. Thonë se ka ardhur dhe një shok me përgjegjësi nga Qarkori...

— Jo, more!, — u çudit Veloja. — E po, meqë ka vajtur atje dhe kanë mbledhje, diç do të bëhet.

— Ja, ja, po vjen, — e ndërpreu Nesti, kur pa shokun Pali të shoqëruar nga dy partizanë që po i ngjiteshin pyllit përpjetë.

\*

\* \*

Komisari erdhi dhe u ndal në një shesh të vogël, disa metra larg tyre, atje ku ishte grumbulli më i madh i partizanëve. Menjëherë dha urdhër të mblidhej batalioni.

Dielli ishte në të thyer. Mbi majën e malit Grano disa re të bardha vërtiteshin si kurorë. Komisari vështroi zëvendëskomandantin dhe ky ia bëri me kokë.

— Shokë, — filloi të fliste komisari, — batalionit tonë i është ngarkuar një detyrë me shumë rëndësi. Do të godasim një kolonë armike te Gryka e Dakës.

Ju, shokë e kuptoni se shumë gjëra varen nga pregaritja, gjakftohtësia dhe disiplina. Derisa të nisemi për në vendet e caktuara, duhet mbajtur goja kyçur. Gjithçka është sekret. Lëvizja do të bëhet natën, në orën njëzet. Gjithsecili duhet ta ketë të qartë planin e sulmit dhe qëllimin tonë. Kompania e parë do të zërë vargun e kodrave nga juglindja, kompania e dytë nga veriperëndimi. Mitralozat e rëndë do të vendosen: njëri në Shkëmbin e Shqipes dhe tjetri në Kodrën e Shkëmbit të Zi. — Ai dhe shumica e partizanëve e njihnin vendin me pëllëmbë dhe kjo i jepte mundësi atij të përcaktonte që në vend detyrat dhe drejtimet. — Këto janë pikat kyçe, — tha ai prapë dhe vetullat i lëvizën me një prerje të dyshimtë. — Po t'i kapim pozicionet pa u diktuar nga armiku, e gjithë Gry-



ka e Dakës bie nën zjarrin tonë. Armiku do të gozhdohet në vend dhe s'do të ketë nga t'ia mbajë. Çdo gjë varet nga shpejtësia dhe befasia, se, po të arrijë gjermani të vërë në përdorim mortajat dhe artilerinë, do ta kemi vështirë. Zjarri i parë duhet të jetë zjarr, jo flakë dëllinje. Komandantët dhe komisarët e kompanisë duhet të bashkëpunojnë ngushtë midis tyre. — Si heshti një çast, vazhdoi: — Në orën tetëmbëdhjetë komandantët dhe komisarët e kompanive të raportojnë mbi gatishmërinë dhe të sqarojnë çdo gjë që ka lidhje me aksionin.

Dielli kishte kohë që kishte ngritur krye mbi majën e malit Grano, por autokolona armike që pritej të vinte nuk po dukej akoma. Me gjithë lodhjen, askush nuk flinte në pozicionin që kishte zënë, askush nuk lëvizte. Të gjithë rrinin gati me sy e veshë të hapur, si në alarm, dhe prisnin orë e çast të dukeshin makinat.

Dini me Nestin kishin zënë vend pas një shkëmbi të zi mbi kthesën kryesore të xhadesë. Disa metra më tutje ishin vendosur Veloja, Rustemi dhe Stiliani. Pozicionet e tyre ishin të thella dhe të maskuara. Ato ishin ndërtuar që në Luftën italo-greke. Megjithëse kishin kaluar vite, ruanin plotësisht gatishmërinë e tyre. Gjatë atij vargu kodrash, që ngriheshin përballë, pozicioni i tyre ishte një problem shqetësues për armikun. Ata nga çasti në çast mund t'i kundërsulmonin dhe të tërhiqeshin pa pasur dëme.

— More, — tha Stiliani, — po vete dreka dhe ky djall gjermani s'po duket gjëkund. Mos e kanë anuluar?!

— Duket se nuhat të keqen, — ia ktheu Dini.

— S'di si të them, nuk më pëlqen kjo pritje, — ndërhyri Veloja dhe mbajti vesh se mos dëgjonte ndonjë zhurmë makinë.

— Mos na e lagu qeni, — tha Dini. — Kush rri gjithë ditën, mor jahu. Të priturit e kam zët.

— Medoemos do të vijnë, — tha një tjetër.

— Do të vijnë e do t'i grijmë, — tha Veloja e përsëri mbajti vesh të dëgjonte ato zhurma të forta makinash që aty më mirë se kudo duhet t'i sillte Gryka e Dakës.

— T'ëmën, nga këta gjermanët sikur ndruhen, — tha Nesti e, sa deshi të bënte krahasimin me italianët, ia preu fjalën Veloja.

— Ama ç'po dërdëllis dhe ti, Nesti. E ç'janë gjermanët, mos kanë rënë nga qielli?

— Jo, jo, gjermanëve s'ua kam shumë frikën, — ndërhyri Stiliani, — veç atyre të shkretë aeroplanëve dhe atyre tankeve ua kam një çikë. Nuk i duroj dot me atë zhurmën e tyre.

— Tankeve u gjendet ilaçi, — iu përgjigj Dini, — aeroplanëve s'ke ç'u bën. Do të thuash me pushkë, ta vesh në shenjë në motor, po a merret era në shenjë?

Veloja sikur u mërzit nga muhabetet, të cilat i duke-shin të kota. Filloi të këqyrte rreth e qark e ua preu bisedën shokëve:

— More, po sikur ta zëmë atë kodrën tjetër, ë?, — tha dhe ia bëri me dorë drejt saj.

— Pse?, — pyeti Dini.

— Si pse! Ku dihet. Po sikur gjermani ta mbyllë atë shteg, — dhe tregoi me dorë përroin e thatë, — nga t'ia mbajmë pastaj? Kur zë një pozicion, duhet të shikosh dhe mundësinë e manevrimit. Jam i vjetër unë, ore baxhan, i di mirë këto punëra.

— Jo, jo, jemi mirë këtu, — kundërshtoi Stiliani.

— Mirë, mirë, po janë dinakë gjermanët.

— Sa për dinakë, dinak është derri i derrit. S'ia ha qeni shkopin, — vërtetoi Dini, — po ka dhe më dinakë



se gjermani. Të kujtohet përpjekja në grykat e Barma-shit! Hajde, bir, hajde, si i vunë përpara!

Papritmas gjëmimi i motorëve, mbyti zhurmët e tjera. E gjithë atmosfera dridhej, tokë e qiell bashkë. Ata s'po u zinin besë veshëve. Por s'kaloi shumë dhe gjëmimi erdhi e u bë uturimë. Ndihej erë vaji dhe benzine të djegur. Hijet e reve shëtisnin mbi vargun e makinave. Oshëtimia u rrit dhe makinat e para kaluan fshatin Lenicë. Dini lëvizte sytë sa andej-këndej, dridhej nga emocioni dhe kapërdinte vazhdimisht pështymën e foli me vete «Hajt pra, mirë se të vini!». Nesti po përgatiste granatat, gjoja i përgatiste, se ato të gatshme ishin, kurse Veloja nuhaste atmosferën porsì një mëz në mëngjes herët. Vetëm Stiliani rrinte i shkujdesur, sikur ngrohej në diell. Të mbështjellë nga një re pluhuri, makinat sa vinin e po afroheshin. Shoferët shpeshherë nxirrnin kokën nga makinat, vështronin djathtas, majtas, lart dhe dukeshin sikur u faleshin dhe kërkonin ndihmë nga qielli. Veloja rrinte mbështetur pas një shkëmbi me fytyrë të zgjatur përpara sikur të donte t'i përpinte një sahat e më parë.

Motorët vazhdonin të zhurmonin me uturimë të mbytur, thua se poshtë tyre binte tërmet.

Sytë e Dinit ngjyrë hiri ndiqnin me kujdes kolonën që zbriste tatëpjetë Hollmit. Makinat kalonin njëra pas tjetrës si një zinxhir i gjatë dhe Dinit që nuk i pritej sa t'i jepej sinjali tha i shqetësuar:

— Pse, sehir do të bëjmë?

Në fushë të Hollmit u dukën dy motoçikleta me nga tre gjermanë me automatikë në qafë dhe me mitraloza përpara. Pas tyre u duk dhe makina e parë.

Toka dridhej. Shtëllunga tymi e pluhuri dilnin nga gjiri i tokës. Era i shpinte nga ana e lindjes, drejt malit Grano.

— Qenkan shumë, or iu shoftë binaja!, — tha Velo-

ja, dhe filloi t'i numëronte: — Një, dy, tre... dymbëdhjetë, pesëmbëdhjetë. Ohu, zjarrin botës ia vure, po kokën tënde do të hash.

Krismat e para shpërthyen në orën 15.00, kur kolona u fut në kthesën e fortë të Qafës së Karabollit. Mali Grano u drodh dhe thithi erën e barutit. Gomat e rrotave të para ishin bërë copë-copë. Velo Gora ishte tërë qejf.

Komisari erdhi me të shpejtë i mbytur në djersë. Ai, si gjithnjë, dukej i qetë në fytyrë, por vështrimi i tij rrëfente se diçka nuk po shkonte mirë.

Ai nuk ngutej kurrë. Kur e shikoje për herë të parë, të linte përshtypjen e një komisari të vrazhdë dhe të ashpër, por e vërteta nuk ishte ashtu. Në të gjitha betejat partizanët e kishin parë se si ndizej në fushën e luftës nga një flakë e pashuar dhe luftonte me guxim të çmendur dhe me tërbim. Pas tij me vrap po vinte dhe një partizan tjetër i nxirë nga pluhuri e tymi i asaj dite. Komisari fshihi ballin nga djersa dhe fytyra i ndriti. Ai pa pozicionet; të gjitha ishin të mbrojtura mirë dhe nuk binin në sy fare. Bile dhe gryka e mitralozit nuk dallohej nga larg. Vetëm për tërheqje ishte vështirë. Mitralozi i rëndë që ishte vendosur mbi një shkëmb nuk i linte gjermanët të ngrinin as majën e hundës. Dini dhe Nesti shtinin me radhë, me breshëri të shkurtëra, por të sigurta.

Por gjermanët e morën veten dhe nisën të rrihnin me artileri.

Gjatë atij bombardimi plot egërsi që zgjati gjysmë ore veshët e Dinit dhe të Nestit ishin të vulosura si shishja me tapë. Predhat shpërthenin nga të katër anët. Një grup gjermanësh që nuk ishte futur në pritë mundi të zinte kodrën e pyllëzuar në kthesë të xhadesë. Ata me dy mitraloza «Shars» villnin zjarr pa pushim dhe pengonin



veprimet e forcave të krahut të majtë. Përleshja bëhej gjithnjë dhe më e ashpër. Autokolona gjermane kërkonte me çdo kusht të çante rrugën për në Korçë. Nga kodra e pyllëzuar u ngrit një raketë që lëshoi dritë valë-valë, e shoqëruar nga një breshëri e gjatë mitralozi. Komisari kalonte nga një pozicion në tjetrin. Ai vajti te mitralozi që ishte sipër Dinit dhe Nestit duke kontrolluar qitjen dhe shenjestrën.

Pas pak komisari zbriti në pozicionin ku ishte Veloja me Stilianin.

— Ku është Dini?, — pyeti ai dhe në buzë i lundroi një buzëqeshje nevrrike.

— Dinin, ta lidhësh, nuk rri në vend, — iu përgjigj Stilianin, ndërsa Veloja uli kokën sikur të ishte ai fajtor.

— Hë, Din, Din, — shfryu komisari duke pasur në kokë një lëmsh të turbullt mendimesh.

Kështu e kishte ai në çastin e parë kur ndodhej përpara diçkaje të papëlqyeshme, nxehej pak dhe, kur nuk e shfrynte dot inatin, ziente përbrenda vetes. Pastaj qetësohej dhe niste t'i merrte punët shtruar, urtë e butë.

Era vërshëllente në pyllin e vogël. Dëgjoheshin britmat e gjermanëve. Ca zhurma të mbytura dëgjoheshin thellë në tokë sikur zemra e saj të rrihte me hope.

— Ja, e shikoni atë kodër atje, — tha pas pak komisarri dhe ia bëri me dorë nga shpaloseshin kodrat njëra pas tjetrës. — Si duket gjermanët kërkojnë të na marrin krahët. Me zjarrin tuaj të mos i lini gjermanët të futen në luginë. E kuptoni se ç'detyrë keni?

Zëri i tij kësaj radhe tingëlloi burrëror. Atë çast erdhi një nga korrierët e batalionit dhe solli një letër. E dërgonte zëvendëskomandanti. Ai njoftonte se skuadra e parë e kompanisë së tyre që ishte caktuar në mbështetje të grupeve të sulmit, kur kishte parë se gjermanët ishin thyer keq dhe mundoheshin të dilnin nga rrethimi, kishin lënë

pozicionin pa urdhër dhe ishin hedhur në sulm. Kjo i kishte dhënë mundësi një kolone gjermane që vinte nga perëndimi të çante në atë drejtim dhe t'u merrte krahët grupeve të sulmit të kësaj kompanie. Zëvendëskomandanti kërkonte me çdo kusht që të shkëputej një skuadër nga kompania e parë dhe të zinte sa më parë kodrën e kuqe për t'u prerë rrugën gjermanëve.

«Pisk i paskemi punët më duket, pisk», — tha Nesti me vete kur komisarari po lexonte letrën.

— Si drejtin kështu, — tha komisarari dhe futi letrën në xhep, — epo të tërë një kokë paskan! Ptu! Ta marrë drejti, ta marrë!

— E po në sulm janë hedhur de, Ndryshe do të ishte po të kishin lënë pozicionet dhe të tërhiqeshin. Për sulm s'duhej pritur urdhër. Pastaj ne me sulm jemi mësuar, ti vetë na ke mësuar, — tha Veloja e ktheu kryet e buzëqeshi.

— Në sulm, në sulm, — foli komisarari me inat. — Po ja që gjermanët po ju marrin krahët! Shiko se mos lini dhe ju pozicionin dhe hidheni në sulm. Dinit ia rregulloj unë qejfin, — tha i inatosur e puliti sytë e mëdhenj bojë ulliri e mbajti vesh.

Nga qitjet komisarari e kuptoi menjëherë se gjermanët jo vetëm që po merrnin krahët, por ata po i përqëndronin forcat në drejtim të kodrës së pyllëzuar mbi xhade. Mitralozi i tyre «Breda» që ishte vendosur në Shkëmbin e Hamësit heshtte. Pse heshtte ai tani?! Por, edhe kur humbisnin krismat, komisarari e nuhaste luftën. Era frynte dhe sillte erën e barutit.

Disa gjermanë dolën nga përroi dhe morën përpyjet kodrës. Në duart e tyre shkëlqenin automatikët.

— Pas meje, — i tha komisarari korrierit dhe mori brinjë një kodre. Ata e ndoqën një copë herë me sy de-



risa ai kaptoi matanë kodrës. Pas pak në atë anë shpërtheu një duel armësh. Krismat e pushkëve dhe të automatikëve s'kishin të reshtur. Nuk ishte e mundur të merrje vesh se kush shtinte dhe nga shtinin. Në atë kohë, në atë drejtim, çatisi Dini. Ai u ngrit në këmbë në mes të gurëve ngjyrë hiri, ndonëse plumbat i vërshëllenin rreth e rrotull. Si mbushi pushkën dhe bëri granatat e dorës, po vështronte nga të shtinte. Dy gjermanë dolën majë një kodre dhe aty po vendosnin një mitraloz. Nga bishti i kolonës gjermanët filluan qitje me mortajë.

— Gjermanët! Ah, të mallkuar!, — thirri Dini dhe filloi të zvarritej tatëpjetë shpatit në atë drejtim nga kishte ikur komisari. U fut në një përrua të vogël dhe po i ngjitej kodrës përpjetë. Diku mbrapa, nga ana tjetër e rrugës, një automatik qëllonte me breshëri të shkurtra. Një nga gjermanët që vraponte u pengua, pastaj u ngrit përsëri, ashtu i madh siç ishte dhe në dorën e tij të ngritur në sfondin e qiellit ndriti një mitraloz.

Nga krahu tjetër, në drejtim të fshatit Hamës, lëviznin disa njerëz duke shtënë me pushkë dhe duke bërtitur. Fjalët e tyre s'kuptoheshin. Prapa, nga drejtimi i urës, dëgjoheshin shumë zëra në një gjuhë të rëndë, sikur thyeje gurë.

— A, të mallëkuar!, — thirri përsëri Dini.

Një gjerman i këtij grupi që ishte shtrirë barkas, nën zjarrin e partizanëve u sul përpara drejt komisarit duke i dalë nga shpina. Dini shtiu mbi gjermanin. Ai vuuri dorën mbi kraharor sikur të kishte kapur plumbin, bëri disa hapa duke shkuar shtrembër dhe pastaj u plas përdhe.

Po ja, nga një hendek u vërsulën dy gjermanë të tjerë. Me një të hedhur ata do të kapërcenin përroin, po Dini pati kohë të shtinte dhe një herë dhe njëri nga gjer-

manët, duke u kthyer menjëherë si për të parë se kush kishte qëlluar, ra i vdekur në mes të përroit, ndërsa tjetri filloi të vraponte çalë-çalë. Dini mbështeti pushkën pas gurit dhe qëlloi. Gjermani vazhdoi të ecte. Dini qëlloi përsëri, përsëri gjermani ecte ashtu shulazi në mënyrën më qesharake që mund të ecet. Dini qëlloi përsëri dhe gjermani që ecte çal-çalë ndaloi. Hodhi një hap, edhe një tjetër, por iu thyen gjynjët dhe u përkul e u rrëzua mënjane mëngadalë.

Kur po nxirrte me nxitim nga gjerdani fishekë të tjetërë, komisarari e kuptoi se lufta nuk bëhej vetëm te mulliri, por edhe përtej, në kodrën e Hamësit. Gjermanët ishin hëdhur në kundërsulm dhe po u merrnin krahët. Komisarari mbushi pushkën me fishekë, por atë çast nga ana e djathtë u dëgjuan britma dhe të shtëna. Disa gjermanë kishin dalë fshehurazi nga një luginë, që prapa kodrës. Ata, sa panë komisararin, shtinë me mitraloz drejt kodrës.

Dini nxori nga brezi një granatë dhe ua hodhi gjermanëve me aq fuqi, sa granata shpërtheu në ajër. Para se ta kuptonte se ç'kishte ndodhur pas shpërthimit të granatës, hodhi dhe një tjetër mbi grumbujt e tymit. Kur dëgjoi klithmën dhe rënkimin, u vërsul përpara sikur ta kishte rrëmbyer një valë e furishme.

— Këtej! E jani pas meje, — dëgjoi zërin e komisararit. Dini të gjithë krerët e fishekëve që kishte pasur i kishte nxjerrë nga gjerdani. Shtriu dorën në gjerdan, po atje s'kishte asnjë fishek. «Ta marrë djalli», — bërtiti duke kërkuar nëpër xhepa dhe menjëherë iu kujtuan fjalët e Velos, që në një mbledhje kishte kritikuar disa partizanë të skuadrës së tij: «Ju që harxhoni fishekë pa nikoqirllëk nuk jeni hiç në rregull. Partizani duhet të qëllojë plot, drejt e në shenjë dhe, për të qenë tamam partizan, drejt e në kokë. Një fishek, një armik. Ja, ti, — i kishte



thënë atë ditë Dinit, — ke harxhuar sot gjithë gjerdanin, po sa fashistë ke vrarë? Një ose dy, hajde ta zëmë dhjetë; po më shumë s'ke vrarë. Se atëherë do të qelbej vendi, po fishekët e tjerë ku të kanë shkuar? Hë de, fol».

Veloja e kishte zakon t'i qortonte të gjithë partizanët që sipas tij nuk ishin në rregull. Stilianin e qortonte për gjumin e tij të rëndë, Nestin, për shpirtin e justifikimit, kurse Dinin se ishte i rrëmbyer në luftë dhe harxhonte fishekë me vend e pa vend.

Që nga vija e një mulliri të shkatërruar që ishte aty pranë doli me vrull një gjerman i gjatë me helmetë në kokë. E vuri automatikun në gjoks dhe shkeli këmbëzën. Plumbat kaluan pranë komisarit. Ai e kuptoi menjëherë se gjermani nuk e kishte vënë re, se shtinte kuturu. Po atë çast Dini e qëlloi që nga prapa me qytën e pushkës.

— E, ek!, — bërtiti gjermani dhe ra pranë filaqisë. Ai kishte qafë të gjatë dhe damarë të fryrë.

Duke menduar kushedi për çfarë arsye se pushka pa fishekë e kishte bërë punën e saj, e hodhi në tokë dhe iu hodh gjermanit që mundohej të kthehej në bark duke u kapur pas një trari. Dini e kapi dhe e ktheu menjëherë në kurriz. Gjermanit i kullonte gjak nga hunda. Dhëmbët e tij të mëdhenj i kishin dalë jashtë, sepse mundohej të bërtiste. Dini mendonte ç't'i bënte gjermanit. Mori përsëri pushkën dhe me të e goditi disa herë.

— Na, qen! Na! Na! ...

Erdhi në vete kur ndjeu se dikush e largoi nga gjermani.

— Dale, — bërtiti komisar i duke u kërrusur. — Prit.

Dini s'e njohu aty komisarin. I kapitur siç qe u mbështet pas murit dhe e vështroi një copë herë, pastaj pa partizanët që vraponin duke u ngjitur kodrës përpjetë. Krismat e pushkëve dhe të mitralozave vazhdonin përtej urës. Dini i buzëqeshi komisarit.

Sulmet dhe kundrasulmet në Grykën e Dakës vazhduan për disa orë rresht pa ndërprerje. Gjermanët, duke parë se ishte e pamundur të hapej rruga me ato forca të goditura rëndë dhe të demoralizuara, sollën forca të reja nga qyteti dhe nisën sulmin në disa drejtime. Përleshja e sulmit të dytë qe shumë e ashpër dhe pushtuesit u thyen keq duke lënë të vrarë e të plagosur. Pastaj gjermanët organizuan përsëri një sulm, por batalioni e kishte bërë punën e tij dhe ishte tërhequr për në pyllin e Zelit.

\*

\* \* \*

Pas një ore Dini me një partizan tjetër i shpunë komisarit një rob gjerman. Ishte i gjatë dhe i thatë si një purtekë, po kishte një fytyrë energjike. Ai vuri duart nga mbrapa, u mbështet pas një lisi dhe vështronte rreth tij i qetë, duke ngritur lart flokët e tij të verdhë dhe të prishur. Dukej sikur s'donte t'ia dinte fare se e kishin zënë rob. Ai vështronte me mospërfillje, sikur shikonte nëpërmjet një xhami.

— Si qenka!, — tha me vete Veloja duke vështruar gjermanin. Dinit i dukej sikur kishte përpara jo një njeri, por një egërsirë.

Veloja bëri një hap para dhe e pyeti:

— E ç'ke që vështron kështu, o malukat, apo të erdhi ngordhja. Tyt, lanet. — Gjermani e vështroi atë si me përçmim e arrogancë.

— S'flet, hë?, — tha Veloja dhe bëri dy hapa drejt gjermanit. Ai kishte hapur këmbët. Mori qëndrim gatitu dhe e vështroi me sy të shqyer nga frika.

— Si e ke emrin?, — e pyeti komisar i talisht.



Gjermani ngurroi herën e parë t'i përgjigjej, po pastaj, duke shtënë gjetkë sytë e thelluar në zgavra, u përgjigj:

— Lubi.

— T'ëmën, — tha Dini, — më paske marrë emrin e genit.

Partizanët ia plasën të qeshurit, po gjermani nuk e kuptonte pse qeshnin ata.

Fytyra e tij e humbi krejt gjallërinë dhe buzët iu zbardhën pak nga pak.

— Meqë marrke vesh italisht, — tha komisari, — mëso atëherë se ushtria gjermane mori të tatëpjetën, kudo po i thyejnë hundët.

— Ushtria gjermane është akoma e fortë, — u përgjigj me ngulm gjermani dhe fytyra e tij sikur përgjonte një thirrje të fshehtë pas pyllit, pas malit.

— Ashtu?!, — ia priti komisari me fytyrë të qetë dhe padashur vuri dorën në revole.

Gjermani u drodh. Si dukej nuk besonte në mbrojtjen e robërve që u jepte ligji i luftës.

— Do të më vrasësh?, — pyeti gjermani, zëri i të cilit këtë radhë ishte pa tingull, si i shuar. Pastaj lëshoi një pëshpërimë të pafuqishme, e cila dukej se ia harxhoi gjithë fuqitë që i kishin ngelur.

— Jo, jo, — u përgjigj komisari me vendosmëri. — Ne i respektojmë ligjet e luftës, po ti nuk do të shpëtosh pa dhënë llogari deri në fund.

— Vërtet!, — u çudit gjermani dhe ngriti sytë për-pjetë sikur të falej, pastaj rënkoi prapë si një foshnje që është rrëzuar përdhe dhe s'mund të ngrihet.

— Ku ke luftuar gjetkë?

— Në Belgjikë, Greqi, Francë, — nisi të murmuronte gjermani dhe uli sytë përtokë, si sytë e një kau të the-rur.

— Po tani jeni në Shqipëri, — tha komisari, — apo jo?, — dhe vuri buzën në gaz me ironi.

— O, o, Albania, — rënkoi gjermani dhe mori frymë thellë e me vete tha: «Mallëkuar qoftë ky vend! Një vend i tillë! Një popull i tillë!».

— Mbye mend këtë vend e këtë popull, — tha komisar i sikur t'ia lexonte mendimet. — Nuk e dinit këtë gjë? Nuk pandehnit se ishte kështu?

— Jo, — foli gjermani, duke e shikuar me ata sytë e skuqur dhe të egër.

— Je oficer, apo jo?, — pyeti komisar i.

— Po, oficer i ushtrisë gjermane.

— Je oficer i keq, — i tha komisar i. — Nuk e njeh historinë e fuqinë e popullit.

Gjermani ull kokën. Ai mori pamjen e një qeni të rrahur keq dhe që pret dajakë të tjerë.

Komisari nxori kutinë e duhanit, drodhi një cigare dhe pastaj ua zgjati shokëve.

— Hajdeni, or shokë, ndizeni dhe ju njëherë. Sot e bëmë fora. Ky nuk besoj të jetë i vetmi rob.

— E ç'do të bëjmë me këtë, o komisar?, — pyeti Veloja, të cilit i dhembnin sytë kur shikonte oficerin.

— Do ta çojmë në shtab e do ta detyrojmë të flasë, pastaj në djall të vejë, — shfryu komisar i.

— Unë them ta pyesim ne e ta qërojmë, s'e shoh dot, — foli sërish Veloja.

— Jo, jo, kemi porosi nga shtabi. Kush do ta çojë, ë?

Asnjë nga partizanët nuk doli vullnetar që ta çonte gjermanin deri në shtab. Asnjë s'kishte qejf të rrinte me atë bishë.

— E çoj unë, — tha Veloja e kroi dorën.

— Jo, jo, — kundërshtoi komisar i.

Të gjithë ia dhanë të qeshurit.



## KAPITULLI VIII

Dimër. Dëbora kishte zbardhur tërë krahinën. Njerëzit që kishin mbetur në fshat shtrëngoheshin përreth zjarrit, kurse ndër male vazhdonte operacioni i parë armik.

Atë ditë binte një dëborë e dendur, e përzier si me shi. Qielli gri ishte ulur fare poshtë dhe dukej sikur do të rrëzohej. Partizanët lëviznin në heshtje në të tatëpjetën e malit. I priste një udhëtim i gjatë dhe plot rreziqe. Ishin ngarkuar nga komanda e batalionit me mision zbulimi në prapavijë të armikut për të vendosur lidhje me forcat territoriale të disa fshatrave dhe njëkohësisht do të shpinin një postë me rëndësi në fshatin Lenicë që i dërgohej Komitetit Qarkor.

Rruga shtrihej e errët, e vdekur dhe gati kërcënuese. Dëbora çahet me vështirësi. Trashësia e saj arrinte mbi gju. Dëgjohej vetëm zhurma e hapave mbi dëborë, e cila vazhdonte të binte dendur dhe me flokë të mëdhenj. Shtresa e bardhë dalngadalë u mbuloi supet e armët. Një lepur sillej si i marrosur përmes pyllit. Era priste si brisk. Ata kishin ftohtë dhe fërkonin duart. Veloja printe përpara dhe të tjerët pas tij. Befas ai ndaloi përfund një

shkëmbi të madh. Kishte filluar të errej. Çdo gjë dukej sikur kishte rënë në gjumin e thellë.

— Kështu pra, — filloi të fliste Veloja. — Nëpër fshat do të kalojmë. S'ka rrugë tjetër. Kur të arrijmë tek ata dy lisat e gjatë, do të bëjmë majtas. Në krye do të jem unë. Sa të kalojmë fshatin, as gëk, as mëk, se ku dihet, mund të ketë gjermanë e ballistë. Më kuptuat? Asnjë pëshpëritje. Tani e tutje do të ecim dhjetë hapa larg njëri-tjetrit. Ruani lidhjet me anë të të parit me atë që keni përpara, por mos u afroni shumë. Në na diktofshin dhe qëllofshin, bini përdhe dhe mos u përgjigjni pa shtënë unë. Në qoftë se do të më ndodhë gjë mua, le që s'më ndodh gjë, komandën do ta marrë Dini. Në qoftë se gjatë përpjekjes ndonjëri do të humbasë drejtimin apo do të shkëputet nga shokët, vendi i takimit do të jetë te mulliri i Jaupit. Ka ndonjë pyetje?

— Jo, — iu përgjigjën ata.

— Mirë, nisemi, — urdhëroi Veloja. Megjithëse rru-dha midis vetullave iu thellua, buzëqeshi ëmbël i përgjurmur. — Na qoftë për hajër, pra!, — pëshpëriti dhe u nis. Pas tij u nis Rustemi, Nesti që i treti dhe në fund Dini.

Kohë më kohë diçka trokëllinte lehtë. Ishte Rustemi që hidhte pushkën nga njëri sup në tjetrin. Veloja ndali, e qortoi dhe ai s'u ndie më. U futën në lagjen e sipërme të fshatit dhe zbrisnin në të poshtë. Këmbët s'u mbahe-shin gjëkund dhe atyre u dukej sikur i kishin hipur një karroce që e tërhiqnin tre kuaj të hazdisur përmes një fushë me gropa. Thuhej se fshati ishte mbushur plot e përplot me ballistë e gjermanë, por ata nuk po diktonin asgjë të dyshimtë, nuk po ndesheshin as me rojet e natës. Diku larg në lagjen tjetër të fshatit u dëgjuan disa zëra dhe lehje qensh, por ata u shuan në terrin e natës. Moti nisi të ftohej, megjithëse vazhdonte të binte po ajo dë-



borë. Era frynte si e harlisur. Veloja ngriti jakën e xhakëtës, dalloi me zor shokët e i erdhi keq që asnjëri nuk kishte kapotë. Të katër shokët ecnin me kujdes. Rustemi që ecte përpara Nestit bëri djathtas e sikur humbi nga sytë e shokëve. Mbas dy minutash Nesti e vuri re Rustemin anës një gardhi, që shpejtoi hapin e u pengua pas një rrënje, por, aty për aty, u ngrit dhe kaloi përmes një kopshti duke u munduar që të mos i ndahej Velos që ishte përpara.

Pas gjysmë ore Nesti u gjend përpara një përroi nja tre metra të gjerë. Nuk dinte sa i thellë ishte, por, duke menduar se Rustemi që ishte përpara tij do ta kishte kaluar, u fut nëpër ujë. Ai ishte i ftohtë dhe i erdhi deri në gju. Megjithëse përroin e kaloi mirë e bukur, prapëseprapë s'po e shihte më Rustemin e s'dinte nga t'ia mbante. Për fat të mirë nga e djathta Nesti pa një dritë dhe pas pak dëgjoji lehjen e një qeni. Vendosi të ecte në atë drejtim për të arritur shokët.

Pas pak doli në një vend si të sheshtë dhe u mbështet pas një gorrice. Atje po mendohej se nga t'ia mbante. Dini që ishte pas tij po afrohej. Në atë çast Nesti pa tre vetë që vinin drejt tij. Ia bëri me shenjë Dinit që të ndalej në vend dhe të mos lëvizte më. Ata sa vinin e po afroheshin. Nesti ra barkas për t'u fshehur e për të marrë pak frymë. Ata bënë pak djathtas dhe u ndalën disa metra larg, pas një lisniku, dhe filluan të pinin duhan.

— Gjermanët priten të vijnë nesër në mëngjes, — tha njëri nga ballistët. — Janë një batalion i tërë. — Shtoi dhe disa fjalë të tjera, por Nesti nuk i dëgjoji dot. Ai nuk mbante mend të kishte pasur ndonjëherë një shqetësim të tillë. Zemra filloi t'i rrihte më fort, saqë i dukej se ballistët do të dëgjonin të rrahurat e saj e do të hapnin zjarr. Ai dhe mund t'i vriste të tre ballistët, por ç'ti bënte ur-

dhrit kategorik që kishte për të mos hapur zjarr. Ku të ishte Veloja me Rustemin vallë?

Kaluan pesë minuta, edhe pesë të tjera. Ballistët s'luanin nga vendi, ndërsa Nestit mbi të gjitha filluan t'i kërcisnin dhëmbët dhe t'i shtirej keq për duhan. Mendoi t'ua ngopte njëherë me automatik pa le të dilte ku të dilte, por u përmbajt. Të tre ballistët seç llototishin njëri me tjetrin dhe bënë në atë drejtim nga kishin ardhur. Siç duket, ajo ishte një nga patrullat e natës.

Nesti qëndroi në vend, se nuk dinte nga të shkonte. Kishte humbur Rustemin e Velon.

Ra një mjegull e dendur që u bë ortake e natës e që të dyja si motra tinzare nuk i lejonin të shikonin shokun goftë edhe një hap para.

«E, drej o punë, — tha Nesti me vete. — Po dhe ky Veloja me Rustemin si shkëputen kaq shpejt?». Nesti u ndal dhe priti Dinin që kishte pas. Tani ata nuk dinin si të bënë, të ecnin përpara apo të qëndronin në vend. Era përsëri vazhdonte avazin e saj. Degët e lisave lëkundeshin sa andej-këndej. Pak nga pak mjegulla sikur filloi të shpërndahej e ata panë një dritë që shuhej e ndizej.

— Të jetë Veloja ky që na jep shenjë?, — pyeti Nesti.

— Veloja s'ka se si të japë shenjë, se zbulohet?

— Po ç'të bëjmë atëherë?, — pyeti Nesti.

— Ecim, s'kemi ç'të bëjmë tjetër, — tha Dini e lëvizën. Shokët s'po i takonin gjëkund. Të dy njëri pas tjetrit zbritën në të poshtë duke çarë rrugën.

Dini me Nestin kishin marrë një drejtim të gabuar. Kishin hyrë në një nga lagjet e fshatit e vinin vërdallë nëpër të dhe nuk po gjenin dot rrugën për të dalë. Nga larg arriti deri tek ata një e shkrehur pushke. Ata kishin qëndruar në vend. Jo shumë larg, kundrejt tyre, u dëgju-



an thirrje dhe të qeshura. Duhej të ishin ballistë. Dini po vështronte me kujdes pas një gardhi. Dini iu qas pranë Nestit, i vuri buzën në vesh dhe i pëshpëriti:

— Këtu përpara, nga e majta, lëvizi një hije e zezë. Si duket ndonjë patrullë Balli. Apo mos është Veloja me Rustemin e na presin ne?

Nesti mblodhi supet.

— Ti, Nesti, rri këtu dhe mos lëviz nga vendi. Unë do të bëj pak përpara, në atë drejtim, dhe do të shoh se ç'drejin janë ata. Pas pak do të kthehem dhe do të vendosim se ç'duhet bërë.

Dhe u nis. Për të mos bërë zhurmë gjatë lëvizjes, Dini hidhte më përpara thembrën pastaj putrën.

Jo shumë larg tij ai dëgjoi thirrje dhe të qeshura. U bind se ishin ballistë. Disa metra më tutje, në anë të një lëmi, një si hije e zezë qëndronte varur në degën e një arre.

«Po kjo ç'të jetë?!, — u çudit Dini dhe për një çast ndali në vend si i ngrirë. Mos më bëjnë sytë?». Qëndroi sa qëndroi dhe mori anës së gardhit e, pa u diktuar nga askush, iu afrua hijes së zezë. Një qen që ishte shtrirë mu në pragun e derës së plevicës, karshi hijes së zezë, u ngrit i trembur dhe bëri tutje. Papritmas Dini iu errësuan sytë dhe zemra nisi t'i rrihte me forcë. Para tij qëndronte një njeri i varur! Ai u habit nga kjo ndodhi e papritur dhe e llahtarshme. I ngrirë në vend i dukej sikur ishte në ëndërr. Ashtu, me nerva të tendosura, dha e mori se mos e njihte, por nuk e dalloj dot. Dini e mori me mend se i varuri duhej të ishte ndonjë aktivist i Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Zemra i ziente nga urrejtja dhe sytë iu mbushën me lotë. Nuk dinte si të bënte. Tek qëndronte mbështetur mbas derës së plevicës, karshi të varurit, i dukej vetja si një i verbër që ecën pa parë se ku hedh këmbën dhe pa e kuptuar se ku ndodhet.

Nestit iu duk sikur e zuri gjumi nga pritja e gjatë. Pas pak u kthye Dini dhe i tregoi ç'kishte parë. Nga larg arriti deri tek ata një e shkrehur pushke, pastaj dhe një tjetër. Ata vazhdonin të qëndronin në vend si të ngulur, pastaj vazhduan lëvizjen në drejtim të të varurit, ngaqë s'kishte nga të kalonin gjatë.

Dini u ndal në vend, u mbështet pas gardhit dhe ia bëri me shenjë Nestit që të afrohej.

— Nesti!, — i pëshpëriti duke e kapur për krahu. — Po sikur ta heqim nga litari, ë?

— Ta heqim?!, — u habit Nesti.

— Asnjë hap s'bëj unë pa e hequr atë që andej. Ai me siguri është...

— E kuptoj, e kuptoj, — e ndërpreu Nesti, — po pastaj ç'do të bëjmë me të, ta tërheqim?

— Mjafton që ta zbresim në tokë. Të mos e lëmë ashtu të varur. Ai e meriton një nder të tillë, pavarësisht se nuk e njohim kush është dhe nga është, pastaj kjo do të jetë një përgjigje për armiqtë...

— Mirë, veç një çikë shpejt, se do të na zërë dita në rrugë, — shtoi Nesti.

— Ke thikë?, — pyeti Dini.

— Po.

Dini hipi në arrë dhe mundohej të priste litarin, ndërsa Nesti e mbante të varurin nga këmbët e ngrira kallkan që, kur të këputej litari, të mos binte poshtë me zhurmë. E morën njeriun dhe me kujdes e shtrinë në pragun e derës së plevicës, sikur të donin ta mbronin nga dëbora dhe era që frynte me tërsëllëmë. Duke qenë pranë njeriut të varur, ndienin si në trupin e tyre vuajtjet që kishte hequr ai.

Nga sipër u dëgjua një zhurmë. Të dy shokët mbajtën vesh. Zhurma po bëhej më e fuqishme. Nja shtatë a tetë



metra afër tyre u duk një ballist me pushkë në dorë. Dini pati frikë se mos ballisti kishte diktuar gjë. Ai përfytyronte sikur ballisti mbante vesh e mundohej të diktonte gjë përmes errësirës. Ballisti nuk u afrua më. Pas një minute u kthye dhe u zhduk në terrin e natës.

— Si duket gjermanët e ballistët. . . , — filloi të fliste Nesti.

— Mbylle të shkretën, — e qortoi Dini dhe i vuri dorën në gojë.

Ata pritën dhe nja pesë minuta e pastaj bënë përpas. Tani duhej me të vërtetë kujdes, sepse kishin hyrë thellë mu në brendësi të fshatit të mbushur me ballistë.

Ora po kalonte dymbëdhjetë e gjysmë pas mesnate. Një mjegull ngjyrë plumbi kishte mbuluar gjithë luginën. Dalngadalë ajo shtrihej tej në horizontin e përgjumur dhe dëborë vazhdonte të binte me copa të mëdha. Të ftohët u bë i madh. Dini ia bëri me shenjë Nestit dhe ata u nisën. Pa bërë as njëqind hapa, u ndeshën ballë për ballë me një patrullë tjetër. Balli që ishte sipër rrugës mbështetur pas mureve të një plevice të rrënuar. Ballistët bërtitën dhe dikush ia dha një breshërie të gjatë qitjesh me automatik që u fishkëlleu mbi kokë Dinit e Nestit.

Flakë për flakë shtinë dhe ata. Njëri nga ballistët bërtiti me të madhe dhe ra përtokë. Të tjerët zunë pozicion në muret e rrënuara të plevicës dhe qëllonin pa pushim. Pastaj ballistët vërtitën dy granata njërin pas tjetrës dhe filluan të shtinin me pushkë e automatik në drejtim të tyre. Dini bëri pak majtas dhe mori tatëpjetë një brinje duke kaluar anës një gardhi dhe i humbi Nestit nga sytë. Tek lëvizte, ndjeu një dhembje të madhe dhe lëshoi një thirrje të përmbajtur! Ktheu kokën dhe bëri të çelte sytë, por balta e përzier me dëborë nga shpërthimi i granatës që i plasi aty pranë i qe ngjitur në fytyrë. Me zor të madh

afroi dorën e djathtë dhe fërkoi sytë se mos ishte qorruar! I çeli sytë e s'pa asgjë. «U qorrova!, — tha e, ngaqë s'donte të besonte, i foli vetes: Jo! Dale! Dale të pres. Si ndodhi kështu!». Mblodhi tërë forcat e tij si një i këputur dhe i rraskapitur nga lodhja, duke u mbajtur pas një rrënje druri, u shkund e u rrokullis tatëpjetë si një kërcu lisi duke ndier dhembje në gjithë trupin! Nuk duroi dot dhe u shtri në kurriz. Dëbora i binte në fytyrë. Ngriti dorën e majtë dhe fshiu sytë e hoqi së andejmi baltën që ia kishte përplasur në fytyrë granata. Atëherë pa dhe përnjëherësh filloi të kërkonte Nestin, i cili në atë çast kur kishte plasur granata ishte rrokullisur tatëpjetë brinjës dhe kishte marrë rrokullimën thellë në përrua. Nesti pushtoi me duar një shelg të hollë që u hepua nga peshja e tij. Duart i shkanë në nëpër lëkurën e drurit që ishte mbuluar me dëborë dhe mbeti ashtu i varur për disa çaste si zog. Pastaj u nis në atë drejtim për t'u takuar përsëri me Dinin. Ecte e kthente kokën sa djathtas e majtas, hapte sytë e veshët, por nuk pa e s'dëgjoji gjë. Si erdhi disa herë rrotull, mori të tatëpjetën pikë e vrer që nuk po takohej me Dinin. Jo shumë larg tij, në krahun e majtë, dëgjoji zhurmë dhe britma njerëzish. Nesti qëlloi në ecje e sipër. E dinte që asnjë prej plumbave nuk do të zinte në mish, po të paktën ai e pas-troi rrugën për disa çaste të vështira. Qëlloi dhe një herë. Plumbi cifloi një gur.

Ballistët që e diktuan s'arritën të qëllonin, sepse Nesti dredhonte shpejt dhe u humbiste nga sytë. Ku mund të shihje në atë mjegull!

Në këtë kohë Dini u hoq zvarë dhe u fut në një përrua. Këmba e djathtë i qe bërë e rëndë, megjithatë vazhdoi të zvarisej duke kujtuar se mos takohej me Nestin. Po Nesti s'dukej kurrkund. Dini qëndroi dhe e ndjeu se po e linin fuqitë.



«Po sikur të ketë pësuar gjë Nesti? Jo! jo! Asgjë nuk ka pësuar. Ai do të ketë arritur te shokët dhe me siguri që presin te mulliri i Jaupit!», — tha e mori kurajë nga ky mendim e vazhdoi të zvarisej. Pas dy-tre metrash iu morën mendtë dhe ndjeu një shije të keqe në gojë e një mendim i keq i ra në kokë. «Po sikur të më ndjekin ballistët pas gjurmëve të gjakut?».

«Oh, — rënkoi dhe ndërroi drejtim. — Nuk bën t'i shpie gjurmët drejt e te mulliri i Jaupit. Do të marr në qafë shokët». Mblodhi menjëherë tërë forcat dhe u zvarit e u zvarit derisa iu afrua një shtëpie që ishte përfund fshatit. Nga dhembjet e forta i humbi ndjenjat për një çast e ra në një qetësi të plotë e joshëse.

\* \* \*

Veloja me Rustemin qëndronin te mulliri në pritje të shokëve. Ata herë pas here i hidhnin sytë qiellit, i cili nga çasti në çast përçohet nga ngjyra të ndryshme raketash e fishekzarësh. Tani për tani çdo gjë ishte e qartë. Orët kalonin dhe shokët e tyre nuk po dukeshin akoma.

Veloja filozofonte me vete dhe mendohej të bindte Rustemin që asgjë e keqe s'kishte ndodhur.

— Erdhën, erdhën! Paskan shpëtuar, — thirri i lehtësuar Rustemi dhe zemra filloi t'i regëtinte me gëzim kur dëgjoi zhurmën dhe pa një hije që vinte në drejtim të mullirit.

— Mos thirr, — e qortoi Veloja me zë të ulët. — Era i shpie armikut zërat në vesh.

— Po shikoje mirë, është Nesti, — tha me zë të ulët Rustemi dhe i doli përpara. Të dy shokët e rrethuan Nes-

tin dhe e shikonin me vërejtje në fytyrë. Ishtë ora dy pas mesnate. Krisma e pushkëve kishte pushuar. Vetëm tek-tuk dëgjohej ndonjë oshëtimë krisme diku thellë, por edhe këto filluan të rralloheshin. Muret e mullirit nxinin dhe filaqia dukej si zgavër e një të verbri. Ajo ngrinte avuj dhe Nestit i dukej si ndonjë varkë e përmbysur.

— Po Dini s'ka ardhur akoma?!, — pyeti Nesti dhe u pre në fytyrë.

— Në mos ka ardhur, do të vijë, — iu përgjigj Veloja. — Është finok i madh e nuk bie në kurth kollaj ai...

— Mor, po lëri ato, — e ndërpreu Nesti. — Unë kujtova se do të kishte ardhur, pa s'vija i gjallë këtu. Hajde të nisemi ta kërkojmë, se ku dihet ç'mund t'i ketë ndodhur?

— Po prisni, mor jahu, është shpejt të dëshpërohem i që tani, — filloi të fliste Veloja, kur pa se ata të dy kishin rrudhur fytyrën me një qederosje të madhe dhe ngulnin këmbë që të kërkonin Dinin.

— Nuk ma ndjell zemra kurrë të keqen, — tha Veloja më shumë për të qetësuar shokët...

— Ohu, na mbushe mendjen, — ia ktheu Rustemi, sikur të tëra fajet t'i kishte pasur Veloja. — Po s'erdhi deri në mëngjes...

— Pse deri në mëngjes, — pyeti Veloja dhe pa Nestin me ata sy të mëdhenj, me atë vështrim si të harruar.

— Sepse vetëm natën mund të lëvizë ai, — pohoi Nesti. — Në mëngjes ata i zënë të gjitha shtigjet e nuk çan dot, sikur mizë të bëhesh, — dhe u lëshua përpara për të gjetur Dinin, po nuk mundi të bënte as dy hapa. Iu errësua gjithçka sikur të mos ishte mëngjes që po agonte, po nata që po binte, dhe u rrëzua. Rustemi që ishte më pranë e kapi dhe nuk e la të binte. Si e vendosi me kujdes për tokë, pa duart e tij të lyera tërë gjak.



— Po ky qenka i plagosur, o Velo!, — thirri i habitur e hoqi xhaketën dhe ia vuri nën kokë. Veloja i foli disa herë me emër, por Nesti nuk i ktheu përgjigje. Ballin e Nestit e mbuloi një djersë e ftohtë. Pas pak ai u përmend dhe me sytë gjysmë të mbyllur mezi shqiptoi:

— Eh, more Din!...

Pa mbaruar mirë fjalën, ia dha të vjellit, një të vjelli me gjak.

Rustemi u çua i alarmuar në këmbë dhe desh thirri me të madhe, por e mbajti veten. Ndërsa Velos i kaloi një fije shqetësimi.

— Ç't'i ketë ndodhur?!, — pyeti Rustemi dhe ngriti vetullat si me një farë çudie.

— Nuk di si të them. Duhet të ketë humbur shumë gjak, — tha Veloja dhe me duart e mëdha e kapi Nestin, e rrotulloi, ia lidhi plagën që të mos i kullonte dhe më gjak e mori frymë i dëshpëruar.

— M'u zbardh qimja e kokës e çoç kam mësuar edhe unë nga kjo qerrata jetë.

Në këtë kohë e sipër filluan përsëri të çanin qiellin raketat me ngjyra të ndryshme, por këtë radhë ato vinin si nga verilindja.

— Keq e kemi!, — tha nëpër hundë Veloja. — Si duket gjermani ka çatisur në Qafmollë dhe, po që se janë të vërteta ato që dëgjuam nga ballistët, për një sahat, të shumtën për dy, në mëngjes kumbis në Lushakë.

---

Mjegulla jo vetëm që nuk po përhapej, por përkundrazi bëhej gjithnjë e më e dendur duke iu afruar gjithnjë e më tepër tokës. Era e fortë e mëngjesit, që frynte e lëmonte fytyrat e tyre, nuk ndihmoi aspak në shpërndarjen e mjegullës. Ata ndienin sikur fytyrat e tyre ua prekte

diçka e lagur. Nuk mund të vazhdonin rrugën pa ardhur Dini.

— Tani duhet të këndojnë këndesat, — filloi të fliste Veloja, — tani zbardhëllen dita, — tha e u mbështet pas murit sikur t'i vinte veshin ndonjë zhurme në thellësi të tokës.

Befas nga e djathta u dëgjuan të shtëna pushke dhe atyre menjëherë iu përgjigjën automatikët e mitralozat gjermanë. Ç'kishte ndodhur vallë?! Gjermanët kishin hedhur lumin dhe kishin ndalur në bregun perëndimor të tij, megjulla nuk i linte të orientoheshin dhe ata kishin ndalur në vend si qen të mbytur në baltë.

— Hajde, shpejt, Rustem!, — urdhëroi Veloja. — Hidhe në shpinë Nestin dhe nisu shpejt, një rrugë e dy punë. Kjo rrugë, demek rrugë, se dhitë e kanë hapur, do të të nxjerrë në një kasolle që është në fund të pyllit. Mos ki frikë, çobani është njeriu ynë. I thuaj që je nga shokët e Velos. I thuaj se ç'po ndodh këtu. Ama si të fluturosh, si zog. Mbasi ta lësh Nestin atje, kthehu po kësaj rruge. Kur të vish te mulliri, ngjitu përroit përpjetë. Po erdhi Dini aty, mu në Qafë të Dëllinjës te shkëmbi i zi po të pres, sepse që aty do të të siguroj rrugën ty që ta kesh të lirë kur të kthehesh. Që aty e çorientojmë dhe gjermanin, goftë edhe për një orë. Ata me siguri atë rrugë do të ndjekin kur të hapet dita. Po ky qerrata Din pse s'po duket akoma?!

— Më lini këtu!, — u lut Nesti që u përmend. — Në pyll gjermanët dhe ballistët s'kanë për të më gjetur, ejani në mbrëmje dhe më merrni.

— Mjaft, — ia priti Veloja. — Dëgjo ç'të them unë dhe mos fol, se do të bëhesh më keq, — e këshilloi dhe e puthi në ballë. Mbi qepalla i rëndonte dëbora si strehë.

Rustemi hodhi shokun në shpinë dhe u nis për atje



ku urdhëroi Veloja. Nesti sëç murmuriste me vete paresh-tur, ai e ndërpriste monologun e vet atëherë kur humbis-te ndjenjat. Atëherë dëgjoheshin më qartë hapat e Ruste-mit që shkelnin mbi borën.

Papritur u dolën tre vetë përpara sikur t'i kishte pje-llë dheu. Rustemi u kthye menjëherë mbrapa dhe u nis me vrap nga kishte ardhur.

— Prit, ore, ku shkon!, — i foli njëri nga ata me një zë të ngrohtë. — Jemi shokët tuaj.

Por Rustemi, edhe kur dëgjoi fjalët e tyre, s'luajti nga vendi. Ai kishte zënë pozicion. Zemra filloi t'i regëtinte më me shpejtësi dhe gjaku t'i buçiste më me vrull nëpër damarë.

«Ti s'më tremb mua», — tha me vete Rustemi e u mbështet pas një shkëmbi dhe u bë gati të qëllonte.

Ata të tre pa u bërë merak nga tyta e pushkës së Rus-temit vazhduan të afroheshin.

— Ore, jemi, ne barinjtë, — thirri ai që kish folur më parë!

— Ashtu? Nuk ju prisja t'ju takoja kaq shpejt.

U dëgjuan lehje qensh. Pastaj zëri i çobanit që u flis-te bagëtive. Iu përftua era e qumështit dhe Rustemi lëpiu buzët, po pozicionin nuk e lëshoi.

— Na, — i thirri ai prapë dhe i hodhi pushkën e tij. — Po deshe, vramë me armën time.

Vetëm atëherë Rustemi e kuptoi dhe u bind që ishin vërtet barijt, të cilët e ndihmuan për ta shpënë Nestin atje ku e kishte porositur Veloja. Nga ata Rustemi dhe Nesti që kish ardhur në vete morën vesh se njeriu i varur ishte një i ri komunist, i kapur në befasi nga ballistët. Rustemi dha porositë e Velos, e u lëshua teposhtë.

Veloja me Rustemin kishin zënë vend në Qafën e Dëllinjës dhe kishin drejtuar armët përpara. Filluan t'u kërcisnin dhëmbët nga acari i atij mëngjesi të ftohtë. Nuk kishin ngrënë asnjë kafshatë bukë përveç pak mish deleje të pjekur pa kripë që solli Rustemi me vete nga stani. Përmes pyjeve e maleve gjatë Operacionit të Dimrit nuk gjeje asgjë për të larguar urinë. Egërsirat kishin zbritur në vendet më të ulëta, sepse s'kishin ç'të hanin. Ato shpesh kërkonin shkurre dëllinjash për t'u marrë kokrrat.

Fshati u shfaq papritur përtej lumit, ashtu i dremitur, me tymin e zi të oxhakut që sillej në hapësirë. Një kuisje qeni e largët arriti gjer te veshët e tyre dhe përhapej në hapësirë si një murmuritje e përgjumur. Re të shumta dyndeshin nga malet dhe derdhnin mbi tokë frymën e tyre të ftohtë. Me flegrat e hundës Veloja nuhati kundërmimin e fshatit. Po frynte erë. Në krye të fshatit ishte një lis i madh. Atje ishin varret e fshatit të mbuluara me dëborë. Veloja kishte zgjedhur si mburojë një gur të madh. Që aty vrojtonte më mirë të tatëpjetën që kishte përpara dhe pllajën përkarshi. Gjermanët po i ngjiteshin së përpjetës të qetë. Ishte pararoja. Në krye të kolonës ishin katër ballistë. Ku ta dinin ata se në atë qafë, pas atyre shkëmbinjve, qëndronin dy partizanë. Velos dhe Rustemit u vlon-te zemra nga urrejtja, u vlon-te për hakmarrje, por kishin urdhër të mos binin në kontakt me armikun.

Veloja atë ditë në kundërshtim me natyrën e tij dukej i ngrysur. Fytyra i kishte marrë ngjyrën e dheut. Don-te me çdo kusht që të thyente atë heshtje të zymtë.

Ai donte të thoshte diçka, aq sa të thyente heshtjen. Pastaj do të thoshte diçka edhe Rustemi. Po as njëri, as tjetri nuk flisnin.



— Po fol, mëre balukegjati i xhaxhait?, — filloi të fliste Veloja. — Ç'më rri ashtu si i tharë në tym! — Pastaj tha: — Hajde, dimër, hajde! Po kaloj të dyzetat, po dimër të këtitillë s'kam parë?! Bjer, o t'u shoftë; bjer!

— Pusho, se mos na dëgjojnë, — e qortoi Rustemi.

— Na plasi by. . ., — tha Veloja, — fol, se kemi mbetur si të shurdhër! Fol të shkretën, fol!

— E po mirë atëherë, vdekur se vdekur, — thirri Rustemi me zë të lartë dhe bëri gati një granatë e i futi një ballë fishekë pushkës. — Rrugëdalje tjetër nuk kemi. Këtu do të luftojmë. Tani s'mund të kthehemi mbrapa. Do të luftojmë gjër në fund.

Veloja mbeti në mëdyshje me një vështrim keqardhës sikur të donte të thoshte se kishte merakun e Dinit dhe të Nestit, por heshti. Dhe Rustemi çuditej me qetësinë e Velos dhe i dukej sikur ajo ishte e rreme.

— Mos e ndill kurrë të keqen, or balukegjati i Velos, — foli për të qetësuar shokun.

— E ndjell, s'e ndjell, puna jonë u pa, — ia ktheu Rustemi.

— Nuk është parë jo, — nguli këmbë Veloja e pas pak shtoi: — T'ëmën, kam parë e s'kam parë, po si këta ballistët s'më ka zënë syri. Sa u dhimbset shpirti, or iu shoftë binaja?!

— Pse ty jo?, — e pyeti Rustemi e vuri buzën në gaz.

— Unë e hëngra çairin.

— E hëngre, po prapë të dhimbset.

Veloja s'foli. Syri i zuri një oficer me dy ushtarë që kishin devijuar nga rruga dhe me vështirësi po çanin dëborën. Ai mund t'i shtrinte të tre të vdekur njërin pas tjetrit. . .

— Më dhimbset, më dhimbset, ta marrë djalli ta marrë, — tha papritur Veloja dhe bëri të qeshte. — Të vri-

tesha për dhjamë qeni, do të më vinte keq, po do ta shes shtrenjt lëkurë sot unë!... Pastaj pse mendon se do të vritemi?

— Sikur thashë, po ja, që bie fjala.

— Fjala le të bjerë, se muhabet po bëjmë, veç shpresat jo. Nuk i humbasim apo jo?, — e ndërpreu Veloja. — Ku mund ta dish se ç'sjell sahati, e nesërmja? Kur të më dalë xhani, shkulem që këtej unë. Por, në qoftë se na pikasin, me kujdes fishekët, o pëllumbi i Velos.

Rustemi tundi kokën si i zënë në faj.

Një karvan me kuaj e mushka të ngarkuara me mortaja dhe municion kapërcyen lumin dhe morën të përpjetën e Lushakës. Kafshët çanin borën me vështirësi dhe potkonjtë e tyre rrëshqisnin mbi tokën me copa akulli. Shtëllunga avujsh dilnin nga flegrat e hundës së tyre. Lumi gjëmonte shurdhër. Ishte një karvan i gjatë që përdri dhej si një bisht i stërmadh.

Lushaka ishte fshati i parë përtej lumit. Gjermanët kishin vendosur ta ndëshkonin në mënyrën më të egër e më barbare. Njerëzve plumbin, shtëpive zjarrin kështu kishin deklaruar ata. Këtu ata do të përdornin taktikën e tokës së djegur.

— Dikush nga ne duhet të shpëtojë, — tha Veloja.

— Pse të mos shpëtojmë të dy?!

— Ashtu do të ishte më mirë. Po të paktën njëri duhet të shpëtojë. Posta duhet shpënë medoemos në bazë. Unë do të qëndroj këtu, se kështu duhet. Do të pres Dinin. Po s'erdhi, do të nisem në kërkim të tij. Kurse ti, Rustem, nis, do të hysh në pyll. Udhë më tej të shpie te Varrri i Grekut. Kur ta kálosh, në krah të tij është një rrëpirë veshur me dru lisi, vërtitu poshtë dhe rrokullisu. Durrët janë të dendur dhe, po të rrukullisesh, plumbi nuk do të të zërë. Po e pe veten në rrezik, zhduke letrën. Dëgjo-



ve?... — Por Veloja nuk arriti ta mbaronte fjalën. Përtej lumit u dëgjuan krisma pushke dhe automatiku, pastaj oshëtima e një mitralozi «Breda».

Ishte njësitë territorial i fshatit me dy kompani të batalionit «Tomorri» që s'dihej si kish arritur, aty.

Veloja ktheu kryet në atë drejtim dhe mbajti vesh. Era ulërinte pareshtur, krismat herë i sillte të qarta e të forta, sikur luftohej aty, prapa kurrizit të tyre, herë të largëta e të mbytura, sikur dilnin nga gjiri i shkëmbit. Gjermano-balistët u kthyen mbrapsh dhe morën të tatëpjetën në drjetim të lumit. Veloja me Rustemin s'mbahe-shin nga gëzimi. Tani mund t'i qëllonin.

\* \* \*

...Në lagjen e sipërme të fshatit u ndez lufta. Drita u ngrit nga dysheku dhe mbuloi kokën me duar. Atë natë ajo ishte fill e vetme. I shoqi kishte shkuar në Korçë për pazar. Shtëpia ishte njëkatëshe dhe e ndërtuar me gurë. Ajo ishte e veçuar nga të tjerat dhe në anë të fshatit. Disa krisma sa vinin e bëheshin më të shpeshta. Për çdo kris-më Drita hapte sytë, merrte zemër e lutej. «Ah, sikur të vijnë partizanët!».

Krismat e pushkëve nuk zgjatën shumë. Nata u qetësua dhe pllakosi heshtja, por Dritën nuk e zinte gjumi. «Ç'janë ato pushkë?»!. Pas pak filloi të lehte qeni. Dritës i dukej se ajo ishte një lehje e qetë, pa egërsi. Me zemër të dridhur iu afrua dritares dhe mbajti vesh. Binte dëborë dhe flokët e saj si pupla pate rrëzoheshin vazhdimisht pas xhamave dhe i zinin pamjen. Pastaj diçka u përpoq me një send të metaltë dhe nga ajo përpjekje u dëgjua një tingull i mbytur e i zvarë. Drita hapi përgjysmë një kanat të

dritareve dhe pa si në mjegull dikë që kaloi. Diçka si hi-  
je. Ajo s'e dalloj që ishte njeri, se ecte me zor, se i me-  
rreshin këmbët e linte gjurmë të thella mbi dëborë. «Po  
kjo ç'të jetë?!, — tha Drita kur pa njeriun që u ngrit e  
u mbështet pas qipisë së barit që ishte në anë të përroit  
dhe vështronte në drejtim të shtëpisë. Drita mbylli dri-  
taren pa zhurmë dhe nëpër trup i kaloi një dridhmë. S'vo-  
noi dhe ajo dëgjoi një të trokitur të lehtë në deriçkën e  
avllisë që ishte në anën e prapme të shtëpisë.

Drita u ngrit dhe vuri veshin.

— Hapc, — u dëgjua një zë.

Dritës i rrahu zemra.

Pas pak u dëgjua prapë po ai zë.

— Mos ki frikë. Jam partizan. Jam plagosur. — Zë-  
ri i tij u përzie me flokët e dëborës dhe humbi lart në te-  
rrin e natës.

Dini kishte rënë në brinjë, por pushkën s'e lëshonte  
nga dora. Nga gjoksi i tij doli një rënkim i mbytur, sikur  
t'i shkullnin prej trupit një gjymtyrë. Qeni pushoi së lehuri.  
Ngriti kokën dhe vështroi i çuditur. Ai vuri këmbët për-  
para mbi gjunjët e Dritës dhe ajo ia lëmoi kokën me për-  
këdheli. Drita e përfshiu partizanin me duar dhe e ngriti  
peshë. Me vështirësi e futi në dhomë. Ajo i kapi flokët e  
tij të butë dhe të qullët në dritën e kandilit dhe i shkun-  
di dëborën. Vështroi fytyrën e tij, një fytyrë e çuditshme,  
një fytyrë e dashur, por e zbetë. Grisi me të shpejtë një  
këmishë të saj të bardhë dhe i lidhi plagën. Plumbi e kish-  
te marrë në çapokun e djathtë. Kur po e shtrinte në dy-  
shek, Dinit iu kolovit koka. I vuri faqen e saj mbi buzë  
dhe iu duk sikur ai nuk merrte frymë, I vuri veshin në  
gjoks, ndjeu një përpëlitje të lehtë. «Zemra punon, punon!  
Ai është i gjallë». Dritës iu mbushën sytë me lotë e s'din-



te ç'të bënte. «Jo, ai nuk vdes», — mendoi e tha të dilte e të thërriste një fqinjën e vet, por u pendua. Nëpër rrugë dëgjoheshin lehje qensh dhe britma njerëzish. Pastaj ranë prapë disa pushkë në lagjen e sipërme të fshatit. E mbuloi Dinin me velenxa dhe qëndronte pranë tij kokulur dhe e heshtur. Dini hapi sytë dhe vështroi si në mjegull. Pastaj i mbylli prapë. Dritës iu ngroh zemra.

— Do të shërohesh, vëlla, — i tha Drita dhe me vete përsëriste të njëjtën gjë: «Do të shërohesh, or vëlla!».

I fërkoji ballin dhe e qetësonte me ata sytë e saj të dhembshur.

Ndaj të gdhirë Drita ndjeu një dridhmë e dobësi të papritur. Gusha iu mbyt me djersë. Gjunjët iu prenë, e i nisën dhimbjet e barrës. «Ngaqë u trondita», — mendoi ajo me vete.

Pas pak Dini dha prapë shenja jete. Si çeli sytë dhe pa Dritën që qëndronte pranë tij, hapi buzët e thara dhe foli si nëpër gjumë:

— Jam mirë, jam mirë.

Dritën e shqetësonte vetëm një gjë: «Po sikur të vij në gjermanët e të kontrollojnë shtëpinë?..».

— Të dhemb tani?, — e pyeti Drita më tepër për të larguar mendjen nga gjermanët.

Dini s'foli.

— Duhet të hash diçka që të marrësh fuqi, — i tha ajo duke i zgjatur një filxhan me mjaltë të tretur.

Dini bëri me shenjë se nuk i hahej. Nuk kishte fuqi të gëlltiste.

— Hajde haje, që të marrësh pak fuqi, — i tha Drita prapë.

Ai gëlltiti disa lugë me vështirësi. Pastaj vuri kokën në jastëkun me kashtë dhe vështroi si i përgjumur, ndërsa ajo i rrinte në kokë sikur do ta ruante nga dikush që mund të zgjate krahët e ta rrëmbente.

— Të dhemb shumë, ë?

— Jo, veçse më është mpirë.

— Katilat, — mallëkoi Drita. — Fli! Gjumi të çlodh dhe të shëron.

Dini vuri buzën në gaz dhe Drita kuptoi se ai disi qe lehtësuar.

— Unë duhet të shkoj, — foli Dini pas pak.

— Të ikësh? Je në vete?!, — e qortoi Drita.

— Gjermano-ballistët mund të vijnë pas njollave të gjakut e të bëjnë kontroll... dhe e pësoni edhe ju, — i tha ai.

— Mos ki merak. Të fsheh unë kur të gdihet. Di unë si të të fsheh. Ka rënë dëborë e madhe dhe vazhdon të bjerë. Asnjë gjurmë gjaku nuk duket... Di unë si të të fsheh. Fli, fli, gjumi të çlodh dhe të shëron.

— S'mund të rri, — ia ktheu Dini dhe u përpoq të ngrihej.

— Ç'flet kështu?! Hiqe atë mendje. Plaga të është ftohur dhe e ke më keq. Pastaj si mund të ikësh me këtë këmbë të dërrmuar?

— Më ndihmo sa të futem në përrua, pastaj hiqem zvarë, në të poshtë është. Te mulliri i Jaupit më presin shokët. Ata do të presin sa do të presin dhe do të vijnë të më kërkojnë. Nuk më lë Veloja mua..., — u mundua të flistë më gjatë, po s'mundi, humbi përsëri ndjenjat.

Dritës i kaloi një dridhmë akoma më e fortë. U përpoq që të mblidhte veten, po nuk mundi. Gruaja e mbetur vetëm në shtëpi me barrën e saj në ditët e fundit të lindjes dhe me partizanin e plagosur u gjend ngushtë.

Atë mëngjes krismat e pushkëve i sollën Dritës dhe mbje të forta dhe ajo filloi të dridhej e tëra. E kishin zënë dhembjet e lindjes, e fëmijës së parë që do të lindte. Ku ta fshihte Dinin tani në të zbardhur që ballistët ishin



derdhur në tërë fshatin? Ata si të tërbuar kontrollonin me radhë shtëpitë e fshatarëve dhe vidhnin ç'gjenin, kontrollonin duke u rënë me kondakun e pushkës mureve dhe dysHEMEVE SE MOS GJENIN ndonjë vend të fshehtë mbushur me gjëra të vyera. Ballistët përhapnin lajme se partizanët qenë shpartalluar, vrrarë e dorëzuar, megjithëse as vetë nuk u besoi këtyre lajmeve. Ata bënë gjithfarë dhunash e zullumesh. Kur dëgjoji zërat ballistëve të hynin në oborrin e saj të heshtur, Drita ndjeu një dhembje shumë të fortë, therëse, aq sa s'mundi të duronte. Dhembja e rrëzoi përdhe. Në atë çast ajo ndjeu një lehtësi të çuditshme e përkëdhelëse. Sytë iu hapën e vetëm kur dëgjoji një zë fëmije fare pranë. Uli sytë e pa pjellën e saj, fëmijën që u shkëput dhe ra përtokë. Drita e mbështolli shpejt e shpejt dhe ia vuri Dinit te koka. Fëmija filloi të qante te koka e Dinit, por ai nuk ndjeu asgjë. Ai kishte rënë në një gjumë të thellë.

Porta e jashtme u hap me forcë dhe dy ballistë nga të çetës së Myrto Grenzës, me armë në duar, u futën brenda. Njëri ishte një shtrebanik, me fytyrë gjithë rru-dha si ndonjë gështenjë e tharë, me shpatulla të ngushta, me sytë futur në zgavra, tjetri ishte me fytyrë të gjatë, i parruar prej një jave, hundën si sqep, sytë të skuqur sikur kishte pirë rakinë e tërë krahinës dhe me një të ecur sikur i hiqte këmbët zvarë.

Dritës sikur iu ngul thika në zemër. Iu duk sikur u hap toka ta përpinte.

— Gjak, — tha njëri nga ballistët me zë të vrazhdë dhe ia nguli sytë Dritës.

— Gjak! Gjak!

— Për flamur, gjak!, — ia priti tjetri.

Foshnja tundi duart e vockla dhe klithi me sa fuqi kishte. Dritës iu duk se e gjithë mëhalla dëgjoji britmat e

saj. Ajo u zmpraps disa herë, mbështeti shpinën pas hambarit dhe me ballin e rrudhur, si e tretur në mendime, mudohej të qëndronte.

— Do të jetë plagosur ndonjë nga ata horrat që ranë mbrëmë në pritë dhe ka ikur ose është fshehur këtu, — tha njëri nga ballistët dhe përpoqi këmbët.

Drita mblodhi veten dhe qeshi me zë.

— Ç'më qesh!, — iu s'kërmit ballisti që ishte në krye, duke rrudhur vetullat. — Unë jam Osman Kadëri, në do ta dish. Fol, ç'është ky gjak?! Fol, se për allah t'i numërova të shtatat.

Drita mori zemër dhe foli:

— Po ky s'është gjak plage, zoti Osman. Është gjak tjetër, — dhe uli kokën si me turp.

Ballistët vështruan njëri-tjetrin të çuditur. Pastaj Osmani u përkul, këqyri me kujdes vendin dhe tha:

— Hë, hë, mua do të ma hedhësh ti, bushtër që të skuq ajo fytyrë si mëlçi. Me gjak jam marrë gjithë jetën unë. Ky është gjak njeriu gjak njeriu! Fol!

— Gjak njeriu, — ia ktheu Drita. — Ja, s'ka as një orë që lindi ime kumatë. — Këtu ajo e ngriti zërin fort që, në rast se Dini kishte ardhur në vete, të kuptonte lojën. — Sapo rregullova atë dhe s'pata kohë të pastroja shtëpinë. — «Po sikur të përmendet Dini», — mendoi Drita me vete dhe balli iu mbulua me sumbulla djerse.

Ballistët ia dhanë të qeshurit.

— Qënkemi këmbë mbarë ne. Pse s'thua do të hamë petulla?, — tha njëri nga ata e shtyu shokun e tij me bërryl. — Po çfarë ka lindur?

— Vajzë, vajzë, — tha Drita e ia mori këngës:

*Lumja unë e lumja ti,  
moj ime kumatë,  
lindi vajzë në shtëpi  
të na bëhet urdhëratë.*



— Hajde, lëre këngën, vëre tiganin në zjarr e na bëj petulla, — tha Osmani dhe ia bëri me shenjë ballistit tjetër si për t'i thënë: «Është në vete kjo, apo ka lajthitur».

— Mirë, — tha Drita, — veçse kaloni në dhomën tjetër sa t'i bëj gati, — dhe ia bëri me dorë.

— Ashtu, e?, — u kanos ballisti tjetër dhe u ul në qoshe të oxhakut.

— Pranë lehonës nuk rrinë burrat, — i foli Drita me zë të lartë e qortues. — Ju keni gra vetë, apo jo? Lehona mund të ngrihet, helbete, punë grash, apo jo, zoti Osman? Ju duhet ta kuptoni mirë këtë gjë?

— Ngrehu, hajvan, — i shfryu Osmani shokut të vet. — Ngrehu, se do të hamë petulla. — Pastaj, sikur ta kishte pickuar njeri, i sokolliti Dritës: — Dhe ti ule një çikë atë zërin që ma ke si zë. Më quajnë Osman Kadëri mua. Të fut në dhe të gjallë.

Drita shtrëngoi kokën sikur t'i thoshte se nuk i bëhej vonë nga kanosjet e tij. Balli i ishte mbuluar me djersë të ftohta. Ishte nata më e vështirë e jetës së saj.

Befas, përtej lumit filloi të qëllonte pa pushim një mitraloz i rëndë. Gjatë natës partizanët kishin zënë kodrat përreth dhe po sulmonin ballistët. Atyre s'u kishte shkuar ndër mend kurrë se partizanët në atë qamet do të kishin guxuar të hidheshin përtej lumit. Ballistët u ngritën si të çartallosur dhe ia mbathën nga sytë këmbët, duke lënë të vrarë komandantin e tyre Myrto Grenzën. Partizanët kishin hyrë në fshat. Drita filloi të merrte frymë lirisht dhe mbeti gojëhapur nga gëzimi.

Dini u përmend e çeli sytë. Drita u përkul, zbuloi foshnjën dhe i thirri:

— Fatbardha! Fatbardha!

Me këtë emër ajo e pagëzoi foshnjën e saj të parë.

## KAPITULLI IX

Kaluan disa muaj. Pranvera ia kishte lënë vendin verës. Dielli ishte ngritur lart dhe digjte si saç, vapa sa vinte e më tepër shtohesh. Gjithçka rreth e rrotull kishte rënë në qetësi, asgjë s'pipëtinte. Nuk frynte fare erë, prandaj asnjë fletë nuk lëvizte as te lisat, as të plepat e as te shelgjet buzë lumit.

Ishte e dyta ditë që batalioni ndodhej në fshatin Lushakë, ku partizanët do të pushonin pas një sërë betejash të ashpra me forcat gjermano-balliste. Dini me Nestin ishin pranuar në Parti. Dini ishte caktuar komisar në kompaninë e Velos.

Atë ditë, aty nga ora katër pasdite, Dini kishte shkuar në lagjen «Demollarë», ku do të merrte pjesë në një mbledhje të aktivitetit të rinisë komuniste të fshatit. Meqë kishte punuar më parë me rininë e këtij fshati kur kishte qenë në terren, nuk i ndahej shpirti nga puna me rininë. Sapo ishte duke përfunduar së foluri mbi situatën politike dhe detyrat e rinisë në këtë fazë të re të luftës mbas ofensivës së dytë të armikut, papritmas dëgjoi një zë të thellë.

— Din, Din! — E thërriste Nesti që së largu me një zë të çjerrë. — Hajde, shpejt o Din!



Dini para dy ditëve kishte marrë lajm se kishte nënën shumë sëmurë, ndaj dhe u pre një çast, por shpejt e mblodhi veten dhe me hapa të nxituar u derdh drejt tij.

«E drej, o punë, ç'të ketë ndodhur», — fliste Dini me vete.

— Eh, Din, Din! Kaq e pati dhe Stiliani!, — tha Nesti me një dhembje të dukshme në bebëzat e syve dhe dy pika lotë i rrëshqitën nga sytë.

— Ç'thua, more?, — tha Dini që s'po kuptonte asgjë nga ato fjalë të shkëputura që thoshte ai dhe ngriu në vend si i mpirë me vështrim nga mali.

— E ç'të them, o Din vëllai, — i tha Nesti mbas pak. — Erdhën dy korrierë nga shtabi i qarkut dhe thanë se është vrarë Stiliani. Komisari urdhëroi të mblidhej i gjithë batalioni dhe nuk e di sepse të kërkon me ngut ty, ndaj dhe të thirra.

Dini u trondit shumë nga ky lajm i hidhur, sepse me Stilianin, si Dini dhe Nesti, kishin shpuar gishtërinjtë dhe kishin pirë gjakun e njëri-tjetrit për t'u bërë vëllezër. Dhe këtë e dinte i gjithë batalioni.

— E po, i ka lufta këto, — i tha Dini si për t'i dhënë zemër Nestit dhe vetes së tij.

— Eh, more Stilian, Stilian, që s'do të të shoh më kurrë...

— Për të parë s'do ta shohësh, por atë s'ke për ta harruar kurrë, — e ndërpreu Nesti e u ul përdhe me vështrim nga mali Grano dhe hodhi sytë nga kodrina që priste si thikë atë qiell të kthjellët të asaj pasdite të qetë dhe sytë iu ndalën te lisi i madh që rrinte si statujë, hijerëndë dhe krenar majë asaj kodre. Sa vinte e ai lis ngrihej para syve të tij si një monument i madh prej guri. «Jo, jo, Stiliani s'është vrarë», — i tha një

zë i brendshëm dhe fytyra e tij iu shfaq pranë atij lisi si një shenjë fitoreje dhe lavdie me atë krenarinë e tij partizane dhe me mitralozin që s'e lëshonte kurrë nga dora. Ai u shfaq në sytë e tij të zymtë dhe të dëshpëruar si një kalorës i madh me shpatë në dorë duke u lëkundur sa majtas-djathtas. «Po shkoj pak më përpara», — i kishte thënë Stiliani atë ditë dhe qe sulur si luftëtar i zgjuar, i qetë dhe i sigurtë për të zënë Kodrën e Lisit të Madh. Edhe italianët që kishin sulmuar befasisht batalionin po i ngjiteshin vargut të kodrave përpjetë për të zënë Kodrën e Lisit të Madh. Sipas italianëve, me këtë operacion ata do të asgjësonin batalionin, do të digjinin fshatin që ishte një nga bazat kryesore dhe me këtë do t'i jepnin fund rezistencës së armatosur në atë krahinë. Në krye të këtij operacioni ishte vetë kapiten Barxolla. Mbi kokën e partizanëve fishkëllenin plumba të panumërt. Një kompani e tërë italianësh ishin angazhuar në luftë për të marrë me çdo kusht Kodrën e Lisit të Madh, por një breshëri mitralozi i ktheu mbrapsht. Italianët filluan të sulmonin prapë në një front më të gjerë, por mitralozi në duart e Stilianit ngrinte dhe korrte ç'gjente përpara. Italianët shtriheshin përdhe nëpër gropa dhe hendeqe për t'u mbrojtur nga plumbat që fishkëllenin mbi kokat e tyre. Trualli ishte i fortë dhe i tharë nga dielli dhe Stilianit i digjin duart nga mitralozi. Dielli i zjarrtë rrihte pa mëshirë shpinën e tij të djersitur. Nga italianët mbetën shumë të vrarë. Tre të plagosur u tërhoqën barkazi dhe u futën në një hendeq. Vetëm një italian doli nga e majta e kodrës, u platit mbas një guri të madh dhe qëllonte pareshtur me automatik në drejtim të mitralozit. Pas pak italiani u hodh dhe u fsheh prapa një shkëmbi. Stiliani që e kishte vënë re këtë bëri pak më majtas duke e drej-



tuar tytën e mitralozit në atë drejtim. Me të nxjerrë kokën italianë për t'u hedhur përpara, Stiliani tërhoqi këmbëzën e mitralozit. Italiani u tërhoq prapa, ngriti kokën ashtu siç bën bujku që ngrihet herët në mëngjes e vështron qiellin për të kuptuar se ç'kohë do të bëjë, lëshoi automatikun përdhe dhe ra përmbys mbi barin e thatë.

— E qërova, — tha Stiliani. — Vetëm më vjen inat që s'është pak më afër që t'i marr armën. — Si tha këto fjalë, u mbështet dhe vuri qytën e mitralozit pranë faqes. Pas pak ai pa një italian tjetër që po tërhoqej zvarë në të poshtë. Italiani qëndroi dhe ngriti kokën për të parë kundërshtarin. Stiliani shtiu dhe koka e italianit u duk sikur u këput dhe u përplas nga mbrapa.

— Edhe një tjetër!, — thirri Stiliani.

Minutat kalonin. Italianëve u erdhën forca të reja. Kërcisnin pushkë dhe hidheshin granata. Komisari i batalionit, Pali Duro, që ishte në këtë krah, kishte vënë re se italianët kishin marrë krahët dhe po i dilnin nga sipër Kodrës së Lisi të Madh. Ai, duke kaluar nga një pozicion te tjetri, u shkante me radhë gjithë partizanëve dhe i porosiste se nga ç'krah duhet të kishin më tepër kujdes.

Italianët filluan të sulmonin prapë në një front të gjerë, por këtë radhë nga krahu i djathtë i kodrës. Stiliani rëmbeu mitralozin dhe bëri pak më sipër duke i lënë italianët të afroreshin sa më afër. Gradoi shenjestrën dhe ua lëshoi me breshëri të gjata. Një nga kompanitë e batalionit po kundërsulmonte armikun nga shpina.

Kapiten Barxolla u ngjit barkazi deri në majë të një kodre dhe kaptoi matanë saj. Tani zjarri plasi nga e majta dhe, papritur, edhe përpara. Rreth kapitenit vërshëllenin plumba dhe ai e tërhoqi kokën padashur, po e drejtoi trupin menjëherë. Duhej të ishte shembull gu-

ximi, de! Mendja i punonte me forcë. Mos vallë informatorët e lëvizjës partizane kishin arritur t'u binin në erë pregatitjeve të tyre?! Dukej sikur njerëzit e tyre futeshin kudo, kurse zbulimi i kapiten Barxollës nuk bënte pothuaj asgjë. Nganjëherë kapiten Barxollës i lindte edhe dyshimi se mos agjentët e tij i jepnin informata të gënjeshtërtë.

«Gjithçka po shkon ters!», — mendoi kapiteni.  
Kapitenit iu duk sikur zjarri para tij dhe nga e majta ishte dobësuar. Rreth tij nuk vërshellenin më plumba. «Shyqyr zotit! Domethënë partizanët janë tërhequr!». Por s'kaloi shumë dhe përpara tij, atje tej, u dukën njerëz që po zbrisnin teposhtë në mënyrë të çrregullt dhe po afroreshin. Mos vallë ua kishin mbathur këmbëve ushtarët e tij?!

Kapiteni urdhëroi me ngut një oficer të ndalonte dhe të mbante ushtarët. Vetë ai iu afrua njërit prej tyre:

— Pse po kthehemi prapa?!  
— Përpara s'hedh dot asnjë hap!, — thirri ushtari dhe vazhdoi më tej.

I dëshpëruar kapiteni u mundua të ndalte një tjetër, po e pa se ky s'kishte armë. Edhe oficeri nuk i ndaloi dot ushtarët që po tërhiqeshin në panik. Ata kalonin me nxitim gjatë rrugës duke shtyrë njëri-tjetrin dhe disa prej tyre mbartnin të plagosurit. Të gjithë dukeshin të lemerisur. Kapiten Barxolla ra përdhe, por nuk ishte vrarë. U mundua disa herë të ngrihej, të hiqej zvarë, zgjati duart e thirri diçka që s'u mor vesh. Italianët ua mbathën me të katra duke e lënë atë mbrapa pa kthyer kokën që të shihnin. Ai vuri të dyja duart në bark, sikur do të mbante zorrët që të mos i dilnin jashtë dhe dëshi të hiqej praptazi deri përposh në lumë. Dini filloi të shkrihej në gaz.



— Ç'më qesh, — i tha Stilianin që s'po kuptonte asgjë.

— E si të mos qesh, o Stilian, — ia ktheu ai. — Nuk e shikon se si po ua mbathin këmbëve italianët?!

Pas disa minutash Dini me Stilianin fluturuan si zogj me krahë nëpër atë arë me grurë. Kapiten Barxollës i qe dërrmuar këmba dhe nuk mund të ngrihej dot. Mu përpara tij dergjeshin dy ushtarë të vrarë. Ai, në regëtimet e fundit të jetës që po i derdhej bashkë me gjakun, mudohej të shtrëngonte plagën, po duart nuk i bindehin. Nga hemoragjia ishte bërë dyllë i verdhë. Një dorë e kapi fort për zverku. I tmerruar ai pa para vetes Dini me Stilianin:

— Din Kurti, — iu prezantua ai. — Kurse Stilian Geron e njihni mirë...

Kapiten Barxolla kapsalliti sytë dhe humbi ndjenjat. Mbas disa ditëve atë e nxorën para gjyqit partizan. Anëtarë të trupit gjykues ishte dhe Dini me Stilianin. . .

— Jo, jo, ai s'është vrarë. Ai s'vritet kurrë, — thirri Dini pas pak dhe e shkëputi Nestin nga këto mendime.

Në mbrëmje, sipas urdhrin të komisarit, Dini dhe Nesti u nisën për në fshat për të dhënë lajmin e hidhur të vrasjes së Stilianit. Nuk u bënë këmbët dhe nuk donin të venin atje ku i dërgonte komisarit, por s'mund të thyenin urdhrin e tij. Dhe ja tani ata po shkonin në familjen e tij të tregonin. Pastaj si Dini dhe Nesti s'dinin fare nga këto punë. Nuk dinin nga t'ia fillonin, çfarë të thoshin dhe kjo i shqetsonte akoma më shumë. Rrugës nuk flisnin fare. Atë ditë kishin folur aq shumë me vete, sa asnjëherë tjetër.

Era e mbrëmjes lozte me degët e pemëve. Lisat dhe plepat anës rrugës qëndronin si hije të blerta. Iu afruan fshatit me shumë kujdes dhe u fshehën në disa kaçube në një kodër. Prisinin të errej. Fshati ishte bazë kryesore e Ballit dhe atje kishte kohë që nuk vinin partizanët.

— Si duket e paskan lajmëruar, — i tha Nesti Dinit kur pa disa gra që hynin e dilnin nga shtëpia e Stilianit. — Po kush vallë?

— E keqja ta gjen derën shpejt, o Nesti, — iu përgjigj Dini. — Po ... nuk besoj ta kenë lajmëruar, kushedi se ç'janë ato gra.

— Nuk më pëlqen gjithë ajo lëvizje njerëzish që hynë e dalin nga shtëpia. Me siguri do ta kenë lajmëruar!

— Mundet.

Dhe Dini sikur u çlirua nga një barrë e rëndë.

Dini me Nestin donin që të mos errej dhe kjo rrugë të mos mbaronte kurrë dhe të mos vinte ai çast që të trokisnin në portën e Stilianit e të tregonin të vërtetën e hidhur.

Mbasi u err mirë dhe nëpër fshat nuk lëvizte njeri, me kujdes vazhduan rrugën duke iu afruar shtëpisë. Kap-tuan nga avllia ashtu siç kishin bërë edhe herë të tjera. U futën në oborr dhe u ngjitën shkallëve, përpjetë. Në dhomë, përveç njerëzve të familjes, kishte dhe disa gra që rrinin në heshtje të plotë.

Nëna e Stilianit ishte mësuar të priste partizanët kurdoherë që të vinin, ditën e natën, ndaj dhe kjo vizitë nuk iu duk e papritur. Si Dinit dhe Nestit iu drodh zemra, sikur ngrinë kur i panë gjithë ato gra që rrinin në heshtje të zymta. Ata iu derdhën nënës së Stilianit, Leonorës, e përqaftuan pa i thënë asnjë fjalë. Çfarë t'i thoshin?



— Sa mirë që m'u ndodhët sonte, ju pastë nëna, ju pastë. Erdhët të më tregoni për djalin. Eh, bir i nënës, bir, që s't'u ndodha pranë, — tha e u mbështet pas gjoksit të Dinit.

E motra e Stilianit filloi të qante me zë. Edhe atyre u rrëshqitën lotë nga sytë, por i fshinë shpejt e shpejt që të mos ua shihte njeri. Dikush e thirri Nestin. Ai u ngrit dhe vajti nga dhoma tjetër ku ishin tre burra të moshuar. Ndërsa Dini ndenji aty pranë nënës së Stilianit.

— Mos qaj, — i tha ajo së bijës me vështrim të ngrysur dhe me një ton të prerë.

«Çudi, — tha me vete Dini. — Ajo është nënë, si duron?».

— U lodhët, o bir, — tha ajo kur Dini bëri sikur të mbështetej pas murit. — Bëtë mirë që erdhët, veçse me kujdes, djemtë e nënës. Ballistët kanë dy ditë që kanë ikur nga fshati dhe e kanë mbajtur vrapin në qytet. Nuk e di, sepse u ka hyrë frika në palcë, që i shpëlaftë mortja i shpëlaftë! Sidoqoftë me mend në kokë kur të ikni, se s'dihet, luftë është. Hajde ngrehu, — i tha ajo së bijës, — dhe jepu djemve të hanë një kafshatë bukë.

— Asgjë nuk duam, nënë Leonora, — i tha Dini pa ngritur kryet fare. E ku i vente mendja atij për bukë! «Sa e fortë qenka», — murmuriti me vete.

— Keni bërë rrugë të gjatë dhe jeni lodhur, djemtë e nënës, ndaj të hani diçka që të merrni fuqi. Hajde, ngrehuni, shkoni matanë dhe mos ia prishni nënës, — tha ajo dhe nisi të vështronte me radhë shoqet e mërzi-tura e të menduara, pastaj hodhi sytë nga dritarja dhe vështrroi në hapësirë diku larg në horizont, ku përtej në një kodrinë dukeshin lisat e mëdhenj që rrinin si rojë të kodrës. Të gjithë sa ishin aty vështronin njëri-tjetrin

dhe heshtnin. Leonora i kishte ngulur sytë në një pikë dhe bota i ishte mjegulluar prej kujtimeve jo të largëta e ajo shikonte gjithçka...

...Atë mbrëmje një mjegull e dendur hiqej zvarë mbi tokë. Ajri i lagështuar e kishte ftohur shumë vendin. Fshati i dukej si i përgjumur.

Kishte kaluar mesnata. Po gdhihej 5 dhjetor 1943. Stasi, i shoqi u ngrit dhe ndezi një cigare. Pastaj deshi të ndizte zjarrin, por u pendua. Ishte shpejt akoma. U tulat mbas oxhakut me velenxë krahëve dhe deshi të merrte një sy gjumë. Atij i therrnin kockat. Rrinte zgjuar, dëshmitar i të gjitha gjërave. E vështroi gruan me sytë e futur nën vetullat e dendura dhe tundi kokën. Mendja i fluturonte te djemtë. Stasi u kthye në kurriz, por edhe kështu nuk mund të flinte. Gruaja e ndiente shqetësimin e tij, por nuk bënte zë. Në atë çast iu bë se dikush po shtynte portën. Stasi mbajti vesh. Në fillim ngadalë sikur buronte nga dheu, pastaj më me forcë. Qeni filloi të kuiste te porta pa pushim, pastaj ulërima u shndërrua në një kuje të pafund. Mendja e Stasit ishte krejt e mpirë në atë çast. Leonora, që me sa dukej edhe atë e kishte pushtuar pagjumësia, u ngrit ngadalë, zbuloi zjarrin në vatër, mori një thëngjill, i fryu dhe ndezi kandilin.

Mbas pak një trokëllimë e fortë u dëgjua në portë, pas pak dhe një tjetër.

— Dikush do të jetë?!, — tha Stasi.

— Trokëllimë, trokëllimë!, — i tha ajo. — Po kush është ai që troket në këtë orë?

Po Stasi nuk iu përgjigj. Ashtu siç ishte, në këmishtë e në brekët e gjata, u ngrit, mbathi llastikat e mori tatëpjetë shkallëve. «Mos janë partizanë», — mendoi ai tërë gëzim.

— Kush është?, — pyeti dhe mbajti vesh.



— A do miq, o Stasi Gero, — u dëgjua një zë burri.

— Mirse të vini, — u tha ai që brenda dhe menjëherë hoqi llozin e portës.

Leonora doli me nxitim në oborr.

«Ama, ç'të bukur miq!», — tha Stasi me vete kur i pa. Ishin tre ballistë: Beçe Goli, Seit Ferra dhe një tjetër që ai nuk e njihte. Dy të parët ishin bashkëfshatarë të tij, nga të çetës së Myrto Grenzës.

— Hë, gjarpër, gjarpër, — iu skërmit i panjohuri dhe i dha një të shtyrë për ta nxjerrë jashtë portës.

— Ç'kërkoni nga unë?, — iu kthye plaku atij e u bë gati t'ia përvishte turinjve.

— Hajde, ec, — i foli ballisti i panjohur dhe prapë i dha një të shtyrë.

— Ku të vete, more horr!, — i bërtiti Stasi. Zëri i tij kumboi në terrin e natës. U përpoq të largonte duart e dy ballistëve, të cilët po ia vinin krahët mbropa.

— Hajde nisu dhe lëri fjalët, — i tha Beçe Golja, një burrë tullac me shtat mesatar. — Do ta marrësh vesh ku do të të shpiem.

— Kudo që të më çoni, toka është imja, — iu skërmit Stasi.

E shtynë përpara dhe ai s'pati si të mbrohej.

— E zeza! Ç'qe kjo hata që më gjeti, — thirri Leonora dhe u derdh pas të shoqit.

— Mos ki frikë, — i tha ai së shoqes. — Asgjë s'kanë ç'na bëjnë. Edhe në dhe të më fusin, unë prapë i gjallë jam.

— Si, more, asgjë, — iu përgjigj ajo e tronditur.

— Moj, kështu si të them unë, — i bërtiti, ai, — kthehu në shtëpi. Edhe në botën tjetër të më shpien, unë prapë do të kthehem.

Me të shtyra, pa e ditur ku e shpinin, Stasi çau përpara duke u kthyer shpinën shtëpisë, gruas dhe fëmijëve. Ai ishte një burrë i rëndë, rreth 60-vjeç, me trup mesatar, me flokë të bardhë, i ashpër në pamje, me fytyrë të bëshme si të skalitur. Ai ecte nëpër dëborë me kokën lart dhe vështronte retë që tërhiqeshin nga era dhe bënin tutje në thellësi të tokës. Era e marrë vërshonte nëpër trupin e tij, por ai nuk e ndiente të ftohtët. Mbas njëzet minutash u dhanë te kisha. Ajo ishte në të dalë të fshatit, në një pyll. Atje fshatarët venin ditën e shën Thanasit. Afër kishës ishte një lëndinë e vogël që në behar e mbulonte gjelbërimi. Kur ishte i ri, ai lozte me shokët në atë lëndinë, i binte pyllit vërdallë dhe pastaj shtrihej aty. Mos vallë po në atë lëndinë do të shtrihej për gjithë jetën?! Dhe Stasi Geroja ndjeu një dridhmë në trup.

— Hyr, — i tha Beçja, duke hapur me forcë derën e kishës. — Hyr, qen hyr!

Stasi Geroja shtangu në vend duke i kthyer krahët kishës.

— Hyr, hyr, — i tha prapë Beçja, por këtë radhë me një ton të qetë. — Të sollëm këtu që të falesh, — dhe u zgërdhi tërë qejf.

— Të falem, hë?! E përse të falem?!, — u çudit Stasi Geroja.

— Të falesh për djemtë që të t'i shpëtojë shën Thanasi, të t'i ruajë nga lufta, dimri... Apo nuk e beson fenë ti?!, — dhe Beçja zgërdhiu dhëmbët dhe ia plasi të qeshurit.

— Mor, po lëri këto, — iu çor Stasi Geroja. — Unë nuk të jap llogari ty në e besoj apo nuk e besoj fenë. Po të ishte për të falur, vija vetë këtu.

— Po ne të sollëm këtu që të falem bashkë, — e mo-



ri fjalën Seit Ferra, një zdap i gjatë e i thatë si purteka, — kaurë e turq, — dhe zbardhi dhëmbët.

— Te ne s'ka kaurë e turq!, — ia priti Stasi Geroja. — Ka vetëm shqiptarë. Apo nuk jeni shqiptarë ju?!

— Qenke i zgjuar, or plak, — i tha ballisti i panjohur. Ndërsa Beçja thartoi fytyrën, sikur të kishte pirë uthull.

— Na zgjoi lufta, — iu përgjigj Stasi Geroja. — Vetëm ju ju ka zënë sëmundja e gjumit dhe s'keni për t'u zgjuar kurrë...

— Kyçe, more, gojën, — iu skërmit ballisti i panjohur dhe u mat t'i jepte një shuplakë turinjve. — Ne do t'ju shuajmë të gjithë...

— Një zjarr që digjet brenda nuk shuhet nga era që fryn jashtë, — e ndërpreu Stasi Geroja.

— Brisk ma paske gojën, po do të ta pres atë gjuhën që ma ke si të nëpërkës, — iu hakërrye Beçja e i dha një të shtyrë Stasit me tërë forcën e tij dhe mbylli derën e kishës.

Ishte gdhirë. Minutat kalonin njëra pas tjetrës. Stasi Geroja rrinte brenda në kishë, ku binte erë temjan dhe qirinj të djegur. Minjtë vinin vërdallë pa pikën e frikës. Ai vështronte rreth e përqark, po nuk dallonte asgjë, as qiell, as tokë. Në kishë digjej një kandil me vaj të mirë. Nga drita e zbetë e kandilit ai vështronte konizmat e shenjtorëve që ishin tërë pluhur dhe rrjeta merimangash dhe i dukej sikur ishte në një vend që s'e kishte shkelur kurrë. Nga jashtë vinin zërat e ballistëve që kolliteshin e shkuleshin së qeshuri me njëri-tjetrin. «Pse më mbyllën këtu?! Ç'kërkojnë të bëjnë?!». Pastaj mendja i vajti te djemtë e tij që i kishte partizanë. «Kini

mendjen, — u kishte thënë ai atyre. — T'i zbardhni faqen vetes dhe shtëpisë, fshatit dhe tërë krahinës...». Di-sa zëra e britma njerëzish që vinin si të mbytura e të çjerra e shkëputën Stasi Geron nga filli i mendimeve dhe ai filloi të mbante vesh. Zërat sa vinin e po afroheshin. Pas pak u hap dera dhe brenda u futën me forcë edhe tetë burra të tjerë, bashkëfshatarë të tij, të lidhur me litarë. Kur i pa ata, Stasi Geroja ndjeu një tronditje e hidhërim bashkë. Edhe ata u çuditën kur e panë atë brenda në kishë që qëndronte si një shkëmb me gjoksin e tij të zbuluar e leshtor. Dhe ata që hynë ishin të zhveshur dhe të zbathur ashtu siç i kishin ngritur nga rrobat. «Ah, të poshtrit, si duket duan të na prishin», — mendo-i Stasi Geroja me vete.

Beçja me Seitin rrinin te dera.

— Hajdeni, faluni, ç'më rrinin ashtu si mumje, — tha me të tallur Beçja dhe rregulloi tytën e një mitralozi. — Faluni për të fundit herë që të lani zullumet, — dhe ia dha të qeshurit.

— Ne s'kemi bërë asgjë, — e mori fjalën Stasi Geroja. — Zullume po bëni ju në tërë krahinën dhe tani në këtë vend të shenjtë. As s'është parë dhe as s'është dëgjuar një maskarallëk i tillë.

— Pusho, gjarpër, — e ndërpreu Beçja me të bërtitur dhe ia bëri me shenjë mitralierit. Ai u shtri barkas dhe u bë gati të hapte zjarr, por një dorë e rëndë që u mbështet mbi supin e mitralierit e ndaloi.

Stasi Geroja u hodhi një vështrim me radhë shokëve si për t'u dhënë zemër. Pastaj ia nguli sytë Beçes.

— Hajde, — urdhëroi Beçja, — kthehuni me fytyrë nga ajodhima, — po as njëri, as tjetri nuk iu bind urdhrit të tij. Ata u shtrënguan njëri me tjetrin si një trup i vetëm dhe në kishë mbeti një sy i madh.



— Burrat nuk vriten nga shpina, — bërtiti Stasi Geroja dhe bëri një hap drejt derës duke u dalë shokëve përpara sikur me gjoksin e tij leshtor do t'i mbulonte ata. — Bini, ç'prisni, katila, në qoftë se doni të shtini! Këtu, ja këtu do të lahen të gjitha, — dhe përplasi këmbën.

Por ata nuk po shtinin. Ballistët kërkonin që ata të luteshin, të binin në gjunjë përpara se t'i vrisnin. Por kjo nuk ndodhi dhe ata u tërbuan nga kjo qëndresë.

— Mirë, — tha Seiti. — Atëhere bini në gjunjë, kështu është më mirë për ju. Bini, bini, që trupi juaj të mos dridhet e përpëlitet kur të rrëzohet përtokë, — dhe nxori revolen nga këllëfi.

— Vëllezër, vëllezër, — bërtiti Stasi Geroja, — të vdesim si shqiptarë! Me trimëri dhe krenari.

Dhe të gjithë, sikur t'u jepte njeri komandë, me duar të lidhura, bënë një hap përpara.

— Hajde, ç'prisni, qëlloni katila, — bërtitën ata njëzëri. Ballistët prapë nuk shtinë. Stasi Geroja e kuptoi se ky ishte një dëfrim për ballistët, ndaj pështyu në drejtim të tyre, ktheu shpinën, u përkul dhe thirri:

— Shtjer, Beçe pushti, — dhe i ra prapanikes me dorë, — shtjer këtu që ta kem kujtim në botën tjetër.

Beçja kërcëu nga vendi dhe, duke iu drejtuar mitralierit thirri me zë të lartë:

— Zjarr...

— Borxh pa larë dhe hak pa marrë nuk mbetet kurër, — thirri Stasi Geroja dhe zëri i tij kumboi dhe u tret në hapësirë. Nuk mundi të fliste më gjatë.

Plumbat vërshëllenin dhe përplaseshin në gjokset e tyre, por ata vazhdonin të qëndronin të kapur fort njëri pas tjetrit. Në vargun e të nëntëve krijohesh boshllëku, por trupat bashkoheshin përsëri dhe vorbullat e njerëz-

ve përsëri vërtitej. E kështu derisa ra edhe i fundit. Rrëketë e gjakut më në fund skuqën flokët e të nëntëve. Disave s'u kishte dalë akoma shpirti. Dëgjoheshin rënkitje dhe sharjë. Atëherë Beçja me revole në dorë u dha plumbin e fundit.

Në fshat u dha alarmi. Gratë dhe fëmijët e viktimave u derdhën në drejtim të vendit të masakrës. Mjegulla e mëngjesit mbyllej dhe hapej si një perde e rëndë, ndërsa përpara e anash ajo hapej si të bënte një ndërrim të heshtur. Pas pak çatisi i tërë fshati. Trualli i kishës ishte bërë tërë gjak. Pamja ishte e tmerrshme. Disa rreze dielli që depërtonin nga të çarat e reve e hynin nëpërmjet dritave lëshonin një dritë të artë mbi kufomat e viktimave.

E shoqja e Stasi Geros, që printe e para, hyri në kishë dhe u gjend përpara të shoqit, që ishte disi i veçuar nga të tjerët. Një plumb e kishte marrë në kokë. Ai kishte kafshuar gjuhën e vet tërë inat dhe zemërim. Vetëm flokët e bardhë ndritnin akoma me tërë shkëlqimin e tyre në anën e paprekur të kokës. Ajo qëndronte e qetë, por përbrenda ziente e tëra dhe me sytë e saj që rrotulloheshin pa pushim kërkonte në çast të hākmerrej, por ballistët kishin ikur. Të njëjtin qëndrim mbanin edhe gratë e tjera. Vetëm fëmijët e vegjël nuk përmbaheshin dot dhe kjo i trondiste edhe më tepër.

Leonora vështroi sa vështroi të shoqin, pastaj i hoqi sytë mënjanë. I vinte shumë keq për të. Tmerr! Asnjëherë nuk kishte parë ndonjë krim të tillë. Një kufomë tjetër i kishte sytë hapur, sikur do të shikonte lart në horizont. Disa kishin rënë shoq mbi shoq. Britmat dhe ulërimat e fëmijëve pushuan. Njerëzit qëndronin si të



goditur nga rrufeja. Leonora mbërtheu gishtërinjtë. Fytyra e saj e hequr dhe e zbetë u bë më e ashpër. Ngadalë përkuli trupin dhe shtrëngoi kokën me duar dhe vështroi prapë të shoqin! Mos vallë pamja e tij nuk fliste për asgjë?

Fëmijët e gratë të tmerruara silleshin rreth e rrotull, belbëzonin e duke u përkulur mbi kufomat.

Sheshi i vogël ishte mbuluar me dëborë. Disa burra të moshuar filluan ta qëronin atë për të hapur varret. Toka kishte ngrirë. Dielli lëshonte një dritë të zbetë. Dhe ja, mbas disa orëve çdo gjë ishte gati. Ç'është e vërteta fshatarët nuk deshën t'i varrosnin aty. Ata donin t'i shpinin në fshat dhe t'i varrosnin në varrezat e përbashkëta, atje ku varroseshin të gjithë, por nënë Leonora nguli këmbë dhe ata iu bindën vullnetit të saj. Pse e bëri këtë, vetëm ajo e dinte.

Nga toka ku ishin hapur varret dilte avull. Degët e lisave vareshin gjithë pikëllim.

Aty nga ora dymbëdhjetë fshatarët i nxorën kufomat nga kisha duke i ngritur lart e duke i mbajtur në duar. Nga buzët e tyre që mezi lëviznin dilte një mallëkim i ashpër. Të afërmit dhe të gjithë ata që simpatiznin Lëvizjen Nacionalçlirimtare u dhanë atyre lamtumirën e fundit. Pastaj një nga bashkëfshatarët që ishte vërsnik me Stasi Geron e përqafoi dhe i tha:

— Bëhu e fortë, Leonorë...

— Do të bëhem se s'bën, — iu përgjigj e pikëlluar ajo me kokën lart. — Kam shyqyr plot. — Dhe fytyra e saj e përplotur sikur shndriste nga një dritë e qartë.

Një grua ia mori një vaji me zë të shtruar e të ulët, ashtu siç vajtojnë gratë, dhe Leonora u shkëput nga filli i mendimeve.





## KAPITULLI X

Komisari u ngrit në këmbë duke u lëkundur përgjymësh dhe puliti sytë nga drita e kandilit. I hodhi një vështrim kalimthi zarfit, e hapi edhe qëndroi në mëdyshje.

— Lajmëro komandantin, — i tha një partizani, Pandeli Krekës, dhe pastaj nisi të lexonte letrën që dërgonte krahinori. I krahasoi informatat e reja me ato që kishte nga zbulimi i batalionit. Përputheshin plotësisht.

«... Forcat gjermano-balliste kanë marrë urdhër të venë përsëri në Gorisht... Deri në agim të zihen kodrat dhe të mbahen ato me çdo kusht... Hyrja në fshat dhe mbajtja e tij është një aksion i madh politik... Është i vetmi fshat në tërë krahinën, ku batalioni ka gati një vit që nuk ka shkelur...».

Këto fraza godisnin në kokë si çekan. Gjumi i kishte dalë plotësisht.

\*  
\*  
\*

Komandanti kaloi si në revistë rreshtat gjer në fund dhe pastaj, duke u kthyer në mes, ngriti dorën. Fytyra

e tij ishte e qetë. Partizanët prisnin. Prisin të dëgjonin se ç'do të thoshte ai. Qetësia ishte nderë e plotë e tej e tej. Sikur të mos lëvizte komandanti, dukej sikur rreth e qark nuk kishte gjë të gjallë.

— Ne, — theu heshtjen ai dhe përdroshi mustaqet siç e kishte zakon sa herë që do të fliste, — do t'u japim ballistëve goditjen e fundit në fshatin Gorisht. Me ballistët duhet të lajmë hesapet një herë e mirë. Nga Gorishti s'kemi për t'u shkukur kurrë. Me sa duket ballistët e kanë humbur toruan dhe janë lëshuar si poturet e hallvaxhiut kur u këputet ushkuri. Ndaj para dy ditëve e mbajtën vrapin në qytet. Mirëpo gjermanët me sa duket s'e hëngrën këtë. Pozicioni i fshatit është një nga pikat më nevralgjike për sigurimin e qytetit. Kujdes se mos bini në përpjekje me Dinin dhe Nestin, të cilët ndodhen në fshat.

Vetullat e Velos, gjer atëherë të vrenjtura, morën tjetër pamje. Sytë bojë hiri që i kapsalliste dendur filluan të qeshnin. Dalngadalë nëpër tërë fytyrën u duk një buzëqeshje që as ai nuk e kuptonte se nga vinte. Mos vallë nga sulmi që do të bënin? Ndoshta. . .

Batalioni doli nga fshati i përgjumur dhe mori të tatëpjetën. Kur kaloi lumin, secila kompani u nis në drejtimin e caktuar. Komisar Pali Duroja vendosi të shkonte me kompaninë e Velos, meqë në atë mungonte komisar. Batalioni që komandohej nga Bakir Xhabiri, një ish-furxhi, me fytyrë zeshkane që kishte gjithnjë shprehjen e një njeriu babaxhan e të kredhur në mendime. Majat e mustaqeve të zeza si pendë korbi i vareshin poshtë dhe formonin një si hark të vogël në të dyja cepat e buzëve.



Ishin orët e vona të natës. Dinin dhe Nestin i kishte mundur gjumi. Në tërë fshatin vetëm nënë Leonora ishte zgjuar. Qielli ishte i vrenjtur dhe gati për të rënë shi. Para agimit Dini me Nestin do të largoheshin nga fshati. Vajguri i llambës ishte në të mbaruar. Nënper xhamin e thyer të dritares vinte erë lagështi dhe gjethesh të kalbura. Nënë Leonora bënte ç'bënte e dilte në dritare. Ishte një grua që mendonte për të gjitha dhe përpiquej që t'i kënaqte sa më shumë njerëzit e zemrës së saj. Ja, përtej lumit ishin partizanët! Gjithçka flinte në ato orë të vona të natës! Flinte apo i dukej asaj?! Vetëm një lehtë e një qeni ndihej aty afër. Po edhe e lehtë e tij çjerrese pas pak humbi në qetësinë e thellë, sikur të qe shuar, të qe futur diku thellë. E pastaj asgjë nuk u ndie. «Hë, edhe një çikë! Hë, edhe një çikë! Flini, bijtë e nënës, flini vetëm gjumi ju mban!». Dhe asaj i erdhni keq. E në qetësinë e thellë të pasmesnatës, kur ajo për një çast kishte harruar gjithçka, me duar të kryqëzuara pas gjunjëve, jepte e merrte dhe s'u dilte dot mbanë mendimeve, kur papritmas në fshat dëgjoji lehtë qensh me tërsëllëmë dhe zëra njerëzish. Në fillim u turbullua aq shumë, sa filloi të dridhej, por u ngrit shpejt, hapi një kanat të dritares dhe filloi të mbante vesh. «Ç'të jenë këto britma dhe lëvizje nënper fshat?! Me siguri ballistët, s'ka kush të jetë tjetër! Mos i ka parë njeri Dinin e Nestin kur erdhën në fshat e i kanë kallëzuar?!» E tmerroi ky mendim. Pastaj, duke çmpirë këmbët e duart doli në oborr. Përjashta u dëgjuan këmbë njerëzish. Nënë Leonora qëndroi një kohë të gjatë me duar të lidhura. E lehtë e qenëve vinte herë pas here nga i njëjti drejtim. U ngjit lart dhe qëndroi mbi parrmak të dritares dhe nuk i hiqte sytë nga një pikë, megjithëse nuk dallonte asgjë në errësirë. Mendja e saj e lodhur rrëshqiti ngadalë

mbi tërë fshatin, pastaj u përqëndrua te të dy partizanët që ende flinin. Pasi u afrua në majë të gishtave, i mbuloi me një rrobe duke vështruar në fytyrë herë njërin dhe herë tjetrin.

Erdhi nja dy herë rrotull nëpër dhomë pa ditur se çfarë të bënte. Pastaj vajti prapë te dritarja dhe filloi të mbante vesh përsëri. Gjithçka përpara syve të saj i errësua. Dhoma i dukej si një djep që lëkundej majtas e djathtas. Ajo mbylli sytë, qëndroi pak ashtu dhe e mblodhi veten. Rruga gjer te dritarja iu duk tepër e gjatë. Mbërtheu të dyja duart pas hekurave, mbështeti edhe gjoksin përmbi parvaz dhe lëshoi gjithë peshën e trupit. Zhurmat e britmat sa vinin e bëheshin më të qarta. Sytë e saj të lodhur përfshinin për të qindën herë pamjen e tërë fshatit.

« — Do t'i zgoj. S'dihet se ç'mund të ndodhë? Do të rrezikohen djemtë e nënës!», — tha me vete, megjithëse i vinte keq t'ua prishte gjumin. Kishte rënë në një hall të madh. Kur ajo ishte duke menduar se çfarë të bënte, disa krisma pushke u dëgjuan në lagjen e poshtme të fshatit. Pastaj, m'u poshtë shtëpisë së saj, anës një lëmi, lëvizën nëpër errësirë katër njerëz! U dëgjuan ca zëra shumë afër. Një nga zërat iu duk i njohur.

« — Beçe Goli?!, — tha ajo me vete dhe u rrëqeth. «Po çdo hall e ka ilaçin e tij», — i kishte thënë njëherë i shoqi. Dhe ato fjalë iu kujtuan atë çast asaj. Pastaj se mos ishte provë e parë për të. Ajo qe mësuar tani me të papriturat, se ishte rrahur me punëra të tilla të luftës.

Ajo grua e zgjuar dhe e shkathët e harroi fare hidhërimin e saj dhe nisi të shqetësohej më tepër për Dinin dhe Nestin sesa për shtëpinë dhe fëmijët e saj. Për shkak të tyre armiqtë do t'i vinin zjarrin shtëpisë dhe do t'i vrisnin të gjithë. Si mjaftonin asaj së gjore lotët dhe malli



për burrin dhe djalin e saj? Dhe ja tani një hall dhe merak më të madh për të dy partizanët që ende po flinin. S'kishte kohë për t'u lëkundur në mendime. Tani jo vetëm minutat, por edhe sekondat kishin rëndësi. Këndesat e fshatit filluan t'ia thoshin këngës së tyre. Dol në oborr dhe i ra shtëpisë nga ana e pasme, duke menduar se nga t'i nxirrte ose ku t'i fshehte. Ç'nuk mendoj e ç'nuk thuri ajo, por të gjitha i kundërshtoi. U ngjit sipër në dhomë ku flinte vajza dhe dy djemtë e tjerë të saj dhe iu afrua dritares, kur ç'të shihte, në qoshen e krahut të djathtë të avllisë që ishte karshi shtëpisë së saj dy ballistë (njëri me qeleshe të bardhë në kokë) rrinin të mbështetur pas saj dhe diç po i thoshin njëri-tjetrit.

«Po sikur t'i fsheh në qilar? Jo, jo, — kundërshton-te vetveten, — dhe aty s'është mirë». Zemra i rrihte me forcë sikur do t'i kërcente jashtë. Ballisti me qeleshe të bardhë në kokë nxori nga xhepi një kuti të madhe dhe filloi të dridhte një cigare. Ai e piu cigaren deri në fund ashtu siç ishte mbështetur pas murit duke vështruar shpeshherë lart qiellin e vrenjtur. Njëpër të çarat e reve yjet vraponin si të hutuara.

Dinin me Nestin që sapo u zgjuan ishin ende të përgjumur e nuk po kuptonin ç'ishin ato krisma. Ç'po ndodhte në fshat?! Asnjëherë nuk kishin qenë në një pozitë kaq të vështirë. Kthyen kokën nga nënë Leonora, por në fytyrën e saj nuk dalluan asgjë të jashtëzakonshme. U buzëqeshi si me pahir.

— Ndonjë ngatërresë midis tyre ose kanë rënë në përpjekje me shokët ilegalë të terrenit, — tha Dini.

— Sido që të jetë, ne duhet të ikim, — u përgjigj Nesti dhe pa e bërë të gjatë u ndanë me nënë Leonorën, e cila s'donte t'i linte.

U bënë gati të dilnin nga shtëpia, të kapërcenin pragun e portës së jashtme, të dilnin në rrugë e të merrnin tatë-pjetë, buzë përroit, ashtu siç kishin bërë planin, kur u qëllua nga një skuadër balliste. Ishte për t'u habitur se si kishin shpëtuar nga gjithë ajo breshëri plumbash që cifluan muret e avllisë e sofatet e portës. Pastaj u dëgjuan britma dhe të thirrura. Fytyrat e tyre shkëlqenin nga gazi, se kishin shpëtuar për qime nga rreziku. U dëgjuan përsëri britma dhe të shtëna. Dy ballistë tentuan të hynin në oborr, por u qëlluan nga Dini e Nesti e njëri prej tyre u shtri sa gjatë-gjerë në pragun e portës duke nxjerrë një rënkim të fortë. Për një çast u pre zjarri. As njëra, as tjetra palë nuk shtiu. Vajza dhe dy djemtë e tjerë, nga të cilët më i madhi nuk i kishte më tepër se dy-mbëdhjetë vjet, ishin mbledhur të tre bashkë në një qoshë të dhomës. Nga një e çarë e reve nxori kokën hëna e drita e saj depërtoi nga xhami i dritares, ndriçoi fytyrën e saj që sapo kishte fshirë lotët e që dukej sikur po qante akoma. Sytë e saj pak të lagur dukeshin si liqene të vogla të shkëlqyera, ku thyheshin rrezet e dritës. Egërsira për hakmarrje që vizatohej në fytyrën e saj, e shkriu atmosferën e frikës edhe te fëmijët. Ajo vrapoi anës murit, iu afrua ballistit që ende s'i kishte dalë shpirti, e kapi për këmbësh, e tërhoqi brenda portës, i mori pushkën dhe gjerdanin e fishekëve dhe nxori një psherëtimë të thellë që tregonte se disi qe lehtësuar në shpirt. Dini me Nestin u gjallëruan papritur dhe vala e gëzimit u rrëshqiti në tërë trupin. Ajo e mori pushkën dhe e vështroi sikur të mos kishte parë kurrë pushkë me sy. Pastaj e hodhi në sup e fytyra i mori një shprehje të ashpër. Kujtoi pushkën e të



shoqit, një maliher grek, edhe ai kështu e kishte rrëmbyer, në përleshje me andartët më 1913. Me atë pushkë luftonte i biri, ai më i madhi. Atë pushkë kushedi sa herë e kishte fshirë e vajosur, bile edhe kishte shtënë me të. Në fillim as ilegalëve që e kishin bërë strehë të tyre shtëpinë e saj e që i kërkonin armët me qiri nuk ua kishte treguar, sepse e mbante fshehur si gjënë më të shtrenjtë. Një ditë e kishte nxjerrë për ta fshirë e për ta lyer me vaj. Por, me ta zbërthyer, në oborr ishin futur ca karabinierë. Ajo e kishte kuptuar menjëherë pse po i vinin ata miq të pafuar, prandaj mezi arriti të hidhej nga dritarja e së andejmi te një fqinjë e saj e së fundi te plevica ku e fshehu. Karabinierët, pasi kishin bërë kontrollin e nuk kishin gjetur gjë, ishin larguar. Pushka e rrëmbyer ishte me gjak dhe asaj i erdhi të pështirë. «Gjak tradhtari, gjak ballisti, gjak i keq», — tha ajo me vete. Njëra anë e kondakut të drunjtë të pushkës vinte si në ngjyrën e kafes së errët e ajo ngjyrë sikur i pëlqeu. Hoqi siguresën e provoi tytën, ia nxori fishekët, ia vuri përsëri dhe e mbylli përsëri siguresën. Edhe pushka sikur ishte gëzuar që kishte rënë në duart e saj. Atë çast një valë e ngrohtë kënaqësie i pushtoi gjithë trupin. Ajo mezi u përmbajt nga gëzimi, sa për pak desh thirri. Vështroi rreth e rrotull nga t'i nxirrte. Le t'i ndiqnin tani! Në atë çast i dukej sikur edhe një ushtri e tërë të vihej pas, nuk do t'i kapnin dot. «Do të më shohin tani», — tha ajo me vete, duke lëmuar pushkën me dorë. Atë çast iu kujtua një shoqe e saj, Paroja, e cila në përleshje me andartët grekë kishte treguar trimëri të rrallë. E vështroi pushkën përsëri. Ajo i dukej ndryshe, jo si të tjerat. E kishte marrë me gjak e me gjak do ta përdorte derisa të kishte frymë. «Tani le të më dalin përpara ballistët e gjermanët, po ua tregoj unë sa para u bën lëkura». Me atë pushkë do të

merрте hakun e të shoqit dhe të të birit. Me kokën që i ziente nga shqetësimet, thirrjet dhe çirrjet e armiqve, ajo çuditej me vete për guximin dhe gjakftohtësinë e Dinit dhe të Nestit, por edhe ata çuditeshin me atë.

Dini me Nestin po mendonin se si të dilnin nga shtëpia e të çanin rrethimin sa pa u gdhirë, përndryshe nuk kishte asnjë shpresë shpëtimi.

— Hajde, nënë Leonorë!, — i tha Dini me një ton urdhërues. — Pregatiti fëmijët dhe të largohemi nga fshati sa pa u gdhirë. — Nesti i tha që ai të qëllonte me intervale nga brenda në pozicione të ndryshme për të krijuar përshtypjen se ata ende ndodheshin brenda të rrethuar, derisa Dini me familjen e Stilianit të dilte nga deriça që ishte mbrapa shtëpisë dhe të merrnin buzë përroit për të dalë nga rrethimi. Si vend takimi Dini caktoi gropën e plepave. Aty ishte një çesmë me dy sylina, të cilat koha e lagështia i kishte nxirë dhe brejtur. Së andejmi rridhte ujë mali i ftohtë që kalonte nëpër gurë të mëdhenj të veshur me myshk. Kushedi sa herë e kishin vënë ata buzën në ato sylina e kishin pirë ujë.

— Jo, jo, — kundërshtoi nënë Leonora, — Unë nuk luaj nga shtëpia. — Tani që kam pushkë, di unë se si flas me ta. Po të paktën të shpëtoni ju, ju pastë nëna! Keni mundësi të kaloni këtej nga mbrapa, — dhe ua bëri me dorë.

— Je në vete!, — e ndërpreu Dini. — Tani që vramë këtë, ne s'mund të largohemi pa ty, pa këta, — dhe ia bëri me dorë për të tre fëmijët që ishin strukur pas murit si zogjtë e kllloçkës. — Ata do t'ju vrasin, kurse kështu kemi mundësi të shpëtojmë. Po hajde, mos na vono.

— Eh, nënë mos qofsh kurrë, — tha ajo pas pak, e vendosur të bënte çdo gjë, mjaft që në duart e gjermanëve e të ballistëve të mos binte. «Durim! Durim!», —



i dha kurajë vetes dhe u foli fëmijëve. — Ngrehuni. Mos kini frikë dhe mos m'u ndani mua sido që të bëhet dhe çfarëdo që të ndodhë, — e bëri përpara andej nga kishin vendosur të çanin rrethimin. Ajo i njihte të gjitha vrimat e oborrit e të kopshtit si në pëllëmbë të dorës. Nesti qëllonte në të rrallë nga pozicione të ndryshme, nga dritaret dhe brenda mureve të avllisë. Dhe ballistët qëllonin në të rrallë pa ditur ende mbi kë dhe ku shtinin.

Mirëpo ishte vonë. Ballistët kishin zënë të gjitha shtigjet. Ata tentuan dy-tri herë, por ishte e pamundur të dilje nga shtëpia me të tre fëmijët. Ballistët nuk pyesnin për të vegjël e të mëdhenj. Ata do të shtinin mbi këdo që do të diktonin. Atëherë vendosën që të çante në fillim rrethimin vetëm Dini. Ai do të hidhte që nga brenda një granatë në rrugë, pastaj do të hapte deriçkën dhe do të flakte edhe një granatë tjetër e, sa të mblidhnin veten ballistët, do të dilte mbrapa një plevice që ishte në të dalë të shtëpive të tjera e të qëllonte me armë duke hedhur edhe një granatë tjetër, kështu do të tërhiqte pas pas tij ballistët dhe do t'i jepte mundësi Nestit me gjithë familje të dilte nga shtëpia. Ata rrahën disa variante duke u kthyer disa herë sa te njëri te tjetri dhe duke shkoqitur mbarë e prapë të mirat dhe të këqijat që kishte çdo variant. Mirëpo as njërin e as tjetrin variant nuk vunë dot në zbatim. Ballistët filluan të qëllonin nga të katër anët e shtëpisë duke bërë thirrje për dorëzim. Ata tentuan dy herë me radhë të hidheshin si macet nga avllia në oborr, nga porta e jashtme, po nga zjarri i Nestit mbetën dhe dy të tjerë të vrarë. Ballistët zunë të gjitha vendet e përshtatshme duke e mbajtur shtëpinë të rrethuar, që edhe miza të mos dilte dot. Ballisti, një burrë me trup të madh, veshur me poture shajaku, bëri në fillim disa hapa të shpejtë, pastaj u shtri përtokë, siç kishte

mësuar kur kishte qenë ushtar në regjimin e mbretit Zog, zuri shpejt një vend të mirë, duke marrë nishan me pushkën e tij, por s'arriti dot të hiqte këmbëzën e pushkës. Nënë Leonora që kishte zënë një nga dritaret e qëlloi më parë. Dini mendoi se plumbi i parë kishte qëlluar rastësisht. Leonora që e vuri re habinë e Dinit qeshi dhe tha:

— Lufta të mëson vetë.

Në lagjen e poshtme të fshatit u dëgjuan përsëri të shtëna pushkësh e automatikësh. Pastaj pushkët e çrregullta u kthyen në një luftim të vërtetë. Britma e komanda jepeshin me zë të lartë e të çjerrë. Një grua doli nga një rrugicë duke vrapuar me çipat e fustanit në duar, u doli prapa dhe u ndal pas murit të një oborri. Mezi merrte frymë. Befas u thirri me zë të çjerrë:

— Na, more, ku shkoni?... Atje në breg sipër shkollës janë gjermanët...

Në atë çast nga rrugica dolën katër ballistë me pushkët në duar. Velo Gora thirri dhe i qëlloi kaq afër, sa pothuaj u vuri tytën e automatikut në gjoks dhe rrëzoi dy. Njëri nga të katër ballistët ua mbathi këmbëve, kurse i treti u mat të qëllonte, por s'arriti dot, Veloja i lëshoi një breshëri.

— Hajde të kalojmë buzë përroit, — i tha një partizani që e ndiqte pas.

Pas atyre fjalëve s'pati kohë të përgjigjej, sepse papritur, që nga lugina dhe kodra e shën Thanasit u ngrit një zhurmë e një potere, krisma të shpejta e të ftohta, sikur të shtinte një bateri kundërajrore.



Veloja shpëtoi për qime nga vdekja. Mbi kokë të Velos vërshëlyen plumbat e një mitralozi. Pastaj shpërtheu një granatë. Kush ishte ai i krisur që shtinte me mitraloz, kur, në vend të ballistëve, mund të vriste shokët e batalionit?! Por pas pak zjarri i mitralozit u ndërpre sikur t'i ishte marrë goja. «Ç'bëhet, or, ç'bëhet», — tha Veloja dhe u ngjit përpjetë. Ai ndiqte me vëmendje komandant Bakirin që ngjitej kodrave të shihte kompanitë duke zbatuar rregullat dhe taktikën e luftës. Komandanti pa disa gjermanë të shtrirë në një ledh që iu dukën si ca plaçka të hedhura andej e këndej.

— Mos luani nga vendi pa urdhër dhe qëlloni, — i tha një skuadre të kompanisë së parë. «Po Dini me Nestin ç'janë bërë vallë?». Vetëm kjo pyetje e hutonte komandant Bakirin. Në dritaren e një shtëpie u duk një leckë e bardhë. Pastaj prej andej filluan të dilnin disa ballistë që ishin mbyllur brenda. Partizanët u derdhën drejt shtëpisë.

— Mos luani nga vendi, — bërtiti komandant Bakiri. — Le të vijnë vetë këtu. Ku dihet, mund të jetë dredhi e tyre. Pastaj shtëpia filloi të tymoste si një kazan i kthyer përmbys.

Krismat e pushkëve të veçanta të gjermanëve pushuan dhe filluan të gjuajnë mitralozat. Nën mbrojtjen e zjarrit të tyre gjermanët bënë përpara disa dhjetëra hapa, pastaj ranë përsëri barkas. Atëherë mitralozat pushuan dhe pushkët gjëmuan më fort e kështu, pak nga pak, me një këmbëngulje që dëshmonte për një disiplinë të fortë dhe për një stërvitje të mirë, gjermanët po afroheshin tek ata.

— Eh, janë të fortë djajtë, — murmuriti Veloja. — Po vijnë tamam në formë dare.

— Velo, — i thirri komisari i batalionit që ishte

mbështetur pas një shkëmbi disa hapa larg tij, — shiko nga ana e kodrës, buzë ledhit, diç po lëviz.

— Ku, pra?! — Dhe sytë e tij ndiqnin si të mpirë lëvizjet e gjermanëve. Kokën e kishte plot përfytyrime të guximshme, plot kujtime që i kishte lënë jeta.

— Ja, andej, nga e djabathta, mu prapa kishës. Ja!, — thirri kur pa të shkëlqente buzë pyllit diçka që i ngjante një rrezeje dielli të reflektuar nga një pasqyrë.

Një zhurmë e çuditshme pushtoi ajrin. Pas zhurmës u dëgjua një gjëzim. Ajri jehoi si një kambanë e çarë, e diçka u përplas rëndë pas tyre. Në fillim iu duk sikur shpërtheu një vetëtimë nga një shakull tymi dhe pluhur të zi. Ajri u drodh e u përplas pas kurrizit si një valë uji i vakët.

Një gjyle tjetër plasi në gropë. Gjermanët qëllonin me mortaja.

— Eja të zbresim, — tha komisari duke kthyer nga Veloja fytyrën e tij bojë hiri e të shqetësuar.

— Qenkan me të vërtetë ustallarë, o vëllaço, — tha Veloja.

— Përpara, — thirri komisari.

Guximi i tij e ngriti batalionin në këmbë. Komisari ishte i qetë dhe e dinte se ç'duhej të bënte ai dhe njerëzit që ishin nën komandën e tij.

Pylli me drurë të rrallë, i prerë përgjysmë, tani u dukej i dendur e i egër. Qielli i mbushur me re u rrinte përsipër si një tavan i zi. Ishte një zagushi që të zinte frymën dhe atyre u dukej sikur çanin përpara nëpër një korridor dredharak. Përfund pyllit shushurinte pa pshuar një burim me ujë të kulluar.



Ata të dy kishin më se një orë që luftonin në rrethim pa i humbur shpresat e shpëtimit. Krismat sa vinin e po shtoheshin. Më në fund u sqarua dhe shkaku i gjithë atij alarmi që kishte ngritur tërë krahinën në këmbë. Gjermanët dhe ballistët atë natë kishin vendosur të hynin përsëri dhe të mos lëviznin më nga fshati. Sipas planit të gjermanëve, një togë ushtarësh e përforcuar me mitraloza të rëndë do të qëndronte në kodrat mbi fshat me qëllim që të siguronin më mirë qytetin nga ndonjë sulm i mundshëm i partizanëve. Ata kishin dërguar dhe një skuadër xhenierësh për kryerjen e disa punimeve mbrojtëse. Mbajtja e këtyre kodrave në duart e tyre ishte vendimtare. Këtu e kishin burimin gjithë ato lëvizje të armikut atë natë. Mirëpo tani ishte vonë, iniciativa kishte kaluar në duart e batalionit. Ata do të mbylleshin në qytet. Në një pushim të vogël kur s'po dëgjoheshin me të shtëna pushkësh e britmat e gjermanëve e të ballistëve rreth shtëpisë, nënë Leonora nxori kryet në dritare dhe pa kodrat, e tutje, poshtë, qytetin. Sytë e nënë Leonorës, të gjallë e pak të mëdhenj, vezullonin. Ajo ishte radhitur përkrah partizanëve e po luftonte me pushkë në dorë.

Ballistët nuk dëgjonin më urdhërin e komandantit të tyre, Beçe Golit. Silleshin të hutuar nëpër fshat dhe shumë prej tyre ishin dehur. Leonorës veçanërisht i bëri përshtypje të madhe një ballist me ca flokë të lëshuar si të një prifti e me fytyrë të hequr, që ishte futur në një gropë dhe qëllonte si i tërbuar duke mos i shpëtuar nga sytë asgjë. Leonora, që kishte ardhur nga mbrapa tij, i vuri grykën e pushkës në shpinë dhe i shfryu:

— Ngrehu, qelbash, mjaft qëllove!

Ballisti ktheu kokën dhe me fytyrën dyllë të verdhë e me ca njolla të errëta, si një kalli drithi i kalbur në udhë, bëri sikur të mblidhte veten, po, kur pa dhe Nestin me dy partizanë të tjerë që vinte drejt tij, u pre i tëri. Leonora i dha një të shtyrë, e pështyu dhe pëshpëriti me vete sikur t'i thoshte dikujt: «Me armë u shpëtoka jeta, me armë u fitoka liria, me armë e ndjeka veten njeriu të fortë, shqipe me krahë...».

Dielli vjeshtak kishte kohë që ishte ngritur sipër ma-  
lit. Po vinte komisari me komandantin. Ata u ndalën pa-  
ra grumbullit të njerëzve. Aty zienin britmat dhe kën-  
gët për fitoren. Gjermanët dhe ballistët, si të çartallo-  
sur, kishin marrë të tatëpjetën duke u futur kanaleve dhe  
hendeqeve për në drejtim të qytetit. Komisari dhe ko-  
mandanti të shoqëruar nga Dini dhe Veloja u ngjitën  
shkallëve dhe hipën në ballkonin e shkollës. Komisari  
diç i tha komandantit e ai tundi kokën. Pastaj përshën-  
dëti popullin e partizanët që ishin përpara.

— Vdekje fashizmit!  
— Liri popullit!, — ia kthyen atij njëzëri.

Gjithë fshati ishte mbledhur te shkolla.  
Komisari u foli fshatarëve për luftën e popullit kund-  
ër hordhive naziste dhe bashibozukëve të Ballit Ko-  
mbëtar. Ai u tregoi se Ushtria Nacionalçlirimtare ishte  
hedhur në një ofensivë të përgjithshme dhe se së shpejti  
do të çlironte gjithë vendin. Ai u foli për luftën dhe për  
fitoret e Ushtrisë së Kuqe të udhëhequr nga Stalini.

— Armiku është vërtet i fortë, vazhdoi të fliste ko-  
misari — por edhe ne forcohemi përditë e më shumë.



Te ne vijnë gjithë ata që mbi gjithçka tjetër vënë popullin. Ja, sot, midis nesh, me pushkë në krah, është edhe nëna e Stilianit, e shokut tonë të paharruar. — Të gjithë kthyen kokën andej nga ishte nëna e shoqëruar nga Nesti dhe dy partizanë të tjerë.

Një plak i parruar i mbështetur me të dyja duart mbi një shkop, ishte përqëndruar i habitur. Në të djathtë të tij rrinte një grua e gjatë dhe e re, me trup të drejtë si qiriri. Ajo i përshëndeti me kokë partizanët dhe u buzëqeshi të tjerëve.

Leonora kishte ngjeshur gjerdanin e fishekëve dhe pushkën e kishte hedhur në sup. Ajo qëndronte kryelartë në mes të atij grumbulli njerëzish dhe dukej si një partizane e vërtetë. Në fytyrën e saj nuk lëvizte asnjë muskul, vetëm kur komisari përmendi emrin e Stilianit, pika lotë i rrëshqitën nga sytë. «Eh, o Stilian, nuk të kam më, o Stilian», — psherëtiu e mbylli sytë. Befas iu duk sikur e pa Stilianin në një largësi të papërcaktuar tek qeshte si gjithmonë duke tundur atë kokë me ata sy që i shkrepnin si xixa. Atij iu duk sikur një rrymë e fuqishme i mbushi me vrull gjithë gjoksin dhe kërkonte të derdhej përjashta. U shkëput nga ky mendim dhe filloi të mendonte për fjalën që sapo kishte thënë komisar, për ndihmën e saj që u kishte dhënë partizanëve në atë betejë. E cila ishte ndihma e saj? Kishte gjuajtur disa herë, i kishte rrëmbyer pushkën e municionin ballistit të vrarë dhe kishte zënë rob një tjetër. «Kaq mund të bënte cilido që mund të ndodhej në vendin tim», — mendonte ajo.

Komandahti, komisari dhe Veloja zbritën nga ballkoni, iu afruan Leonorës dhe i shtrënguan dorën. Komisar i përqafoi fort në krahët e tij të fuqishëm, sikur ta kishte nënën e vet. Të gjithë partizanët u prekën e zunë

të hapnin e të mbyllnin sytë sikur përpiqeshin të mbytnin ndjenjat që po i mallëngjenin. Kurse komandant Bakiri përdridhte mustaqet i kredhur në mendime.

Leonorës iu duk çasti më i bukur i jetës së saj. Asnjëherë ajo nuk qe prekur aq thellë. Asaj i dukej se dhe dielli ndriçonte më shumë, edhe mali Grano ishte më i afërt. Pastaj mendimet e çuan larg, në ato ditët e ndritura të së ardhmes. Përfytyronte si do të çlirohej qyteti, gjithë vendi, si do të takohej me djalin e madh që kishte partizan në Brigadën IV, si do të vente në qytet bashkë me shoqet e saj.



ten me shume se tre vete bashke qe cernin ne punen e ty-  
re, patrulla e tritkuar therriste:

— Shprehndahuni!  
Patrulla duket si ai qe kandon ne c'cesare per ty dhe-  
ne xemer vetes. Ushtrist e ardhur tshitas ishin te tij  
n'xetevjecare dhe meq'th'ese e dinin se prapa tyre ishin  
nenoficer me ekspetence, e kishin humbur toruan. Ush-  
tra gjermane ishte me ajo qe kishite qene me pare. Ba-  
tistet vazhdonin te h'p'nin r'p'oxalje dhe g'j'lh'are xullu-  
mesh. Gj'nd'ia sa v'niq' **KAPITULLI XXI** dhe me e ko-  
klav'it.

O q'nd'ullonin v'ra se gjermanet do te t'p'p'ishin  
me q'rti dhe se kjo ishte g'eshite dit' e jav'et. Thu-

Kaluan edhe tre javë. Qyteti rrinte në pritje. Tetori ishte në të dalë. Zërat e mëparshëm rreth luftërave që zhvilloheshin në periferi të qytetit, nëpër rrugët e komunikacionit u përqëndruan në një pikë të vetme. Gjermanët mendonin se një valë e re sulmi do të derdhej mbi ta, por s'ishte në dorën e tyre të zgjidhnin kohën e ndeshjes. Një javë më parë në qytet kishin ardhur përforcime. Ajo ishte ushtria e një garnizoni të rraskapitur nga lufta e shërbimi dhe ndodhej në gjendjen më të vështirë që kishte provuar ndonjëherë. Oficerë të hutuar silleshin poshtë e lart dhe, me fytyra ngjyrë dheu. Mendja e tyre digjej prej një dëshire të mjegullt se një mrekulli e qiellit mund të ndryshonte gjendjen dhe të sillte mbarësinë. Hutimi po kthehej në një depresion të thellë. Sytë e ushtarëve nuk mund të fshihnin lodhjen dhe shqetësimin. Ata kishin marrë pamjen e një njeriu të mbyllur në kafaz që po plakej dhe po jepte shpirt. U bënë arrestime dhe u pushkatuan edhe tre vetë të tjerë. Tani për çdo objekt ushtarak, si dhe nëpër rrugët kryesore të qytetit mund të shihje një nënoficer me tre ushtarë që ruanin dhe patrullonin ditë e natë. Dhe kur ata shihnin di-

tën më shumë se tre vetë bashkë që ecnin në punën e tyre, patrulla e friksuar thërriste:

— Shpërndahuni!

Patrulla dukej si ai që këndon në errësirë për t'i dhënë zemër vetes. Ushtarët e ardhur rishtas ishin të rinj njëzetvjeçarë dhe, megjithëse e dinin se prapa tyre ishin nënoficerë me eksperiencë, e kishin humbur toruan. Ushtria gjermane s'ishte më ajo që kishte qenë më parë. Ballistët vazhdonin të bënin raprezalje dhe gjithfarë zullumesh. Gjendja sa vinte e bëhej më kaotike dhe më e komplikatur.

Qarkullonin zëra se gjermanët do të tërhiqeshin nga qyteti dhe se kjo ishte çështje ditësh e javësh. Thuhej gjithashtu se, po të sulmoheshin nga partizanët, ata jo vetëm që nuk do ta lëshonin qytetin, por do të bënin rrënimë e shkatërrime të atilla që të mos mbinte bar as për njëqind vjet. Thuhej se gjermanët do të përdornin taktikën e tokës së djegur. Banorët e qytetit e kuptonin shumë mirë gjendjen dhe jo vetëm që nuk kishin frikë nga pallavrat dhe kërcënimet e gjermanëve dhe të ballistëve, por dhe vepronin. Ishin gati të hidheshin në zjarr dhe të bënin flijime për të shpëtuar njëherë e mirë nga robëria fashiste.

Batalioni dukej sikur flinte i qetë rrëzë kodrave të Gorishtit pas asaj beteje që habiti krahinën dhe kishte harruar fare për rrezikun që i kërcënonte banorët dhe vetë qytetin, por e vërteta nuk ishte ashtu. Batalioni i qenështuar një përgatitjeje intensive për luftë në kushtet e qytetit dhe priste udhën e Komandës së Brigadës. Komunistët që vepronin në ilegalitet brenda në qytet po pu-



nonin intensivisht për të koordinuar veprimet e njësitit guerril të qytetit me forcat partizane që do të angazhoheshin në luftë për çlirimin e qytetit.

Në batalion kishin ndodhur ndryshime. Ai ishte inkuadruar në brigadën e re, të porsakrijuar, që ishte emërtuar Batalioni i Parë. Komisar i batalionit ishte caktuar Din Kurti, ndërsa Pali Duroja ishte caktuar komisar i komandës së vendit të Qarkut. Kishte shkuar në komandën e vendit edhe Nesti, i cili ishte përmirësuar nga shëndeti në stanin e barinjve. Komandanti i batalionit Bakir Xhabiri nuk e kishte pritur mirë transferimin e komisarit, por megjithatë ai mendonte se edhe te Din Kurti kishte gjetur një komisar me zemër të madhe, me guxim të rrallë dhe me një mendje të hollë. Në luftën e Gorishtit Din Kurti i qe dukur komandant Bakirit si ndonjë shpend i egër që printe tufën. Ai s'kishte parë njeri tjetër përveç Pali Duros, që të synonte drejt qëllimit me një ngulm të tillë. Kur fliste Dini, ai e dëgjonte me sytë të fiksuar në ballin e tij dhe mendonte se ai i dinte të gjitha gjuhët e botës. «Komisari, — thoshte komandant Bakiri, — është përfaqësues i Partisë, ai duhet të jetë edhe trim, edhe i zgjuar». Edhe Veloja shpeshherë, kur betohej, thoshte: «Qafsha Dinin» ose «Për kokë të Dinit». Dhe këtë be ai e bënte për gjëra me shumë rëndësi. Si Bakiri ashtu dhe Veloja silleshin të gëzuar nëpër tokat e shikonin përgatitjet për detyrën e ardhshme. Kurse përgatitjet e gjermanëve, transhetë e tyre i shikonin si me mospërfillje. Ata thoshin se partizanët janë shpendë mali që nuk e njohin rrezikun.

Re të holla kishin mbuluar hënën, megjithatë drita e saj e zbetë mjaftonte për të bërë të dukshme trajtat e turbullta të sendeve. Batalioni bëri afrimin që natën dhe u vendos në vendin e caktuar. Kompania e Velos u vendos nga ana e malit dhe kishte pak të ftohtë. Veloja u mbështet te trangu i një gorrice dhe ndenji një copë herë të madhe me syrin e një njeriu që njeh artin ushtarak. Herë pas here hidhte sytë nga maja e malit, nga lindja, sikur mezi priste të hapej mëngjesi. Ashtu dhe dremiste duke mbyllur e duke hapur sytë.

Akoma nuk ishte gdhirë plotësisht kur komandant Bakiri dha sinjalin e sulmit. Partizanët u derdhën përpara me një shpejtësi të rrufeshme të etur për sulm e kjo nuk mbahej mend në asnjë luftim tjetër. Bakiri ndiqte i përqëndruar të gjitha lëvizjet e partizanëve. Ai i kishte ngulur sytë mbi ta, duke mos lënë t'i shpëtonte asnjë nga lëvizjet e tyre. Ata që i panë e i dëgjuan thirrjet e partizanëve si dhe britmat dhe çirrjet e gjermanëve të shoqëruara me oshëtimën dhe buçimën e krismave të të gjitha llojeve të armëve që dispononin të dyja palët menduan se kishte ardhur fundi i botës. Të dy, Bakir Xhabiri dhe Velo Gora, përdrodhën mustaqet duke i ngritur si shtizë përpjetë dhe kjo ishte një shenjë që tregonte sipas tyre se gjermanët do të lëshonin armët që me sulmin e parë, por u gabuan.

Kodrat përreth qytetit thithnin krismat dhe gjëmet. Ndërsa partizanët ishin futur në shtëpitë e para të qytetit, kulla e Josif Muhaxhirit që zotëronte një pjesë të mirë të periferisë së qytetit qëndronte ende në duart e gjermanëve. Kulla bënte hije mbi tokë. Ishte vështirë të merrej ajo, por Veloja mendonte se ajo nuk do t'i rezis-



tonte gjatë sulmit partizan. Rezistenca e gjermanëve i tërbonte edhe më tepër partizanët. Komandant Bakiri po vriste mendjen pse kjo kullë kishte marrë emrin e Josif Muhaxhirit. «T'ëmën, — shau veten. — Jam komandant dhe nuk di akoma pse kjo kullë është quajtur me këtë emër. Hajvan dhe unë, si s'e kam pyetur komisarin? Mund të ketë vdekur ndonjë nga ata që e kanë ndërtuar që në kohën e Turqisë, ose është vlarë ndonjë nga komitet në luftërat e mëparshme që e quanin Josif», — e sikur u kënaq nga shpjegimi që i bëri. Klithmat, rënkimet dhe mallëkimet e gjermanëve të plagosur e shkëputën komandant Bakirin nga ky mendim. Në drejtim të kullës po zhvillohej një luftë e ashpër dhe përfundimi i saj dukej i dyshimtë. Bakiri bëri tutje me një pamje krejt të qetë, që tregon-te se kishte besim të plotë se kompanisë që vepronte në atë drejtim nuk i kanosej asnjë rrezik.

Qyteti i rrethuar me male e gryka po tymoste dhe po rridhte gjak. Dini me Velon po ecnin me vrap në drejtim të disa shtëpive pa marrë parasysh rrezikun. Edhe aty rezistenca e gjermanëve ishte shumë e ashpër. Një togë e kompanisë së parë ishte gozhduar në vend dhe nuk ngrinte dot as majën e hundës. Përfund një rrafshinë që shtrihet si ndonjë varrezë e braktisur dhe e pa fund, ishte një tank. Tanku ngjante si një mushkë e plagosur e ngarkuar me arka me municion që ishte rrëzuar e s'mund të ngrihej dot. Nga ky krah, nga e djathta e hyrjes së qytetit, dukeshin dy bunkerë si samarë breshke. Tanku që dukej si i groposur përgjysmë rrotullonte kullën e tij të çeliktë me grykën e topit në të gjitha drejtimet. Rrugët e qytetit ishin të shkreta dhe shtëpitë e dyqanet mbyllur e në pritje. Breshëria e predhave të mortajave sa vinte e dendësohej, gjersa u shndërrua në një breshër të madh. Ishte vendi që goditej më tepër nga gjermanët. Dini ngriti dorën. Automatiku në dorën e tij shkëlqeu për një çast në rre-

zet e diellit që sapo nxori kokën mbi majën e malit Grano. Prapa shpinës së tij dikush tha diçka. . . Tani partizanët nuk qëllonin më, sepse mund të godisnin të vetët. Duke përfitur nga kjo, gjermanët u shfaqën në anën tjetër të ndërtesës. Por kundërsulmi si dukej u kufizua në një orvatje të kotë për të mbajtur ndërtesën. Din Kurti dha urdhër të devijojehj nga e djathta e t'i dilej ndërtesës nga mbrapa.

Gjermanët filluan të silleshin në rrugët e qytetit. Ata tentuan t'u vinin zjarr disa depove ushtarake, por u penguan nga forcat partizane. Matanë një rrugice ranë shtëllunga të dendura tymi, që të zinin frymën.

— Ti, — i tha një partizani Veloja, — ngjitu sipër në atë shtëpi, vendos mitralozin ku të të mbushet koka ty dhe merr në shenjë atë zuzar atje. — Partizani e kuptoi se Veloja quajti zuzar mitralozin gjerman, ndaj dhe nuk kërkoi sqarime se për kë e kishte fjalën.

Veloja që ndiqte pa marrë frymë përfundimin e përleshjes nuk guxonte të shtinte nga frika se mos vriste shokët e tij. Gjermanët që nuk kishin luajtur nga vendi, u përgjigjeshin me të shtëna të matura dhe të përpikta. Mitralozi që villote zjarr për një çast u zhduk sikur të mos kishte qenë kurrë. Veloja u sul drejt ndërtesës ku kishte qenë mitralozi gjerman. Ai rendi me tërsëllëmë. Bulevardi ishte i vdekur. Dikush hodhi drejt tij një breshër plumbash. Velo Gora mbylli sytë. Qëndroi një copë herë ashtu. Kur i hapi, pa se partizanët akoma po kapërcenin disa mure dhe po vraponin nga sipër drejt mureve të ndërtesës. Çatia ishte mbuluar me tjegulla të kuqe që i kishin sjellë nga Italia. Në atë kohë gjëmuan njëra pas tjetrës të katër mortajat që ishin vendosur sipër kazermave. Predhat ranë diku larg tyre. Shpërthimet ishin aq të forta, sikur të ishte çarë dheu.

Din Kurti tundi kokën.



— Shiko, — i tha Veloja komisarit, Dinit, dhe i vuri dorën në sup, — shiko ç'bën ai atje.

Përfund një ndërtese përballë tyre ngrihej një shelg i madh, që ishte përkulur aq shumë, sa degët e tij të pasme vareshin gati rrafsh me tokën. Mbrapa trugut të tij ishte fshehur një ballist. Ai herë fshihej pas trugut, herë vështronte përmes degëve, duke dashur të shihte nëse kishte goditur në shenjë.

— Ky djall kërkon të na vrasë, — tha Veloja. — Mos e pusho zjarrin kundër atij qelbashi, — i tha Rustemit që kishte pas.

Veloja me Rustemin shtinë përnjëherësh. Lëvozhgat dhe fletët e zverdhura të shelgut fluturuan dhe era i shpërndau në të katër anët. Ballisti u përgjigj duke sharë dhe me një plumb tjetër ia rrëzoi Velos kapelen nga koka. Nga drejtimi i kullës shpërthyen përsëri britma të egra dhe një breshëri plumbash fërshëllyen përmbi kokat e partizanëve. Asnjë nga shokët nuk mbeti i vrarë, vetëm disa u plagosën për shkak se po luftonin në një vend të zbuluar. Me sa dukej, gjermanët kërkonin të mos i linin partizanët të lëviznin nga vendi dhe t'u jepnin mundësi forcave të tërhiqeshin nga pjesa lindore e qytetit. Ata u hodhën në kundërsulm dhe luftonin me këmbëngulje e dëshpërim. Ballisti i fshehur mbrapa trugut të shelgut nuk pushonte së qëlluari, mbase më kot, sepse, porsa nxirrte kokën nga mburoja, një breshër plumbash i binin përqark. Më në fund ballisti mori guxim dhe me shpejtësi të rru-feshme u hodh në një hendek, por s'arriti dot.

— Jepi edhe një plumb!, — i tha Rustemi Velos.

— As edhe një plumb, — iu përgjigj Veloja. — Ai ma mori të keqen, duhet t'i kursejmë fishekët. Tani e kemi rrugën të hapur, unë them të ecim.

Dini me Rustemin bënë tutje.

Në orët e vona të pasdites gjermanët nuk e zbrapsën dot sulmin e tretë të forcave partizane. Gjermanët e shpërndarë në pika të ndryshme të qytetit, me përjashtim të atyre pak gjermanëve që rezistonin të rrethuar në kullën e Josif Muhaxhirit, u grupuan dhe pas një përleshjeje të ashpër mundën të çanin rrethimin në drejtim të juglindjes. Kolona e tyre nisi të rrëshqiste në drejtim të Grykave të Dakës, e ndjekur nga forca të tjera të brigadës. Thoshin se kompania e katërt që vepronte në atë drejtim kishte zënë rob Fate Ymerin, Beçe Golin dhe Seit Ferrën, por nuk dihej me siguri. Në mbrëmje u mor vesh se ky lajm ishte i vërtetë.

Pesë gjermanë dhe tre ballistë që nuk kishin mundur të bashkoheshin me forcat kryesore hiqeshin zvarë ashtu përtokë si gjarpërinj. I gjetën të pesë gjermanët dhe tre ballistët prapa një kovaçhane gjysmë të rrethuar që ishte në dalje të qytetit. Veloja s'kishte parë kurrë njerëz më të rraskapitur se ata. Gjermanët dhe ballistët rrinin gojëkuçur dhe nuk lëviznin nga vendi. Një grumbull të rinjsh mbledhur rreth e rrotull me një farë largësie, duke vështruar gjermanët dhe ballistët në heshtje, tregonin urrejtje e interesim. Disa prej tyre u hidhnin robërve nga një vështrim plot mllef duke e shfryrë dufin me gjithfarë gjestesh kërcënuese. Në krah të tyre, mbështetur pas një muri, ishte Dini. «Le të shfryjnë dufin», — tha me vete dhe mbështeti mjekrën në pëllëmbën e dorës si një njeri që vret mendjen dhe s'di si t'ia bëjë. Por u pendua shpejt për këtë mendim.

— Mjaft, — u tha Dini atyre. — Ne nuk kemi të drejtë të ofendojmë robërit. Na e ndalon ligji i luftës.

Fytyrat e gjermanëve me atë uniformën e tyre zhelezhele, tërë baltë e pendë pulash, shprehnin turp dhe dëshpërim. Dukej çiltas se ata e ndienin veten të poshtëruar në kulm që kishin rënë rob në duart e partizanëve.



Velos nuk i erdhi mirë që Dini i ndaloi shokët. Ai ngriti me një lëvizje të buzëve mustaqet lart dhe mezi e përmbajti veten.

— Lëri, ore, djemtë... Ç'janë këto rregulla që po na vë?

— Këto nuk janë rregullat e mia, Velo, — e ndërpreu Dini. — Këto i ka vendosur Komanda Supreme dhe ne duhet t'i zbatojmë ato.

Erdhi një partizan i mbytur në djersë dhe tha se në afërsi të kullës së Josif Muhaxhirit ishin vrarë dy partizanë dhe se një kolonë gjermane kishte shpërthyer në drejtim të kompanisë së tretë dhe po tërhiqej gjatë rrugës automobilistike në drejtim të Grykave të Dakës. Dini u dëshpërua shumë për vrasjen e shokëve dhe ktheu kokën nga ana tjetër. Veloja përdrodi njërën anë të mustaqes. Komandant Bakiri rrinte në këmbë i heshtur, duke kapsallitur sytë me kokën të anuar në sup dhe thithte i turbulluar cigaren.

Për disa minuta ata qëndruan të palëvizur, pastaj bënë përpara, por me hapa të matur, të ngadalshëm, duke u ndaluar në çdo çast dhe pa ia hequr sytë kullës, sikur prisnin që nga muret e saj të heshtura të dilnin gjermanët e fundit. Poshtë, rrëzë mureve, ishin shtrirë kufomat e tre ushtarëve gjermanë. Dini mori frymë thellë sikur të ishte liruar nga një barrë e rëndë dhe tha me gjysmë zëri:

— U shpartalluan, për besë u shpartalluan keq.

Së largu një oficer dhe dy ushtarë gjermanë, si murgj të mesjetës, po dilnin nga kulla si nga kubeja e një katedraleje të vjetër. Oficeri ishte komandanti që kishte komanduar një togë ushtarësh. Ndaloi para Dinit. Sytë e tyre u takuan me urrejtje. Gjermani bëri një gjest nënshtrimi, ndonëse tiparet e rrepta të fytyrës së tij shprehnin përsëri një kryelartësi e mosbesim që rridhte më tepër nga habia dhe përbuzja që kishte për kundërshtarin. Ai uli kokën me ballin tërë rrudha sikur dëgjonte zhurmë në tokë dhe tha:

IA — Unë do të dëshmoj kudo dhe kurdoherë për forcën dhe trimërinë e luftëtarëve tuaj.

Ai fliste në gjuhën e vet dhe partizanët vetëm nga gjestet, me të cilat përforconte pareshtur fjalët, mund të merrnin me mend se çfarë thoshte.

Komandant Bakiri kafshoi buzën dhe nguli sytë më thellë sikur donte të lexonte deri në fund mendimet e tij.

— Ne, — vazhdoi oficeri gjerman, — i ulëm armët përpara forcës dhe shpirtit tuaj sulmuës. Vetëm një kryeneç budalla s'mund të çmojë forcën tuaj.

— Më në fund e kuptuat, — e ndërpreu Dini.

\* \* \*

Dielli ishte në të perënduar. Ngjante sikur tërë krahina kishte marrë flakë. Qyteti tymosi dhe rrodhi gjak tërë ditën. Nëpër rrugët e qytetit kishin dalë të rinj e të reja, plaka e pleq, ata këndonin e qeshnin, hidhnin parulla dhe tundnin grushtet përpjetë. Disa prej tyre mblidhnin helmetat dhe armët e hedhura andej e këndeje. Nga rrugët u hoqën kufomat e gjermanëve dhe u zbrazën pushkë e mitraloza për nder të fitores. Në sheshin kryesor nga rrugica të ndryshme vërshuan grupe partizanësh dhe pas tyre vajza e djem të rritur duke kënduar e bërtitur. Por forcat kryesore të batalionit ishin në bllokim të qytetit. Këtë urdhër e kishte dhënë Pali Duroja, komisari i komandës së vendit, i cili bënte pjesë në shtabin operativ për çlirimin e qytetit që sapo kishte mbërritur. Ata do të qëndronin deri të nesërmen në mëngjes. Në mbrëmje në të gjitha fshatrat, rrëzë malit Grano, u ndezën zjarre. Thuhej se ishte e dyta herë që ndodhte një gjë e tillë. Herën e parë zjarre të tillë ishin ndezur në mbrëmjen e 8 nëndorit 1941, kurse tani ato lajmëronin të gjithë krahinën për fitoren e madhe.



31 Të nesërmen batalioni parakaloi përmes qytetit, përpara popullit dhe përfaqësuesve të Partisë e të pushtetit popullor. Batalioni s'kishte bërë asnjë stërvitje të posaçme për parakalim, por partizanët marshuan bukur dhe me një hap të rregullt. Populli i përshëndeti nga dritaret dhe trotuarët e rrugës. Batalioni atë ditë kishte një pamje ma-dhështore. Bajonetat e mbërthyera në pushkët shkëlqenin në ajër më tepër se çdo ditë tjetër. Dukej sikur ato putheshin me qiellin.

Në qytet valonin në të gjitha anët flamurë të kuq. Në ballë të ish-Komandaturës Gjermane ishte vendosur një banderolë e bardhë, e madhe, ku ishin shkruar: «RROFTË PUSHTETI POPULLOR». Kurse në një ndërtesë tjetër përballë saj: «RROFTË USHTRIA NACIONALÇLIRIMTARE».

Fill pas parakalimit të batalionit, përmes qytetit kaloi grupi i robërve të luftës. Ata po i shpinin në vendin e caktuar posaçërisht për ta. Në krye printe Velo Gora, ndërsa djathtas e majtas partizanë me armë në duar që shoqëronin robërit. Kur kaloi kjo turmë, njerëzit të ardhur nga fshatrat përreth, nga Lenica, Bërdusha, Lushaka, Gorishti etj. vështronin me vëmendje por në heshtje lëvizjet e të mundurve, që mezi hidhnin këmbët.

Pas fjalimit të shkurtër që mbajti një nga përfaqësuesit e pushtetit popullor, në emër të forcave që morën pjesë për çlirimin e qytetit e mori fjalën Dini. Porsa hapi gojën, të gjithë filluan të dëgjonin me vëmendje. Zëri i tij tregonte krenari dhe mallëngjim. Ai hapte krahët sikur donte t'i përqafonte të gjithë.

— Vëllçzër, — tha ai. — Të huajt ishin bërë zotër në qytetin tonë. Tani...

Po nuk e mbaroi dot fjalën. Zërin e Dinit e mbulonin britmat e të rinjve dhe të të rejave. Një entuziazëm dhe gëzim të tillë s'kishte njohur ndonjëherë ky qytet i

vogël malor. Të gjitha sa deshi të thoshte Dini mund të lexoheshin në fytyrat e atyre që ishin aty. Ja, ai e mori përsëri fjalën... Fliste për punë trimërie dhe vështrimi i masës bëhej i ngulët dhe i rreptë. Kujtonte të këqijat që kishin hequr dhe sytë e tyre ndizeshin nga zemërimi. Zinte në gojë poshtërsitë e gjermanëve dhe të ballistëve dhe disa nga të afërmit e tyre ulnin kokën të turpëruar. Ndonjëri shikonte rrugën si dhelpira prapa gardhit. Të gjithë e dinin se kishte ende forca që nuk do të pajtoheshin deri në vdekje me këtë ditë të re, me gëzimin e lumturinë e tyre. Kur përsëriti fjalën «hakmarrje», ai prekte telin më të ndjeshëm të atyre që kishin pësuar nga lufta. Ata e kuptonin që shpata e drejtësisë do të binte pa mëshirë mbi të gjithë ata që kishin bërë krime.

— Hakmarrje! Hakmarrje!, — gjëmoi sheshi.

Dini zgjati dorën nga ndërtesat e rrënuara. Muret e kullës së Josif Muhaxhirit i ranë përsëri në sy dhe ai filloi të shihte Shqipërinë që nga kohët më të lashta. Ndjeu sikur para syve të tij tundej qyteti. Ata që e kishin ndërtuar këtë kullë kishin vdekur, por kjo i zgjoi gjithfarë kujtimesh e mendimesh. Turma pa sytë e Dinit që digjeshin si prushi.

— Populli ynë edhe më përpara ka luftuar, — vijoi Dini dhe fytyra e tij mori një shprehje serioziteti. — Të huajt gjithnjë janë vërsulur me tërbim përmbi vatrat tona, por të paktë qenë ata që u kthyen të gjallë në shtëpitë e tyre.

Komandant Bakiri ndiqte në heshtje të thellë e tërë kënaqësi lëvizjet e hijshme të Dinit dhe dukej sikur po peshonte me kujdes çdo fjalë të tij, pastaj filloi të mos e ndiqte më logjikën e fjalëve të Dinit, sikur humbi në kujtime, të cilat iu dukën të largëta, si të kishin ndodhur në një kohë tjetër, në një epokë tjetër, kur tamam ai, Din Kurti, që po fliste tani, ai komisar, nuk ishte veç një djalosh që bridhte rrugëve të këtij qyteti për të ngjitur traktin e parë.

Dhe s'kishin kaluar veçse dy-tre vjet. . .